



THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe



**REGIONAL
ANTI-CORRUPTION
INITIATIVE**

Lufta kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor: forcimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e kthimit të pasurive



Titulli:

Lufta kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor: forcimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e rikuperimit të aseteve

Projekti:

Forcimi i antikorrupsionit në Evropën Juglindore përmes përmirësimit të masave të konfiskimit të pasurive

Botuesit:

Këshillim për të Drejtat Individuale në Evropë (AIRE)
Nisma Rajonale Antikorrupsion (RAI)

Për botuesit:

Biljana Braithwaite – Drejtor, Programi i Ballkanit Perëndimor, Qendra AIRE
Vladan Joksimović – Drejtues i Sekretariatit të RAI-t

Redaktor:

Desislava Gotskova

Autor:

Jill Thomas

Kontribues:

Prof. Dr. Sc. Eldan Mujanović, (Bosnjë dhe Herzegovinë)
Mirjana Lazarova Trajkovska (Maqedonia e Veriut)
Radmila Dragičević Dičić (Serbi)
Ledina Mandia, Dr. (Shqipëri)
Aleksa Ivanović (Mali i Zi)
Ganimete Ismajli (Kosovë*)

Përkthimi dhe korrektimi:

Will Ferris (anglisht);
Adelina Albrahimi (shqip);
Duška Tomanović (BCMS)
Zoran Gavriloski (maqedonisht)

Dizajni dhe printimi:

Kliker Dizajn

Pikëpamjet e paraqitura në botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Nismës Rajonale Antikorrupsion ose shteteve anëtare të saj.



Përgatitja e këtij publikimi është mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim nuk reflektojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Lufta kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor: forcimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e kthimit të pasurive

Qendra AIRE dhe Iniciativa Rajonale Antikorrupsion

Raport mbi kthimin e pasurive dhe bashkëpunimin
ndërkombëtar në Ballkanin Perëndimor

Edicioni i 2-të

Pasqyra e lëndës

Parathënie	7
Përmbledhje ekzekutive	9
Shkurtime	18
1. Hyrje.....	20
2. Metodologjia (fusha e veprimit dhe periudha).....	22
3. Përkufizime	23
4. Standardet ndërkombëtare dhe evropiane për kthimin e pasurive	27
4.1 Konventat e Kombeve të Bashkuara.....	27
4.2 Rekomandimet e FATF-së	27
4.3 Këshilli i Evropës.....	28
4.4 Bashkimi Evropian.....	28
5. Vështrim i përgjithshëm mbi juridiksionet	31
5.1 Shqipëria	31
5.2 Bosnjë dhe Hercegovina	41
5.3 Kosova*	47
5.4 Mali i Zi	54
5.5 Maqedonia e Veriut	59
5.6 Serbia	66
6. Ndikimi i pandemisë COVID-19 mbi kthimin e pasurive në Ballkanin Perëndimor	75
7. Përfundime dhe rekomandime	79
8. Shtojca 1: Lista e raporteve të AIRE - RAI-t të prodhuara gjatë periudhës së raportimit	92

Parathënie

Ky raport shënjon përfundimin e projektit dyvjeçar rajonal “Forcimi i antikorrupsionit në Evropën Juglindore përmes përmirësimit të masave të konfiskimit të pasurive”, i cili u zbatua nga qendra AIRE (Këshilla për të Drejtat Individuale në Evropë) dhe Sekretariatit të Iniciativës Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI). Projekti u financua nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetje të mëtejshme të ofruar nga fondacioni *Konrad Adenauer*.

Korrupsioni është një nga sfidat më të përhapura dhe më të papajtueshme me sundimin e ligjit. Në Evropën Juglindore dhe në të gjithë botën, korrupsioni krijon pengesa për biznesin dhe mundësitë individuale, shkatërron forcën dhe autoritetin e sistemeve të drejtësisë dhe rrjedhje nga arka e shtetit, duke shmangur drejtimin e parave nga përdorimi produktiv dhe përfitues drejt ndërmarrjeve kriminale. Masat efektive të kthimit të pasurive janë thelbësore për luftimin e korrupsionit dhe të gjitha format e krimit. Masa të tilla shërbejnë për të mbrojtur ekonominë e ligjshme, për të forcuar të ardhurat nga taksat, për të gjeneruar pasuri për të mirën publike, për të ndihmuar në mbrojtjen e shtetit ligjor, për të minuar stimujt kriminalë dhe për të parandaluar aktivitetet e paligjshme.

Projekti i qendrës AIRE dhe RAI synonte forcimin e kapaciteteve të institucioneve kryesore (në veçanti zyrat e prokurorive, gjykatat, qendrat e trajnimit gjyqësor, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe agjencitë e menaxhimit të pasurive) për të zbatuar në mënyrë efektive masat e kthimit të pasurive në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe nxitjen e bashkëpunimit rajonal në rastet e kthimit të pasurive.

Projekti u përqendrua posaçërisht në juridiksionet e mëposhtme: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë*, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut dhe Serbi. Qëllimi i projektit gjithashtu shtrihej herë pas here në zona të tjera të Evropës Juglindore, duke përfshirë profesionistë nga Bullgaria, Kroacia, Moldavia dhe Rumania.

Gjatë jetës së tij dyvjeçare, projekti krijoi hartën e fushave të pikave të forta dhe të dobëta në të gjitha juridiksionet e përfshira, prodhoi tri botime specifike në rajon për kthimin e pasurive, hodhi bazat për rrjetin rajonal të alumnit për të siguruar që ata që kanë marrë pjesë në projekt të mbeten të lidhur dhe të përditësuar me zhvillimet në legjislacion, politika dhe procedura, kreu një sërë trajnimesh praktike në fushat ku nevojitej kapacitet më i konsoliduar, organizoi dy vizita studimore të përqendruara te profesionistët teknikë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Rumani, hodhi themelet për qasjes rajonale të mbledhjes dhe analizës statistikore dhe kontribuoi për përcaktimin e kthimit të pasurive si një objektiv politikash në të gjithë rajonin.

Gjatë dy viteve të fundit, puna e qendrës AIRE dhe RAI-t ka ndihmuar juridiksionet në të gjithë Evropën Juglindore për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve për të

* Ky emërtim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me rezolutën e Këshillit të Sigurimit nr. 1244 dhe mendimin e GJND-së për deklarimin e pavarësisë së Kosovës.


zhvilluar regjime efektive të kthimit të pasurive dhe për të integruar punën e tyre me rrjetin ndërkombëtar të masave antikorrupsion të kontinentit. Progresi i dëshmuar në këtë raport është një dëshmi e punës së qendrës AIRE dhe RAI-t, por mbi të gjitha është dëshmi e angazhimit, zbatimit dhe optimizimit të të gjithë pjesëmarrësve dhe partnerëve tanë në rajon.

Raporti u shkrua nga znj. Jill Thomas, eksperte ndërkombëtare për kthimin e pasurive, e cila ka përvojë të gjerë në rajon. Kontribute të mëtejshme u dhanë nga koordinatorët kombëtarë të projektit prof. dr. asoc. Eldan Mujanović (Bosnjë dhe Hercegovinë); Ledina Mandia PhD (Shqipëri), Ganimete Ismajli (Kosovë*), Aleksa Ivanović (Mali i Zi), gjyqtare Mirjana Lazarova Trajkovska (Maqedonia e Veriut) dhe gjyqtare Radmila Dragičević-Dičić (Serbi). Si pjesë e procesit të hartimit dhe konsultimit, ministrive përkatëse të drejtësisë së rajonit iu dha drafti përfundimtar i raportit në mënyrë që ai të mund të përfitonte nga komentet dhe reagimet e tyre. Do të dëshironim të falënderonim të gjitha institucionet kombëtare të rajonit të Evropës Juglindore dhe veçanërisht qendrat e trajnimit gjyqësor, zyrat e prokurorive dhe gjykatat për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm.

Qendra AIRE dhe RAI gjithashtu dëshirojnë të falënderojnë Qeverinë e Mbretërisë së Madhe për angazhimin e saj në projekt, mbështetjen thelbësore financiare dhe udhëzimet e saj mbi luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Falënderojmë gjithashtu edhe fondacionin *Konrad Adenauer* për ofrimin e mbështetjes financiare, i cili bëri të mundur pjesëmarrjen e përfituesve shtesë nga rajoni.

Së fundmi, dëshirojmë të shprehim vlerësimin për përkushtimin, profesionalizmin dhe angazhimin e të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të kthimit të pasurive që morën pjesë në projekt dhe kontributin e vyer për përfundimin e tij me sukses.

VLADAN JOKSIMOVIC



Shef i Sekretariatit,
Iniciativa Rajonale Antikorrupsion

BILJANA BRAITHWAITE



Drejtor,
Programi i Ballkanit Perëndimor
Qendra AIRE

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport synon të vlerësojë progresin dhe zhvillimet e bëra në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën*, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, përgjatë jetëgjatësisë së projektit rajonal të qendrës AIRE dhe RAI-t për kthimin e pasurive, me titull “Forcimi i antikorrupsionit në Evropën Juglindore përmes përmirësimit të masave të sekuestrimit të pasurive”, i cili u financua nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe u mbështet financiarisht nga fondacioni *Konrad Adenauer*. Fokusi i tij është kthimi e pasurive kombëtare dhe ndërkombëtare dhe posaçërisht politikën e kthimit të pasurive, sekuestrimi i pasurisë, menaxhimi, konfiskimi, asgjësimi, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbledhja e statistikave mbi kthimin e pasurive. Raporti gjithashtu përfshin një rishikim i kapaciteteve të hetimit financiar, veçanërisht në lidhje me gjurmimin e pasurisë që më vonë mund të bëhen objekt i një urdhri ngrirjeje, konfiskimi ose sekuestrimi, ose që i nënshtrohen aktualisht urdhrave të tillë.

Gjatë gjithë këtij vlerësimi janë marrë parasysh botimet e mëposhtme të projektit rajonal të AIRE-RAI-it:

Botimi i Qendrës AIRE dhe RAI-it “Kthimi i pasurive në Ballkanin Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës (2018)”

Ky botim përcakton terrenin për kthimin e pasurive në rajon, duke dhënë komente mbi kapacitetet për të kryer kthimin e pasurive në secilin juridiksion, bashkëpunimin ndërkombëtar për kthimin e pasurive, njohuritë për teknikat e hetimit financiar dhe regjistrimin e statistikave.

Doracaku i Qendrës AIRE dhe RAI-it “Për kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)”

Ky botim është një përgjigje ndaj rekomandimeve në raportin e Analizës Krahasuese të Legjislacionit dhe Praktikës (2018). Ai ofron një përshkrim unik në thellësi dhe gjithëpërfshirës të procesit dhe legjislacionit të kthimit të pasurive në secilin prej juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor. Në veçanti, ai përqendrohet te “konfiskimi i zgjeruar” dhe përpjekjet e rajonit për të zbatuar këtë qasje të re.

Doracaku i Qendrës AIRE dhe RAI-t “Për instrumentet dhe praktikën më të mira për bashkëpunimin ndërkombëtar për kthimin e pasurive (2019)”

Ky botim është projektuar posaçërisht për të mbështetur autoritetet e angazhuara në kthimin e pasurive ndërkombëtare. Ai synon të forcojë njohuritë dhe aftësinë e agjencive të zbatimit të ligjit, shërbimeve të prokurorisë dhe organeve gjyqësore për të zbatuar instrumentet e bashkëpunimit ndërkombëtar në rastet e kthimit të pasurive, kur kërkohet të identifikohen dhe më pas të sekuestrohen dhe konfiskohen pasuritë e vendosura jashtë juridiksioneve të tyre.

Raporti i qendrës AIRE dhe RAI-t “Mbi zbatimin efektiv të masave të kthimit të pasurive në Ballkanin Perëndimor: vështrim i përgjithshëm i metodologjisë së monitorimit rajonal, treguesit kryesorë krahasimorë dhe raste studimore të praktikave të mira” (2020).

Në përgjigje të përfundimeve të botimit “*Analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës (2018)*”, ky raport përqendrohet në qasjen dhe fazën në të cilën ndodhet çdo juridiksion i Ballkanit Perëndimor lidhur me mbledhjen e statistikave mbi kthimin e pasurive, në përputhje me standardet e reja të BE-së në këtë fushë. Përveç kësaj analize unike, botimi përmban raste studimore në disa fusha të tjera të lidhura me kthimin e pasurive.

Objektivat e raportit janë:

- » të rishikojë situatën aktuale në aspektin e legjislacionit, politikave, kornizave institucionale dhe praktikës në fushën e kthimit të pasurive kombëtare dhe ndërkombëtare në secilin prej juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor në krahasim me standardet ekzistuese evropiane dhe ndërkombëtare dhe praktikat dhe rekomandimet më të mira dhe përparësitë e identifikuara që burojnë nga aktivitetet e projektit;
- » duke përdorur katër botimet^[2] e qendrës AIRE dhe RAI-it si bazë, të përshkruajë situatën aktuale duke ofruar një vlerësim gjithëpërfshirës të progresit, duke u përqendruar veçanërisht te fushat e ndërhyrjes së projektit (zbatimi i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare dhe bashkëpunimi ndërkombëtar);
- » të eksplorojë çdo indikacion fillestar të ndikimit të pandemisë së COVID-19-ës mbi kthimin e pasurive dhe të identifikojë fushat e mundshme të ndërhyrjes/mbështetjes që mund të sigurohen nga projekti ose nga një projekt vijues;
- » të sigurojë rekomandime, bazuar në gjetjet dhe konkluzionet e këtij vlerësimi dhe ndikimin e pandemisë COVID-19 për kthimin e pasurive në rajon.
- » të sigurojë udhëzime për ndërtimin e kapaciteteve të ardhshme rajonale dhe forcimin e lidhjeve midis profesionistëve kombëtarë në rajon.

Kuptimi i terminologjisë së kthimit të pasurive në kontekstin ndërkombëtar mund të jetë sfidues. Kreu 3 ofron një listë të fjalëve dhe termave të lidhura me kthimin e pasurive, së bashku me shpjegimin e profesionistëve për kuptimin e tyre dhe përkufizimet përkatëse të OKB-së, FATF-së, KiE-së dhe BE-së, në rastet ku ato ekzistojnë.

Kreu 4 përmban një referencë ndaj standardeve ndërkombëtare dhe evropiane në kthimin e pasurive të referuara më parë në botimet e qendrës AIRE dhe RAI-t, përveç standardeve të reja përkatëse të miratuara gjatë periudhës së projektit. Në këtë kontekst, kreu i referohet specifikisht direktivës (BE) 2019/1153, që përcakton

[2] Botimi i AIRE-RAI-t “*Kthimi i pasurive në Ballkanin Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës (2018)*”; “*Doracak për kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)*”; “*Manual për instrumentet dhe praktikat e mira për bashkëpunimin ndërkombëtar për kthimin e pasurive (2019)*”; “*Raporti i AIRE-RAI-it “Mbi zbatimin efektiv të masave të kthimit të pasurive në Ballkanin Perëndimor: përmbledhje e një metodologjie rajonale të monitorimit, standardeve krahasimore dhe studimeve të rasteve të praktikave të mira (2020)*”.

rregullat që lehtësojnë përdorimin e informacionit financiar dhe informacionit tjetër për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të disa veprave penale dhe për shfuqizimin e vendimit të Këshillit 2000/642/JHA. Ky instrument i ri është veçanërisht i rëndësishëm për zyrat kombëtare të kthimit të pasurive, pasi ai ofron rregulla për marrjen dhe përdorimin e informacionit financiar gjatë hetimeve, përfshirë gjurmimin e pasurisë për qëllimin e konfiskimit. Sipas kësaj direktive, juridiksionet e BE-së janë të detyruara t'u ofrojnë zyra të kthimit të pasurive qasje në regjistrat e tyre kombëtarë të centralizuar të llogarive bankare.

Kreu 5 përmban një pasqyrë të situatës aktuale në secilin prej vendeve të Ballkanit Perëndimor në drejtim të legjislacionit, politikave, kornizave institucionale dhe praktikës në fushën e kthimit të pasurive kombëtare dhe ndërkombëtare, duke theksuar progresin, duke u përqendruar veçanërisht te fushat e ndërhyrjes së projektit.

Për të ndihmuar në identifikimin e fushave që kërkojnë mbështetje të mëtejshme, vështrimi i përgjithshëm i zhvillimeve në secilin prej juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor në kreun 5 dhe seksioni mbi përfundimet dhe rekomandimet në kreun 7 ndahen në temat e mëposhtme:

- » Kthimi i pasurive si objektivi politikash;
- » Dispozitat ligjore për ngrirjen, konfiskimin dhe sekuestrimin në kuadrin e kthimit të pasurive;
- » Konfiskimi i zgjeruar;
- » Konfiskimi civil ose administrativ i bazuar në mosdënim;
- » Hetimi financiar;
- » Menaxhimi i pasurive;
- » Ripërdorimi i pasurive të konfiskuara;
- » Bashkëpunimi ndërkombëtar;
- » Matja e efektivitetit dhe statistikave kolektive;
- » Trajnimi.

Kreu 6 është një përmbledhje fillestare e ndikimit të pandemisë COVID-19 mbi kthimin e pasurive në Ballkanin Perëndimor.

Kreu 7 paraqet përfundimet mbi situatën aktuale sipas temave dhe rekomandime për zhvillimin e ardhshëm të nevojshëm në rajon.

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE

Kthimi i pasurive si objektivi politikash

Sipas standardeve ndërkombëtare^[3], në mënyrë që juridiksionet të synojnë dhe zvogëlojnë në mënyrë efektive aktivitetin kriminal përmes përdorimit të kthimit të pasurisë, kthimi i pasurisë duhet të jetë një fokus specifik i ministrave, politikëbërësve,

[3] Rekomandimi nr. 2 i FATF-së, Politikat dhe koordinimi i LPP/LFT - Vendet duhet të kenë politika kombëtare LPP/LFT, të informuara nga rreziqet e identifikuara, të cilat duhet të rishikohen rregullisht, dhe duhet të caktojnë një autoritet ose të kenë një koordinim ose mekanizëm tjetër që është përgjegjës për politika të tilla.

ligjvënësve dhe profesionistëve në të gjitha agjencitë. Kjo mund të ndodhë plotësisht nëse kthimi i pasurive është një *objektiv politikash*. Për pasojë, nëse të gjitha agjencitë e përfshira nuk punojnë drejt një qëllimi të përbashkët, ndryshimi nuk do të ndodhë. Sigurimi i kthimit të pasurive si objektiv i politikave kërkon vullnet të fortë politik. Kthimi i pasurive është në agjendën e politikave në të gjitha sistemet gjyqësore të rajonit. Megjithatë, ai shfaqet si një aspekt brenda një përzierjeje strategjish dhe jo si një fokus specifik. Ky raport sugjeron ngritjen e profilit të politikave të kthimit të pasurive duke caktuar një koordinator kombëtar të kthimit të pasurive të nivelit të lartë për të drejtuar politikën në strategji të ndryshme.

Dispozitat ligjore për ngrirjen, konfiskimin dhe sekuestrimin në kuadrin e kthimit të pasurive

Ballkani Perëndimor ka bërë një përparim të madh lidhur me legjislacionin për kthimin e pasurive. Shumë juridiksione tashmë kanë ndryshuar Kodet Penale dhe Kodet e Procedurave Penale, ose janë në proces të këtyre ndryshimeve, ose po planifikojnë t'i bëjnë ato. Në mënyrë të veçantë, shumica e juridiksioneve kanë krijuar legjislacion të veçantë për kthimin e pasurive, i cili përmban dispozita të ndryshme në lidhje me kthimin e pasurive, por kryesisht drejtohet nga miratimi i legjislacionit të “konfiskimit të zgjeruar” të sjellë nga standardet evropiane. Ky është një hap progresiv për rajonin dhe duhet vlerësuar.

Zbatimi i dispozitave të konfiskimit të zgjeruar vazhdon të sfidojë hetuesit, prokurorët dhe gjyqtarët. Atësitë e hetimit financiar të nevojshme për të lidhur pasuritë me pronarë dhe vepra të caktuara, për të dëshmuar pasuri joproporcionale dhe për të bindur gjykatën për standardin penal se pasuritë janë të paligjshme, janë ndër problemet kryesore të hasura. Ndryshimi i legjislacionit për të zvogëluar standardin provues mbi ligjshmërinë e pasurive në nivelin e standardit civil të “bilancit të probabilitetit” dhe futja e “prezumimeve” automatike që mund të nxjerrë gjykata se pasuritë kanë ardhur si rezultat i të ardhurave nga krimi, do të ndihmonin në zbatimin e ligjit. Mungesa e trajnimeve dhe mentorimit për zbatimin e dispozitave të konfiskimit të zgjeruar është gjithashtu një pengesë për përdorimin e suksesshëm të tij. Ekzistojnë shembuj të shkëlqyer të rasteve të suksesshme, disa prej të cilave përfshihen në raportin e qendrës AIRE dhe RAI-it “*Mbi zbatimin efektiv të masave të kthimit të pasurive në Ballkanin Perëndimor: vështrim i përgjithshëm i metodologjisë rajonale të monitorimit, treguesit kryesorë krahasimorë dhe raste studimore të praktikave të mira (2020)*”. Këto raste duhet të ndahen si brenda vendit, ashtu edhe brenda rajonit, si në nivelin ndërqeveritar, ashtu edhe midis forumeve publike dhe organizatave të shoqërisë civile, për të ndihmuar për ndryshimin e çdo perceptimi negativ publik të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ky raport rekomandon monitorimin e vazhdueshëm të praktikës gjyqësore, të vendimeve të konfiskimit të zgjeruar, si edhe trajnim dhe mentorim të mëtejshëm.

Konfiskimi civil ose administrativ i bazuar në mosdënim

Kuadri ligjor i juridiksioneve në rajonin e Ballkanit Perëndimor ende nuk parashikon konfiskimin e pasurisë së krijuar me anë të produkteve të krimit pa dënim, në proceset gjyqësore civile ose administrative *in-rem* (në vend të *in person*). Ligjvënësit, aktualisht,

janë përqendruar te zbatimi i suksesshëm i konfiskimit të zgjeruar, i cili mund të shihet si një hap i përkohshëm për futjen e dispozitave të plota të “konfiskimit civil të bazuar në mosdënim” ose dispozitave civile “të pasurisë së pashpjeguar”. Megjithatë, rekomandohet që juridiksionet e Ballkanit Perëndimor ende të shqyrtojnë mundësinë e miratimit të konfiskimit civil të bazuar në mosdënim në të ardhmen.

Hetimi financiar

Raportet e mëparshme qendrës AIRE dhe RAI-t kanë arritur në përfundimin se aftësia për të kryer hetime financiare si nga organet e zbatimit të ligjit, ashtu edhe nga prokurorët është e ulët. Në përgjithësi, dhe jo çuditërisht, duke pasur parasysh kohën e shkurtër që nga fillimi i projektit, situata mbetet e njëjtë. Gjatë analizimit të informacionit brenda manualeve të qendrës AIRE dhe RAI-t, është e qartë se problemi nuk është te legjislacioni, i cili parashikon në mënyrë adekuate teknikat e hetimit dhe përcakton kushtet dhe objektivat e hetimit financiar. Çështjet shqetësuese kanë të bëjnë me kapacitetet dhe aftësitë jo vetëm brenda njësive të specializuara, por në të gjitha agjencitë hetimore penale dhe prokuroriale. Ky ndryshim kërkon vullnet politik për të përfshirë integrimin e hetimit financiar, i cili aktualisht mungon. Brenda kohëzgjatjes së projektit, koordinatorët kombëtarë raportuan se kapacitetet e hetimit financiar janë rritur brenda njësive të specializuara, prokurorive speciale dhe njësive të hetimit financiar, por në të gjitha rastet u deklarua se ato ende nuk janë të mjaftueshme për të përballuar nivelin e punës. Prandaj, ky raport përsëri rekomandon integrimin e përgjithshëm të hetimit financiar në të gjitha njësitë prokuroriale dhe hetimore dhe trajnimin e mëtejshëm specifik për kthimin e pasurive.

Zyra e kthimit të pasurive

Kjo është një fushë tjetër ku është bërë përparim i madh në periudhën e projektit. Në nivelin politik ka një pranim të qartë të nevojës për të caktuar zyrtarisht një zyrë kombëtare të kthimit të pasurive dhe juridiksionet (e vendeve të rajonit) e kanë këtë në qendër të vëmendjes me seriozitet, megjithëse gjenden në faza të ndryshme të procesit. Përcaktimi i një zyre për kthimin e pasurive është vetëm fillimi, ndërkohë që juridiksionet do të kërkojnë ende mbështetje për t'i sjellë këto zyra në një nivel të mirë lidhur me kapacitetet dhe efektivitetin. Nevojitet më shumë punë, për shembull në rastin e Bosnjë dhe Hercegovinës, dhe trajtimin e rekomandimit që zyra e kthimit së pasurive të caktohet në nivelin e entiteteve dhe në nivelin shtetëror, siç është rasti në Republika Srpska (RS). Ky dhe rekomandime të tjera të lidhura janë përfshirë në këtë raport.

Administrimi i pasurive

Administrimi i pasurisë përgjatë ciklit të plotë të kthimit të pasurive është pjesë e veçantë, por integrale e procesit, i cili ka ndikim mbi hetuesit, prokurorët dhe gjykatat, përveç çdo zyre kombëtare të administrimit të pasurisë që është krijuar. Është e rëndësishme që, ndërsa përgjegjësia për administrimin e pasurisë duhet t'i takojë fort administratorit kombëtar të pasurive, prokurorët duhet të jenë të vetëdijshëm për detyrimet e tyre në lidhje me procesin. Juridiksionet brenda rajonit janë në faza të ndryshme të zhvillimit, por janë dukshëm më larg nga shumë rajone në botë sa

i përket legjislacioni dhe kapacitetit të administrimit të pasurisë. Raporti fillestar i AIRE-RAI-t i vitit 2018 theksoi problemet në vlerësimin e pasurisë. Ky raport arriti në përfundimin se aftësia për të vlerësuar pasuritë ekziston brenda zyrave të caktuara për administrim të pasurive, megjithatë këto zyra nuk janë të mandatuara ligjërisht për të siguruar mbështetje vlerësimi për prokurorët derisa gjykata të ketë lëshuar urdhrin e saj për sekuestrim. Legjislacioni dhe proceset e kthimit të pasurive duhet të ndryshohen për t'u siguruar që zyrat e administrimit të pasurisë të ofrojnë këshilla thelbësore të parakonfiskimit, në formën e planifikimit para konfiskimit.

Administratorëve të pasurisë brenda zyrave të administrimit (ZAP) u kërkohet të jenë të vetëdijshëm për fazat e një çështjeje në mënyrë që të përgatiten për të administruar më tej pasuritë e lidhura me çështjet, ose t'i shesin ato. Kjo bëhet më mirë kur ZAP-ja, prokurori dhe gjykatat janë të lidhura në mënyrë elektronike. Asnjë nga ZAP-të e Ballkanit Perëndimor nuk është e lidhur në këtë mënyrë, duke u mbështetur kryesisht te posta standarde, posta elektronike ose telefoni për të marrë njoftimin e ndryshimeve në urdhrat e ngrirjes dhe të konfiskimit, për shembull, pas apelimit. Prandaj kërkohet punë e mëtejshme për të digjitalizuar si procesin e administrimit të pasurive përmes futjes së regjistrave të pasurisë, edhe sistemet që lidhin në mënyrë elektronike agjencitë e përfshira në ciklin e pasurive.

Ripërdorimi i pasurisë së konfiskuar

Ripërdorimi i pasurisë së konfiskuar që nuk janë objekt i kompensimit të viktimave për qëllime sociale ose gjyqësore është një praktikë në rritje në të gjithë botën dhe është përfshirë në Instrumentin më të fundit të BE-së për Ngrirjen dhe Konfiskimin^[4]. Ripërdorimi sociale dhe shtetëror i pasurisë është një mundësi dhe aspekt i procesit që shpesh neglizhohet nga qeveria. Megjithatë jo të gjitha juridiksionet në rajon kanë sisteme të strukturuar dhe të ligjësuara për ripërdorim, ekzistojnë disa shembuj të shkëlqyeshëm (Shqipëria dhe Serbia) dhe ato duhet të referohen edhe nga juridiksionet që dëshirojnë të miratojnë një sistem ripërdorimi.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Gjatë periudhës së projektit rajonal të qendrës AIRE dhe RAI-t, prokurorët raportuan bashkëpunimin ndërkombëtar për kthimin e pasurive si një nga sfidat e tyre më të mëdha, veçanërisht për hetimin dhe gjurmimin e pasurisë gjatë proceseve gjyqësore të konfiskimit të zgjeruar. Mungesa e njohurive rreth mundësive për bashkëpunim, të bazuar në marrëveshje paraprake të mbështetura në traktat, dhe aspektet e teknikës legjislative të lidhura me Ndihmën e Ndërsjellë Juridike (NNJ) sa i takon kthimit të pasurive, e shtynë projektin rajonal të qendrës AIRE dhe RAI-it të ofrojnë një kurs mbi bashkëpunimin ndërkombëtar drejt trajnimit për kthimin e pasurive. Një manual referimi mbi *Mjetet dhe Praktikën më të Mirë për Kthimin e Pasurive Ndërkombëtare*, i prodhuar në lidhje me trajnimin, u është shpërndarë profesionistëve brenda rajonit. Për më tepër, janë realizuar dy vizita studimore me profesionistë të nivelit teknik në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Rumani. Këto vizita rritën nivelin praktik të bashkëpunimit

[4] Direktiva e BE-së 2014/42/BE, neni 10, paragrafi 3: "Shtetet Anëtare shqyrtojnë mundësinë e marrjes së masave që lejojnë përdorimin e pasurisë së konfiskuar për interes publik ose qëllime sociale.

ndërkombëtar midis rajonit dhe Mbretërisë së Bashkuar. Gjithashtu, në nivelin strategjik, ekspertët e kthimit të pasurive në Mbretërinë e Bashkuar ishin në gjendje të shpjegojnë qasjen e MB-së ndaj konfiskimit civil i bazuar në mosdënim dhe urdhrat e pasurisë së pashpjegueshme. Koordinatorët kombëtarë raportuan se si trajnimi, manuali përkatës dhe vizitat studimore kanë qenë shumë të mirëpritura dhe të dobishme, duke kërkuar që i njëjti trajnim t'u ofrohet një numri më të gjerë prokurorësh.

Me synimin për të rritur bashkëpunimin rajonal për kthimin e mëtejshëm të pasurive, përfituesit e projektit kanë propozuar krijimin e një Rrjeti Rajonal të Alumnive të qendrës AIRE dhe RAI-t në nivel kombëtar dhe rajonal. Ky rrjet do të përbëhet nga pjesëmarrës në aktivitetet e trajnimit të projektit dhe në vizitat studimore dhe do të krijohet në secilin juridiksion përfitues për të siguruar qëndrueshmërinë e rezultateve të projektit. Në takimet kombëtare të alumnive të zhvilluar nga Koordinatorët Kombëtarë të Projektit (KK), ata tashmë kanë identifikuar një sërë problemesh praktike të cilat mund të trajtohen në nivelin rajonal.

Matja e efektivitetit dhe statistikave të mbledhura

Një faktor kryesor për matjen e efektivitetit të çdo sistemi të kthimit të pasurive janë statistikave. Duke e ditur këtë, BE-ja ka përfshirë regjistrimin dhe raportimin e statistikave në instrumentet më të fundit të kthimit të pasurive të BE-së. Megjithatë, regjistrimi i saktë, gjithëpërfshirës dhe standard i statistikave të kthimit të pasurive është jashtëzakonisht i vështirë për t'u arritur. Prandaj nuk ishte habi që botimi i parë i qendrës AIRE dhe RAI-t, *“Kthimi i pasurive në Ballkanin Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës (2018)”*, në faqen 73^[5] flet për mungesën e monitorimit dhe mbledhjes së statistikave për kthimin e pasurive në rajon. Kjo nuk është unike vetëm për Ballkanin pasi edhe BE-ja ende po merret me krahasimin e statistikave për sekuestrimet, konfiskimet dhe vlerat e tyre midis Shteteve Anëtare të BE-së (SHA). Në përgjigje të drejtpërdrejtë të kësaj, projekti ka përfunduar kërkime unike për të skicuar situatën në secilin prej juridiksioneve të vendeve anëtare të BP-së, dhe për ta krahasuar atë me standardet më të rëndësishme të nxjerra nga burimet ndërkombëtare, në veçanti nga Bashkimi Evropian, duke arritur kulmin me botimin e qendrës AIRE dhe RAI-t *“Raport mbi zbatimin efektiv të masave të kthimit të pasurive në Ballkanin Perëndimor: përmbledhje e metodologjisë rajonale të monitorimit, standardeve krahasuese dhe studimeve të rasteve të praktikave të mira”*. Ky është një hulumtim novator. Ky raport arrin në përfundimin se mënyra e vetme për të siguruar që statistikave përkatëse të mblidhen me saktësi është përdorimi i një sistemi të përbashkët nga të gjitha agjencitë e përfshira në sekuestro dhe konfiskim. Në mënyrë që të matet efektiviteti i kthimit të pasurive në të gjithë rajonin përmes mbledhjes së statistikave, duhet të inkurajohet një model standard për mbledhjen e statistikave, bazuar në bazën e përshkruar në raportin e AIRE-RAI-t. Hulumtimi fillestar i kryer nga projekti AIRE-RAI inkurajon projekte të ardhshme mbi ndërtimin e kapaciteteve përmes financimit individual dhe mentorimit të specializuar, që synon prodhimin e një sistemi në gjendje të prodhojë statistika në përputhje me standardet e kërkuara.

[5] Në studim përcaktohet «nevoja për mbledhjen e grupeve specifike të të dhënave që do të mundësonin një vlerësim më të mirë të efektivitetit dhe efikasitetit të procesit të kthimit të pasurive, si dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të mbledhjes së të dhënave në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive».

Trajnimi

Ekziston ende një mungesë e dukshme e edukimit dhe trajnimit të specializuar të brendshëm për punonjësit e zbatimit të ligjit në lidhje me hetimin financiar për të gjurmuar dhe identifikuar pasuritë të cilat më vonë mund t'i nënshtrohen konfiskimit. Hetimi i specializuar financiar si për policinë, ashtu edhe për prokurorët, trajnimet për prezantimin e provave financiare para gjykatës dhe trajnimi i mëtejshëm për bashkëpunimin ndërkombëtar janë akoma të kërkuara dhe të nevojshme. Rekomandohet që projektet e mëtejshme të ndërtimit të kapaciteteve të analizojnë nevojat për trajnim të juridiksioneve individuale para se të fillojnë me një trajnim të përgjithshëm që mund të jetë interesant, por jo veçanërisht i dobishëm.

Projekti rajonal AIRE-RAI ka ofruar trajnime të shkëlqyera gjatë dy viteve të fundit për prokurorët dhe gjyqtarët, në një gamë të gjerë temash të lidhura me kthimin e pasurive. Qasja novatore e përdorimit të ekspertëve nga rajoni së bashku me specialistë ndërkombëtarë është theksuar si një praktikë e mirë, me profesionistët rajonalë që i përgjigjen mirë trajnimit nga ekspertët rajonalë. Është e qartë se i gjithë rajoni ka nevojë për ndërtim të mëtejshëm të kapaciteteve për kthimin e pasurive në rajon. Pa këtë mbështetje të vazhdueshme, konfiskimi i produkteve të krimit në rajon do të mbetet në nivelet e ulëta të papranueshme aktuale.

Rezultatet kryesore:

1. Qendra AIRE dhe RAI kanë luajtur një rol unik për zhvillimin e kapaciteteve të kthimit të pasurive në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Përpilimi i tri botimeve specifike rajonale mbi kthimin e pasurive u ka siguruar juridiksioneve të rajonit një ndarje të plotë të ligjit të brendshëm dhe procedurave të kthimit të pasurive, metodologjinë për bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me kthimin e pasurive dhe qasjen për t'u zbatuar gjatë mbledhjes së statistikave të kthimit të pasurive. Rekomandohet fuqimisht që juridiksionet të përdorin përshkrimet e qarta të legjislacionit, institucionet dhe procedurat e përshkruara në botimet e AIRE-RAI-t para dhe në mënyrë që të ndihmojnë për miratimin e dispozitave të reja të kthimit të pasurive dhe strukturave institucionale.
2. Krijimi i rrjetit të alumni si në nivelet kombëtare, edhe në nivelin rajonal ka qenë një propozim kryesor gjatë projektit. Garantimi që profesionistët e rajonit të mbeten të lidhur përmes zhvillimit të legjislacionit, politikave dhe procedurave në lidhje me temën në fjalë është shpesh sfidues, teknikisht e ligjërish, dhe shkëmbimi i praktikave të mira dhe i praktikës gjyqësore përkatëse është thelbësor për rritjen e kthimit të pasurive në Ballkanin Perëndimor. Rrjeti Rajonal i Aluminit AIRE-RAI përfaqëson një burim të vlefshëm për përjetësimin e veprimit rajonal për kthimin e pasurive dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, madje edhe përtej projektit.
3. Për të siguruar se kthimi i pasurive mbetet një objektiv politikash, duke nxitur ndryshimin e nevojshëm për të rritur kthimin e pasurive, juridiksionet, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm ose rregullimet kushtetuese, duhet të zhvillojnë një strategji specifike të kthimit të pasurive, një plan veprimi dhe një grup pune. Në krye të Grupit të Punës duhet të emërohet një ekspert i shquar në fushën e tij të pasurisë për të udhëhequr politikat dhe praktikën për kthimin e pasurive në të gjitha agjencitë përkatëse.

4. Duhet të zhvillohet një program rajonal i mbështetjes për zyrat kombëtare të kthimit të pasurisë për të ndihmuar në trajnimin e kolegëve. Për më tepër, zyrat kombëtare të kthimit të pasurive do të përfitonin nga këshillimi i mëtejshëm për të siguruar efektivitet të plotë, në përputhje me legjislacionin e BE-së, praktikatat më të mira dhe treguesit e efektivitetit.
5. Ballkani Perëndimor ka bërë një përparim të madh në fushën e menaxhimit të pasurive jo vetëm gjatë periudhës së projektit, por edhe në vitet para tij, veçanërisht sa i takon ndërtimit të kapaciteteve institucionale, veçanërisht në krijimin e agjencive dhe drejtorive të specializuara. Megjithatë, rekomandohet ndërtimi i mëtejshëm i kapaciteteve në fushën e administrimit të pasurisë në formën e akteve nënligjore, planifikimi para konfiskimit dhe krijimi i regjistrave për pasuritë e konfiskuara dhe të sekuestruara të cilat të ishin të ndërveprueshme me bazat e të dhënave gjyqësore për kthimin e pasurisë.
6. Për të matur efektivitetin e kthimit të pasurive në të gjithë rajonin, duhet të inkurajohet një model standard për mbledhjen e statistikave, bazuar në bazën e përkrahur në raportin e qendrës AIRE dhe RAI-t. Shembuj të mirë të regjistrave elektronikë ekzistojnë në rajon (RPSK-ja e AAPSK-së në Shqipëri, Regjistri i Prokurorisë dhe ai Gjyqësor brenda HJPC-CMS-së në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Regjistri Qendror në Serbi), por juridiksionet ende kanë nevojë për mbështetje me këtë.
7. Nevojiten trajnime të mëtejshme për të rritur aftësitë hetimore për të gjurmuar pasuritë, për të paraqitur çështje të pronësisë mbi pasurinë dhe pasurinë joproporcionale në gjykatë, për të ndihmuar gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe personelin e policisë në njësitë e hetimit financiar, për të kuptuar provat rrethore gjatë procedurave të konfiskimit të zgjeruar dhe për bashkëpunimin ndërkombëtar. Rekomandohet që projektet e mëtejshme të ndërtimit të kapaciteteve të analizojnë nevojat për trajnim të juridiksioneve individuale para se të fillojnë një trajnim të përgjithshëm, i cili mund të jetë interesant, por jo veçanërisht i dobishëm.
8. Me kërkesë të juridiksioneve përfituese, Projekti Rajonal i Qendrës AIRE dhe RAI-t ka mbështetur një diskutim fillestar mbi zhvillimin e një marrëveshjeje rajonale shumëpalëshe të rajonit të Ballkanit Perëndimor për ndarjen e pasurisë midis tri juridiksioneve. Kjo do të sigurojë një bazë ligjore për pasuritë dhe vlerën e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuara në një juridiksion, në emër të juridiksionit të ndjekjes penale, për t'u ndarë midis juridiksioneve të përfshira në çështje. Ky është një model i shkëlqyeshëm i praktikës më të mirë për marrëveshje të tjera të ngjashme të lidhura në rajon.

Shkurtime

AIRE	Këshillim për të Drejtat Individuale në Evropë
KPP	Kundër pastrimit të parave
ZAP	Zyra e Administrimit të Pasurisë
AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (Shqipëri)
AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (Kosovë*)
AASP	Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara (Republika e Maqedonisë)
ZRP	Zyra për Kthimin e Pasurive
PSH	Policia e Shtetit e Shqipërisë
BAMIN	Rrjeti Ndërinstitucional për Administrimin e Pasurive në Ballkan
BD	Distrikti Brčko (Bosnjë dhe Hercegovinë)
BiH	Bosnjë dhe Hercegovinë
CARIN	Rrjeti Ndërinstitucional i Kthimit të Pasurive
KP	Kodi Penal
VKK	Vendimi Kuadër i Këshillit
LFT	Lufta kundër financimit të terrorizmit
KiE	Këshilli i Evropës
KPP	Kodi i Procedurës Penale
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
EUROPOL	Zyra e Policisë Evropiane
ENU	Njësia Kombëtare e Europolit
ETS 141	Konventa për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit
ETS 173	Konventa Evropiane e të Drejtës Penale për Korrupsionin
ETS 182	Protokolli i dytë shtesë i Konventës Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale
ETS 24	Konventa Ndërkombëtare për Ekstradimin
ETS 30	Konventa Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale Shtesë
ETS 99	Protokolli i Konventës Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale
BE	Bashkimi Evropian
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
FBIH	Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës (Bosnjë dhe Hercegovina)
FIU	Njësia e Inteligjencës Financiare
GIZ	The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
GRECO	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
KLGJP	Këshilltari i Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
JHA	Drejtësia dhe Punët e Brendshme

KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës*
LKPK	Ligji për Konfiskimin e Produkteve të Krimin
NNJ	Ndihmë e Ndërsjellë Juridike
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
SHA	Shtetet Anëtare
KBM	Konfiskimi i bazuar në mosdënim
RAI	Iniciativa Rajonale Antikorrupsion
RS	Republika Srpska (Bosnjë dhe Hercegovinë)
RPSC	Regjistri i Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
SEE	Evropa Juglindore
StAR	Rrjeti i Kthimit të Pasurive të Vjedhura
OKB	Kombet e Bashkuara
UNCAC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
UNTOC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar
BP	Ballkani Perëndimor

1. Hyrje

Ashtu si edhe në rajone të tjera të botës, kthimi i pasurive ka marrë vëmendje specifike edhe nga juridiksionet e Ballkanit Perëndimor gjatë 15 viteve të fundit. Si i tillë, rajoni ka marrë një mbështetje të konsiderueshme nga projektet e financuara nga donatorë të jashtëm. Qendra AIRE dhe Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI) kanë luajtur një rol thelbësor në këtë mbështetje. Së bashku me vullnetin politik për të ndryshuar, rajoni tashmë ka arritur një sukses të konsiderueshëm, në shkallë të ndryshme në juridiksione të ndryshme, në miratimin e legjislacionit të kthimit të pasurive, duke marrë parasysh strukturat dhe politikat institucionale, dhe ka inkurajuar praktikën e mirë përmes trajnimit, duke e sjellë atë në përputhje me shumicën e standardeve ndërkombëtare. Arritja e një standardi ndërkombëtar nuk do të thotë domosdoshmërisht se një juridiksion ka një sistem efektiv të kthimit të pasurive dhe mbetet fakt që nivelet e konfiskimit në rajon janë të ulëta.

Si përgjigje, qendra AIRE dhe RAI bashkuan forcat në vitin 2017 për të mbështetur juridiksionet e Ballkanit Perëndimor për të intensifikuar dhe konsoliduar përpjekjet e tyre në nivelin rajonal në fushën e kthimit të pasurive. Hapi i parë i kësaj iniciative ishte kryerja e një analize krahasuese të legjislacionit dhe praktikës në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor. Gjetjet, rekomandimet dhe përparësitë e identifikuara të kësaj analize janë dokumentuar brenda raportit *“Kthimi i pasurive në Ballkanin Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikave”* botuar në vitin 2018. Duke përdorur rekomandimet dhe përparësitë e identifikuara nga ky raport si udhëzues, qendra AIRE dhe RAI kanë bashkëpunuar për të zbatuar një projekt rajonal 2-vjeçar me titull *“Forcimi i punës antikorrupsion në Ballkanin Perëndimor përmes përmirësimit të masave të sekuestrimit të pasurive”* (Projekti Rajonal Antikorrupsion). Gjatë gjithë kësaj periudhe, projekti ka realizuar shumë aktivitete në rajon dhe ka botuar disa raporte, me qëllim rritjen e aftësive për kthimin e pasurive. Projekti është financuar nga Qeveria Britanike. Projekti mbulon juridiksionet e mëposhtme: Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovën*, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Falë mbështetjes së dhënë nga fondacioni *Konrad Adenauer* dhe Sekretariati i RAI-t, është bërë e mundur edhe pjesëmarrja në aktivitete të caktuara për profesionistë nga Bullgaria, Kroacia, Moldavia dhe Rumania. Studimi fillestar i qendrës AIRE 2018 dhe studimi i RAI-t arriti në përfundimin se, megjithëse juridiksionet në rajonin e EJT-së kanë miratuar në një masë të madhe standardet e nevojshme rajonale dhe ndërkombëtare për kthimin e pasurive, zbatimimi i këtyre standardeve mbetet ende “i dobët”. Ky raport synon të mbështetet mbi punën e shkëlqyeshme të kryer nga projekti dhe të vazhdojë me ritmin e zhvillimit të aftësive për kthimin e pasurive në rajon, duke çuar në një rritje të konfiskimit të produkteve të krimit.

Për më tepër, raporti do të shqyrtojë çdo indikacion fillestar të ndikimit të COVID-19-ës mbi kthimin e pasurive, p.sh. tipologjitë e mashtrimit të lidhura me COVID-in, rritjen e rrezikut për korrupsion dhe keqpërdorimin e fondeve publike dhe aftësinë e autoriteteve për të luftuar këto krime.

Raporti është përqendruar si në nivelin kombëtar, edhe në atë rajonal, duke ofruar informacion mbi situatën aktuale në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë*, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, si dhe në rajonin e EJK-së si një e tërë. Përfundimet dhe rekomandimet paraqiten sipas fazës dhe temës së kthimit të pasurive, duke iu referuar juridiksioneve individuale kur është e përshtatshme.

Raporti synon të informojë:

1. Profesionistë të politikave kombëtare dhe vendimmarrës të nivelit të lartë kombëtar të përfshirë në reformën e drejtësisë penale;
2. Koordinatorin Kombëtar të Kthimit të Pasurive;
3. Ligjvënësit dhe politikëbërësit kombëtarë;
4. Gjyqtarët;
5. Profesionistët kombëtarë të kthimit të pasurive si në organet e prokurorisë, ashtu edhe në ato të zbatimit të ligjit, në veçanti kontaktet e rrjeteve CARIN, BAMIN dhe STAR në secilin juridiksion;
6. Drejtuesit e Zyrave Kombëtare të Kthimit të Pasurive dhe Zyrave të Administrimit të Pasurive;
7. Projektet ekzistuese dhe të ardhshme të financuara nga donatorë të jashtëm, të përfshirë në ndërtimin e kapaciteteve për kthimin e pasurive në Ballkanin Perëndimor (AIRE-RAI, BE, KiE, UNODC, GIZ);

2. Metodologjia (fusha e veprimit dhe periudha)

Ky raport vlerëson zhvillimet e kthimit të pasurive në rajon gjatë periudhës nga tetori i vitit 2018 deri në tetor të vitit 2020.

Fillimisht u krye një analizë fillestare e legjislacionit ekzistues rajonal dhe ndërkombëtar dhe praktikës më të mirë për kthimin e pasurive, për të siguruar standardet kundrejt të cilave do të krahasohet secili juridiksion. Këto standarde janë përcaktuar në fillim të raportit, duke treguar futjen e standardeve të reja që nga raporti i fillimit të projektit në vitin 2018.

Më pas u krye një analizë e të gjitha botimeve të projektit, duke siguruar një bazë kundrejt së cilës mund të krahasohen zhvillimet në rajon dhe duke identifikuar fushat prioritare të përcaktuara.

Pas kësaj, u bë një ekzaminim i zhvillimeve në secilin prej juridiksioneve të vendeve të Ballkanit Perëndimor që nga koha kur u shkrua raporti fillestar. U përpilua “model standard raporti” për të shërbyer si plan për mbledhjen e informacionit. Ai u shpërnda për t’u plotësuar nga koordinatorët kombëtarë të projektit AIRE-RAI. Të gjitha burimet e informacionit të disponueshëm u përdorën nga koordinatorët kombëtarë për të mbushur raportet e vendit, përfshirë legjislacionin e brendshëm ekzistues dhe dokumentet e politikave, njohuritë lokale të mbledhura gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit, studimet e rasteve dhe informacionin nga agjencitë përkatëse, ministritë dhe organizatat.

Informacioni që përmbahet në “modelin standard të raportit” u krahasua përkundrejt gjetjeve, përfundimeve dhe përparësive të identifikuara në raportin fillestar, për të vlerësuar nivelin e zhvillimit në secilin juridiksion gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit. Informacioni u krahasua me standardet aktuale dhe ndërkombëtare dhe praktikën më të mira.

Gjetjet e përgjithshme paraqiten me përfundime dhe rekomandime si për rajonin, ashtu edhe për secilin juridiksion individual.

Ky raport nuk është një vlerësim i ndikimit të projektit rajonal AIRE - RAI, megjithatë, në rastet kur aktivitetet e projektit kanë çuar përpara praktikën për kthimin e pasurive, kjo praktikë përmendet në raport.

3. Përkufizime

Më poshtë jepet një listë e fjalëve dhe termave të lidhura me kthimin e pasurive, së bashku me një shpjegim prej profesionisti të kuptimit të tyre dhe përkufizimeve përkatëse të: Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit (UNCAC) dhe Konventës së Varshavës; Këshillit të Evropës (KiE), atje ku ato ekzistojnë.

Kthimi i pasurive

Ky raport e përdor termin “kthimi i pasurive” për të përshkruar të gjitha fazat e procesit për t’i privuar kriminelët nga pasuria e tyre e fituar në mënyrë të paligjshme^[6], duke përfshirë gjurmimin dhe identifikimin e pasurive, ngrirjen dhe konfiskimin, administrimin e pasurive, konfiskimin dhe kthimin, dhe asgjësimin e pasurive.

Pasuritë

“Pasuritë” përfshijnë pasurinë e përdorur për kryerjen e krimit (mjetet) dhe produktet ose të ardhurat e realizuara nga krimi. Produktet e krimit shpesh përshkruhen si “fitim ose përfitim material i krimit”. Produktet e krimit mund të ndahen në: të ardhura të drejtpërdrejta të veprës penale, të referuara gjithashtu si objekti, dhe të ardhura të tërthorta nga krimi. Nëse përdorim shembullin e grabitjes së armatosur të një banke, “mjetet” do të ishin arma e përdorur për të kërcënuar stafin e bankës dhe makina për t’u larguar, “të ardhurat e drejtpërdrejta” do të ishin paratë e marra nga banka dhe “të ardhurat e tërthorta” do të ishin pasuritë e patundshme të blera duke përdorur paratë e marra nga banka.

Instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale i përshkruajnë pasuritë si më poshtë vijon:

“Mjetet” nënkuptojnë çdo pronë të përdorur ose që synohet të përdoret, në çfarëdo mënyre, tërësisht ose pjesërisht, për të kryer një vepër penale ose disa vepra penale. (Konventa e Varshavës e KiE-s A. 1 (c))

“Pronë” do të thotë pasuri e çdo lloji, qoftë trupore ose jotrupore, e tundshme ose e patundshme, materiale ose jomateriale, dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që dëshmojnë titullin ose interesin në pasuri të tilla. (UNCAC A. 2 (d); Konventa e Varshavës e KiE-s, A. 1 (b))

“Produktet e krimit” do të thotë çdo pronë e rrjedhur ose e marrë, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, përmes kryerjes së një vepre penale. (UNCAC A. 2 (e))

“Të ardhura” do të thotë çdo avantazh ekonomik, i rrjedhur ose i marrë, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, nga veprat penale. Ato mund të përbëhen nga çdo pronë siç përcaktohet në këtë nen. (Konventa e Varshavës e KiE-s, A. 1 (a))

[6] Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit e vitit 2005 e përdor termin “kthim pasurish” vetëm për t’iu referuar kompensimit të pasurive të vjedhura përmes korrupsionit.

Gjurmimi dhe identifikimi i pasurive

“Gjurmimi dhe identifikimi i pasurive” përfshin procesin e hetimit penal dhe financiar për të gjetur ose lokalizuar pasuritë, ose brenda juridiksionit që po kryen hetimin penal, ose në një juridiksion tjetër, gjë e cila do të përfshinte një kërkesë ndërkombëtare për gjurmimin e pasurive. Identifikimi i pasurisë synon të zbulojë pronarin ose kontrolluesin e pasurisë.

Ngrirja, sekuestrimi dhe kufizimi

Pas gjurmimit dhe identifikimit të pasurisë, dhe pasi çështja të kalojë në fazën e hetimit të hapur, pasuria duhet t'i nënshtrohet ngrirjes, sekuestrimit ose kufizimit, në mënyrë që të parandalojë lëvizjen e saj në periudhën para vendimit gjyqësor përfundimtar në lidhje me të, në pritje të konfiskimit. Nëse pasuritë nuk ngrihen ose sekuestrohen, autori i dyshuar i veprës mund t'i lëvizë pasuritë në një përpjekje për t'i fshehur ose asgjësuar ato. Ngrirja dhe sekuestrimi zbatohen me urdhër të gjykatës. Kur një pasuri i nënshtrohet një urdhri ngrirjeje, ai mbetet aty ku është, për shembull llogaria bankare e ngrirë mbahet në të njëjtën bankë. Kur një pasuri i nënshtrohet një urdhri konfiskimi, ai merret në zotërim nga shteti, për shembull në rastin e sekuestrimit të një makine. Ngrirja dhe sekuestrimi përshkruhet gjithashtu si “sekuestro”.

Termi “kufizim” përdoret për të përshkruar përkohësisht ndalimin e transferimit, konvertimit, disponimit ose lëvizjes së pronës në pronësi të një personi të caktuar, gjithashtu me anë të një urdhri nga gjykata. Në këtë rast, pasuria zakonisht qëndrojnë me pronarin. Një urdhër kufizimi vendoset mbi një individ jo mbi një pronë ose pasuri, megjithëse pasuria përshkruhet si “e kufizuar” ose objekt i një urdhri kufizimi.

“Ngrirje” ose “sekuestrim” do të thotë ndalim i përkohshëm i transferimit, konvertimit, disponimit ose lëvizjes së pronës, ose marrja përkohësisht e kujdestarisë ose kontrollit të pronës në bazë të një urdhri të lëshuar nga një gjykatë ose një autoritet tjetër kompetent. (UNAC A. 2 (f) ; Konventa e Varshavës e KiE-s A. 1 (g))

Konfiskimi

“Konfiskimi” është procesi i privimit të përhershëm të autorit të veprës nga produktet ose të ardhurat e krimit pas vendimit përfundimtar të gjykatës. Konfiskimi zakonisht përdoret për të përshkruar procesin e privimit të përhershëm të autorit nga mjetet ose pasuritë e paligjshme, të tilla si droga ose armët e zjarrit, ose para ose pas marrjes së vendimit përfundimtar nga gjykata. Megjithatë, fjalët *confiscation* dhe *forfeiture* në gjuhën angleze përdoren në disa juridiksione për t'iu referuar të dyja konfiskimit. Ato mund të përdoren në vend të njëra-tjetrës.

“Konfiskimi”, i cili përfshin humbjen e pasurisë kur është e zbatueshme, do të thotë privimi i përhershëm nga pasuria me një urdhër gjykate, ose me urdhër të një autoriteti tjetër kompetent. (UNCAC A. 2 (g))

“Konfiskim” do të thotë një dënim ose një masë e urdhëruar nga gjykata pas proceseve gjyqësore të lidhura me një vepër penale ose me disa vepra penale që çojnë në privimin përfundimtar nga pasuria.

Konfiskimi i bazuar në mosdënim

“Konfiskimi i bazuar në mosdënim” është procesi i konfiskimit të pasurisë pa dënimin i një personi të veçantë për një veprë penale në lidhje me pasuritë në fjalë. Ky lloj konfiskimi mund të ndodhë si në proceset penale, ashtu edhe në ato civile. Më poshtë jepen katër shembuj të konfiskimit të bazuar në mosdënim.

a) Konfiskimi i produkteve të krimit dhe i mjeteve kriminale gjatë ndjekjes penale, në rrethanat kur çështja është provuar, por dënimi nuk është i mundur për shkak të vdekjes, mospranisë ose sëmundjes mendore të autorit të krimit, ose për arsye të tjera që parandalojnë një dënim përfundimtar.

b) Konfiskimi i zgjeruar

“Konfiskimi i zgjeruar” ndodh në rastet kur konfiskohen edhe pasuria që nuk janë objekt i veprës për të cilën kriminelin ka dalë para gjykatës. Në këtë rast, konfiskimi “shtrihet” edhe mbi pasuritë, të cilat nuk përbëjnë mjete, të ardhura të drejtpërdrejta ose të tërthorta të krimit, të cilat ndiqen penalisht. Konfiskimi i zgjeruar aplikohet jo vetëm në lidhje me veprën e veçantë për të cilën është dënuar një autor veprë, por shtrihet për të përfshirë të gjitha përfitimet e marra nga aktiviteti kriminal në përgjithësi. Autoriteteve nuk u kërkohet të krijojnë një lidhje midis pasurive të dyshuara kriminale dhe sjelljes specifike kriminale për të cilën akuzohet personi. Konfiskimi mund të bazohet në prova ose në përfundime rrethore. Mungesa e rakordimit midis pasurive të një personi dhe burimeve të tij/saj të ligjshme të të ardhurave dhe/ose provat e përgjithshme të përfshirjes në një sjellje kriminale fitimprurëse mund të jenë pjesë e justifikimit për “zgjerimin” e konfiskimit edhe mbi pasuritë e tjera (p.sh. prania e një modeli dënimesh, provat për pjesëmarrjen në një organizatë kriminale, etj.). Meqenëse shumë prej këtyre termave bazohen shumë te perceptimi, vendet shpesh përpiqen t'i përshtatin ato sipas legjislacionit ose praktikave të tyre. Prandaj, përveç sa më sipër, disa vende gjithashtu klasifikojnë tatimin e produkteve të krimit si një formë e konfiskimit të zgjeruar.

c) Konfiskimi civil

“Konfiskimi civil” është një veprim *in rem* që kërkon prova që dëshmojnë se pasuria është një instrument i krimit ose i të ardhurave kriminale, por nuk kërkon vërtetimin e fajit të një individi përtej dyshimit të arsyeshëm.

d) Pasuria e pashpjeguar

“Pasuria e pashpjegueshme” është rasti kur një person zotëron ose gëzon një nivel pasurie që nuk mund ta ketë fituar ligjërisht ose që nuk mund të shpjegohet me asnjë mjet tjetër, të tilla si: trashëgimia, fitimi i një lotarie ose një dhurate.

Konfiskimi i bazuar në objekt

“Konfiskimi i bazuar në objekt” është konfiskimi i pronës ekzakte, reale që rezulton të jetë produkt ose instrument i krimit.

Konfiskimi “i bazuar në vlerë” ose konfiskimi me “zëvendësim vlerë”

“Konfiskimi i bazuar në vlerë” është kompensimi kur një person i dënuar urdhërohet të paguajë një shumë parash të barasvlershme me vlerën e përfitimit kriminal. Gjykata

ose autoriteti kompetent llogarit “përfitimin” për autorin e dënuar për një vepër të veçantë. Urdhri i konfiskimit bëhet për shumën e kësaj vlere. Në këtë rast, gjykata nuk merret me instrumentet aktuale (përveç nëse ato janë pasuri të paligjshme, të tilla si armë zjarri ose drogë) dhe të ardhura të paligjshme, por përqendrohet te shuma ekuivalente me përfitimin kriminal të përfituar nga personi në fjalë. Urdhri i konfiskimit mund të përmbushet ose “paguhet” nga autori i veprës duke përdorur çdo mjet në dispozicion të tyre, përfshirë pasuritë e ligjshme.

Shpesh, mjetet apo të ardhurat aktuale nuk janë më në posedim të autorit të dënuar kur vjen koha për të nxjerrë urdhrin e konfiskimit. Zëvendësimi i vlerës lejon përcaktimin e vlerës së të ardhurave dhe/ose instrumenteve të krimit dhe përdor vlerë ekuivalente për t’u konfiskuar si “zëvendësim” i instrumenteve ose të ardhurave aktuale.

Konvertimi i pasurive

Pasuritë konvertohen kur ato shndërrohen nga pasuri, mallra ose shërbime, në para *cash* përmes një shitjeje.

Deponimi i pasurive

“Deponimi i pasurive” është procesi i shitjes ose shkatërrimit të një pasurie.

Marrëveshja për ndarjen e pasurive

“Marrëveshja për ndarjen e pasurive” është një dokument që përcakton marrëveshjen midis dy ose shumë shteteve për ndarjen e pasurive, në rastet kur pasuritë në lidhje me shtetin hetues ose ndjekës penal kufizohen dhe menaxhohen nga një shtet tjetër. Për shembull, shtetet mund të vendosin të ndajnë produktet e krimit 50/50 midis dy shteteve të përfshira.

Ligji për Konfiskimin e Produkteve të Krimit (LPKP)

Ligji për Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe shkurtesa e tij LKPK është një term i përgjithshëm i përdorur gjatë këtij botimi dhe brenda doracakut të qendrës AIRE-RAI “*Mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)*” për të përshkruar legjislacionin dytësor të miratuar posaçërisht për kthimin e pasurive, emërtimet e të cilave ndryshojnë. Për shembull, për BiH shkurtesa LKPK përdoret për t’iu referuar ligjit LKPK të FBiH, emërtimi i plotë i të cilit është ligji “Për konfiskimin e produkteve të krimit” (Zakon o oduzimanju nezakonito stečene imovine krivičnim djelom); LKPK-ja e RS-së quhet Ligji “Për Konfiskimin e të Ardhurave të Krimit” (Zakon o oduzimanju nezakonito stečene imovine krivičnim djelom); në RS LKAK-ja quhet Ligji “Për konfiskimin e pronës së fituar në mënyrë të paligjshme” (Zakon o oduzimanju nezakonito stečene imovine). LKPK-ja në Shqipëri është Ligji Antimafia dhe në Malin e Zi emërtimi i ligjit është “Për sekuestrimin dhe konfiskimin e përfitimit material që rrjedh nga aktivitetet kriminale”.

4. Standardet ndërkombëtare dhe evropiane për kthimin e pasurive

Në këtë kre jepet një përmbledhje e standardeve ndërkombëtare (OKB, FATF) dhe e standardeve evropiane (KiE, BE) të zhvilluara për të siguruar kthim efektiv të pasurive në nivelin kombëtar dhe në nivelin ndërkombëtar.

4.1 Konventat e Kombeve të Bashkuara

Ekzistojnë dy konventa të OKB-së të cilat trajtojnë kthimin e pasurive: Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (UNTOC)^[7] e vitit 2000 dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit (UNCAC)^[8] e vitit 2005. Të gjitha juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, përveç Kosovës,* janë palë në të dyja konventat. Përveç trajtimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar ndërkombëtar (KO), të dyja konventat përfshijnë gjithashtu edhe dispozita të bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me gjurmimin dhe identifikimin e pasurive të paligjshme, si dhe me ngrirjen, sekuestrimin, konfiskimin dhe asgjësimin e këtyre pasurive. UNTOC-u e trajton bashkëpunimin ndërkombëtar në lidhje me hetimet financiare duke përfshirë kthimin e pasurive të paligjshme (neni 12-13), asgjësimin e të ardhurave të konfiskuara (neni 14) dhe ndihmën e ndërsjellë juridike (neni 18) ose hetimet e përbashkëta (neni 19). Krimet në lidhje me korrupsionin trajtohen në mënyrë specifike nga UNCAC-u. Për këto krime, koncepti i “kthimit të pasurive” përmendet specifikisht dhe shtjellohet më tej në kreun V – Kthimi i pasurive (nenet 51-59). Nenet 53 deri në 55 të UNCAC-it kanë të bëjnë me njohjen e urdhrave të konfiskimit edhe pa dënime penale. Kthimi dhe asgjësimi i pasurive të konfiskuara mbulohet nga neni 57.

4.2 Rekomandimet e FATF-së

FATF-ja (ose GAFI^[9] në frëngjisht) është një organizatë ndërqeveritare e themeluar në vitin 1989, e cila aktualisht merret me parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare në lidhje me këto aktivitete. Standardet e vendosura nga ky organ politikëbërjeje i njohur globalisht, gjithashtu, synojnë bashkëpunimin ndërkombëtar (rekomandimet 36 deri 40 të rekomandimeve fillestare të FATF-së të vitit 2012, përditësimi në vitin 2019).

Në veçanti rekomandimet 4 dhe 38 dhe shënimet e tyre interpretuese mbulojnë ndihmën e ndërsjellë juridike në lidhje me ngrirjen dhe konfiskimin e pasurive të paligjshme. Në fakt, jepen edhe udhëzime për procesin e kthimit të pasurive si të tillë, duke përfshirë gjithashtu edhe konfiskimin e bazuar në mosdënim.

[7] UNGA Res. 55/25, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar Transnacional, UN Doc. A/RES/55/25 (8 janar 2001).

[8] UNGA Res. 58/4, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit, UN Doc. A/RES/58/4 (21 nëntor 2003).

[9] Groupe d'action financière (GAFI).

4.3 Këshilli i Evropës

Disa traktate dhe rekomandime shumëpalëshe të KiE-s kanë të bëjnë me ose janë të rëndësishme për procesin e kthimit të pasurive. Ato përfshijnë Konventën evropiane për ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale (Konventa MLA) të vitit 1959, dhe protokollin e saj shtesë të vitit 1978 dhe protokollin e dytë shtesë të vitit 2001^[10]; Rekomandimin nr. R (88) 18 të miratuar nga Komiteti i Ministrave i KiE-s i vitit 1988 mbi përgjegjësinë e ndërmarrjeve për kundërvajtje^[11]; Konventën evropiane për pastrimin e parave, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi (Konventa e Strasburgut) e vitit 1990^[12]; Konventën evropiane të së drejtës penale për korrupsionin të vitit 1999 (Konventa e Strasburgut 1999) dhe protokollin i saj shtesë të vitit 2003^[13]; dhe Konventën e KiE-s për pastrimin e parave, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe mbi financimin e terrorizmit të vitit 2005 (Konventa e Varshavës)^[14].

Me përjashtim të Kosovës* dhe Bosnjë-Hercegovinës^[15] (BiH) të gjitha juridiksionet e Ballkanit Perëndimor kanë miratuar dhe ratifikuar traktatet e KiE-s.

Në vitin 1999, KiE themeloi gjithashtu Grupin e Shteteve Kundër Korrupsionit^[16] (GRECO), i cili është organi monitorues antikorrupsion i Këshillit. Anëtarësimi nuk është i kufizuar vetëm te shtetet anëtare të KiE-s. Objektivi kryesor i GRECO-s është të përmirësojë aftësinë e anëtarëve të saj për të luftuar korrupsionin duke analizuar nëse shtetet anëtare janë në përputhje me standardet antikorrupsion të KiE-s. Kjo arrihet përmes një procesi dinamik të monitorimit të vlerësimeve të ndërsjella. GRECO përfshin gjithashtu edhe procesin e kthimit të pasurive dhe zbatimin e standardeve dhe instrumenteve përkatëse.

4.4 Bashkimi Evropian

BE-ja ka miratuar legjislacion të konsiderueshëm në lidhje me procesin e kthimit të pasurive që nga viti 1998, shpesh duke u bazuar ose duke përmirësuar elemente të legjislacionit ekzistues ndërkombëtar. Përderisa juridiksionet e Ballkanit Perëndimor nuk janë shtete anëtare të BE-së, legjislacioni i përshkruar në vijim nuk është i detyrueshëm për ta. Megjithatë, përveç vendosjes së standardeve të reja për procesin e kthimit të pasurive në përgjithësi, të gjitha juridiksionet e Ballkanit Perëndimor janë vende candidate për anëtarësim në BE dhe gjenden aktualisht në faza të ndryshme të pranimit. E rëndësishme për t'u nënvizuar është se zbatimi i legjislacionit të BE-së përbën kërkesë për t'u bërë shtet anëtar i BE-së.

[10] Seritë e traktateve evropiane (ETS) Nr. 30, 99 & 187.

[11] <https://rm.coe.int/16804c5d71>

[12] ETS 141.

[13] ETS 173 & 191.

[14] Seritë e traktateve të Këshillit të Evropës (CETS) 198, përditësimi i Konventës së Strasburgut sa i takon procesit të kthimit të pasurive.

[15] Kosova* nuk është anëtare e KiE-s; Bosnjë dhe Hercegovina nuk e kanë nënshkruar dhe as nuk e kanë ratifikuar protokollin shtesë të Konventës për ndihmë të ndërsjellë juridike (ETS 99).

[16] <https://www.coe.int/en/web/greco>

Prandaj, legjislacioni i mëposhtëm duhet të miratohet nga të gjitha vendet e Ballkanin Perëndimor:

Aksioni i përbashkët 98/699/DPB mbi pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfirmimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi. Ai duhet të mundësojë shteteve anëtare (MS) tashmë në fazat e hershme të hetimit që të identifikojnë dhe gjurmojnë të ardhurat dhe instrumentet e krimit me kërkesë të një shteti tjetër anëtar;

Vendimi kuadër i Këshillit 2001/500/DPB mbi pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfirmimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi. Ai përfshin dy elemente kryesore. Së pari, shteteve anëtare u kërkohet të zbatojnë sisteme të konfiskimit të bazuara mbi vlerën përkatëse jo vetëm për proceset e brendshme gjyqësore, por edhe për ato të huaja. Së dyti, kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike në lidhje me kthimin e pasurive kërkohet të kenë të njëjtën përparësi si kërkesat e brendshme;

Vendimi kuadër i Këshillit 2003/577/DPB mbi ekzekutimin në Bashkimin Evropian të urdhrave për ngrirjen e pasurisë ose provave. Ai prezantoi parimin e njohjes së ndërsjellë të urdhrave të ngrirjes dhe konfiskimit. E rëndësishme është që ky vendim lejon gjithashtu kontakt të drejtpërdrejtë midis autoriteteve gjyqësore, jo ndryshe nga rregulloret e Shengenit;

Vendimi kuadër i Këshillit 2005/212/DPB mbi konfiskimin e të ardhurave, mjeteve dhe pasurisë së lidhur me krimin. Ai parashikon konfiskimin e pasurive të transferuara te një palë e tretë, si dhe konfiskimin e zgjatur;

Vendimi kuadër i Këshillit 2006/783/DPB mbi zbatimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të urdhrave të konfirmimit. Ai prezantoi parimin e përmendur për urdhrat e konfiskimit;

Vendimi i Këshillit të BE-së 2007/845/DPB në lidhje me bashkëpunimin midis zyrave të kthimit të pasurive të Shteteve Anëtare në fushën e gjurmimit të pasurive dhe identifikimit të të ardhurave të pasurisë ose të pasurisë tjetër të lidhur me krimin (vendimi i Këshillit të ZRA-së). Ai prezantoi detyrimin e krijimit të zyrës së kthimit të pasurive për Shtetet Anëtare të BE-së;

Direktiva 2014/42/BE mbi ngrirjen dhe konfirmimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi në Bashkimin Evropian. Ajo, në një farë mase, thjeshtoi vendimet kuadër të Këshillit të nxjerra në periudhën 2001-2005. Kjo direktivë gjithashtu zhvilloi më tej dispozitat për konfiskimin e bazuar në vlerë dhe konfiskimin e zgjeruar dhe prezantoi dispozita për konfiskimet penale të bazuara në mosdënime, në të cilat i akuzuari është fshehur ose nuk mund të ndiqet penalisht për shkak të sëmundjes. Ajo gjithashtu prezanton, për herë të parë, kërkesën për të mbledhur statistika mbi kthimin e pasurive në nivelin qendror dhe për t'ia dërguar ato çdo vit Komisionit të BE-së;

Rregullorja (BE) 2018/1805 ("Rregullorja e 2018-ës") mbi njohjen reciproke të urdhrave të ngrirjes dhe urdhrave të konfiskimit. Kjo zëvendëson vendimet kuadër të

Këshillit të nxjerra në periudhën 2003-2006 midis shteteve anëtare me qëllim njohjen më të lehtë dhe më të shpejtë të urdhrave të gjykatës. Rregullorja përfshin gjithashtu dispozita për menaxhimin dhe asgjësimin e pasurisë së ngrirë dhe të konfiskuar, kompensimin dhe dëmshpërblimin e viktimave dhe mbledhjen e statistikave për kërkesat ndërkombëtare për të zbatuar urdhrat e ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit. Rregullorja nuk e përfshin konfiskimin e bazuar në mosdënimin e natyrës civile ose administrative. Ajo ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor, 2020;

Direktiva (BE) 2019/1153. Ajo përcakton rregullat që lehtësojnë përdorimin e informacionit financiar dhe informacioneve të tjera për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të disa veprave penale dhe shfuqizon vendimin e Këshillit 2000/642/DPB, duke ofruar rregullat për marrjen dhe përdorimin e informacionit financiar gjatë hetimeve, duke përfshirë gjurmimin e pasurive me qëllim të konfiskimit. Përmes kësaj direktive, ZRA-të kanë qasje në regjistrat kombëtarë të centralizuar të llogarive bankare. Europolit parashikohet të ketë qasje të tërthortë vetëm përmes Njësive Kombëtare të Europolit (NJKE).

5. Vështrim i përgjithshëm mbi juridiksionet

Të dyja publikimet qendrës AIRE dhe RAI-t, përkatësisht “*Kthimi i pasurive në Ballkanin Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës (2018)*”, dhe “*Doracakut mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)*” ofrojnë komente të hollësishme mbi kuadrin ligjor të juridiksioneve të vendeve të BP-së dhe përputhshmërisë së tyre me standardet e kërkuara rajonale dhe ndërkombëtare. Ky kre ofron një përmbledhje të këtyre dispozitave, duke nënvizuar zhvillimet e realizuara që nga fillimi i projektit rajonal AIRE-RAI.

5.1 Shqipëria

Kthimi i pasurive si objektiv politikash

Megjithëse aktualisht nuk ka një strategji kombëtare^[17], komitetet ose plan veprimi specifik për kthimin e pasurive, kthimi i pasurive kriminale mbulohet përmes disa strategjish dhe planesh veprimi kombëtare. Së pari, Strategjia ndërsektoriale 2008-2013 “Për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit për një qeverisje transparente”, u zëvendësua më pas nga “Strategjia ndërsektoriale 2015-2020 kundër korrupsionit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 247, datë 20 mars 2015, e cila ishte ende në fuqi në kohën kur u shkrua ky raport. Përveç kësaj, “Strategjia ndërsektoriale për luftimin e krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe terrorizmit”, miratuar nga VKM nr. 663, datë 7 korrik 2017, gjithashtu mbetet në fuqi. Më tej, Dokumenti Strategjik Kombëtar për Hetimin e Krimit Financiar për periudhën 2009-2015 e përmend gjithashtu kthimin e pasurive.

Plani i veprimit 2020-2030, i miratuar përmes zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Antikorrupsion më 30 prill 2020, përcakton midis objektivave të tij masat në lidhje me: (i) qasjen parandaluese, të tilla si: forcimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike; analizimi i trendëve të korrupsionit; përmirësimi i statistikave për aktivitetet e agjencive të zbatimit të ligjit kundër korrupsionit; mbledhja, përpunimi dhe modernizimi i të dhënave statistikore mbi korrupsionin; mbledhja dhe harmonizimi i të dhënave statistikore për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara me vendim gjykatë për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe përcjellja e tyre në Komisionin Evropian; (ii) qasjen ndëshkuese, të tilla si: monitorimi dhe raportimi i të dhënave statistikore në lidhje me konfiskimet; krijimi i raporteve statistikore dhe formateve të mbledhjes së të dhënave; krijimi i mekanizmave specifikë për të zhvilluar luftën kundër korrupsionit në administrimin dhe menaxhimin e pasurive

[17] Dokumenti i punës i stafit të Komisionit të BE-së, Raporti për Shqipërinë për vitin 2019, i cili e shoqëron dokumentin, Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, Komunikata e vitit 2019 mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së, 29 maj 2019, sugjeron që aktualisht po hartohet një strategji kombëtare e kthimit të pasurive.

të sekuestruara dhe konfiskuara që vijnë si rezultat i korrupsionit përmes krijimit të një grupi pune për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”; krijimi i një regjistri elektronik për mirëmbajtjen dhe raportimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara; si dhe identifikimi i organeve publike ose subjekteve me të drejtë akses në portalin/shërbimet elektronike të AAPSK-së regjistrimi i pasurive të dhëna me qira dhe pasurive në procesin e administrimit; konsolidimi i kapacitetit hetimor duke forcuar strukturat hetimore dhe përdorimi i instrumenteve ligjore si për aspektin e procedurës penale, ashtu edhe atë të inteligjencës; përmirësimi i bashkëpunimit midis agjencive të zbatimit të ligjit të përfshira në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit/rishikimit të marrëveshjeve ekzistuese të lidhura midis institucioneve të zbatimit të ligjit dhe institucioneve të ngarkuara me luftën kundër korrupsionit; rritja e mëtejshme e qasjes në bazat e të dhënave dhe të dhënat elektronike shtetërore për kryerjen e hetimeve përmes ndërfaqes së sistemeve; hartimi i procedurave standarde dhe mekanizmave të bashkëpunimit midis Policisë së Shtetit, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe SPAK-ut; përmirësimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar; dhe përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar.

“Strategjia ndërsektorale për luftimin e krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe terrorizmit”, miratuar me VKN nr. 663, datë 7 korrik 2017, e cila është ende në fuqi, synon të zhvillojë politika të përshtatshme për të përmirësuar më tej standardet e sigurisë në vend, ku, *inter alia*, objektivat dhe politikat strategjike synojnë rritjen e kapaciteteve hetimore dhe orientimin e këtyre strukturave drejt inteligjencës dhe rritjen e efikasitetit në fushën e ndjekjes penale, zbulimit, sekuestrimit, konfiskimit dhe kthimit të pasurive të krijuara nga produktet e krimit.

Pavarësisht faktit se kthimi i pasurive ka vend të konsoliduar në agjendën e politikave, *Transparency International* në raportin e saj të vitit 2019 ka arritur në përfundimin që sekuestrimet dhe konfiskimet e pasurive kriminale në rastet që lidhen me korrupsionin nuk urdhërohen ose kryhen në mënyrë sistematike në Shqipëri. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë i vitit 2019 përshkruan, nën seksionin *Lufta kundër korrupsionit*, që Shqipëria duhet: (i) të bëjë përparim të mëtejshëm drejt krijimit të një historiku solid të sekuestrimeve dhe konfiskimeve të pasurive kriminale që rrjedhin nga aktivitete/vepra penale të lidhura me korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe të rrisë më tej përdorimin e hetimeve financiare; (ii) të hartojë procedura të plota për krijimin e organeve të specializuara antikorrupsion, të përbërë nga Zyra e Prokurorisë Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) dhe Gjykata për të trajtuar çështje të nivelit të lartë të korrupsionit; të sigurojnë burime dhe të sigurojnë bashkëpunim midis këtyre strukturave të reja; (iii) të vazhdojnë të përmirësojnë qasjen në të dhënat elektronike kombëtare për autoritetet e zbatimit të ligjit.

Dispozitat ligjore për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive

Një analizë e hollësishme e dispozitave ligjore të kthimit të pasurive për Shqipërinë përfshihet në botimet e qendrës AIRE dhe RAI-t “*Kthimi i pasurive në Ballkanin*”

Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës (2018)”, në faqen 50-54 dhe në *“Doracakun mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)”* në faqen 51-65. Kjo pjesë përmban një përmbledhje të kësaj analize.

Dispozitat ligjore për sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit në Shqipëri gjenden në KP (2017) dhe KPP (2017). KPK-ja (2017) dhe e ndajnë konfiskimin në 3 kategori: konfiskim provues, konfiskim parandalues dhe konfiskim konservator, të cilat së bashku ofrojnë bazën për konfiskimin e instrumenteve, objekteve të drejtpërdrejta të krimit dhe produkteve të veprës penale. Neni 36 i KP-së përcakton dispozitat për konfiskimin penal. Për më tepër, ligji nr. 10192, datë 3 dhjetor 2009, “Për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit përmes masave parandaluese kundër pronës”, i ashtuquajtur “Ligji Antimafia” (LAM), i ndryshuar në 2017 dhe kohët e fundit me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020, përcakton dispozitat për sekuestrimin dhe konfiskimin parandalues, duke siguruar gjithashtu edhe mundësi të konfiskimit të zgjeruar brenda sistemit shqiptar. LAM, në nenin 12, lejon kapjen dhe konfiskimin e bazuar në vlerë, duke deklaruar se edhe pasuritë e tjera përveç atyre që janë objekt sekuestrimi, madje edhe ato me origjinë të ligjshme, mund t’i nënshtrohen sekuestrimit dhe konfiskimit, në rast se pronari i tyre i ligjshëm disponon pronën ose me marrëveshje ndërmjet prokurorit dhe pronarit të ligjshëm të pronës. Miratimi i Ligjit Antimafia mund të shihet si një histori kryesore suksesi për Shqipërinë, duke çuar, për shembull, në një rritje me 2.1 herë të vlerës së pasurive të sekuestruara në vitin e parë të ligjit, krahasuar me vitin 2010. Megjithatë, dispozitat e parashikuara në këtë ligj raportohen se përdoren më gjerësisht sesa ligjet “klasike” të konfiskimit penal në përputhje me nenin 36 të Kodit Penal, i cili është i detyrueshëm dhe zbatohet për të gjitha veprat penale^[18]. Nevojitet punë e mëtejshme për të linjësuar sekuestrimin dhe konfiskimin në të gjitha ndjekjet penale, përveç atyre që bien në fushën e veprimit të Ligjit Antimafia.

KPP-ja, në nenin 352, parashikon konfiskimin e pasurisë në mungesë të të pandehurit ose kur autori i veprës deklarohet “që nuk gjendet”.

Sipas nenit 3 të Ligjit Antimafia, gjykata mund të urdhërojë sekuestrim ose konfiskim edhe pas vdekjes së të dyshuarit, në llogari të të afërmeve të tij, ose personave fizikë ose juridikë nën kontrollin e tij. Pasuritë e të dyshuarve të vdekur mund t’u konfiskohen pasardhësve të tyre të ligjshëm.

Konfiskimi i zgjeruar

Ligji Antimafia, i plotësuar me KPP-ja (2017), i siguron Shqipërisë dispozita të konfiskimit të zgjeruar, të bazuar në mosdënim. Dy kriteret kryesore për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar në Shqipëri janë pjesëmarrja në veprimtari kriminale dhe gjendja e pajustificuar ekonomike. Barra e provës se pasuritë rrjedhin nga aktiviteti kriminal fillimisht bie mbi prokurorin, pas së cilës i dyshuari ka të drejtë përgjigjeje, me

[18] Dokumenti i punës i stafit të Komisionit të BE-së, Raporti për Shqipërinë për vitin 2019, i cili e shoqëron dokumentin, Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, Komunikata e vitit 2019 për Politikën e Zgjerimit të BE-së.

barrën e provës për të treguar ligjshmërinë e pasurisë që kalon te i pandehuri. Zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe prokurorët vazhdojnë të përballen me sfida sa i takon zbatimin të ligjeve që parashikojnë konfiskim të zgjeruar brenda Ligjit Antimafia. Trajnime të mëtejshme lidhur me këtë pikë ishin planifikuar brenda programit të Këshillit Gjyqësor për gjysmën e parë të vitit 2020, por u shtynë për shkak të pandemisë COVID-19.

Në një lëvizje pozitive për të përmirësuar fokusin proaktiv të hetimit penal dhe financiar, është krijuar një “task-forcë” e posaçme multidisiplinare në bazë të planit të veprimit “Fuqia e ligjit”. Më konkretisht, që nga fillimi i projektit rajonal të qendrës AIRE dhe RAI-t, është miratuar një akt normativ i Këshillit të Ministrave, nr. 1, datë 31 janar 2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike” si mjet ligjor për task-forcën. Kjo ka çuar në sekuestrim të pasurive në një numër të madh rastesh. Këto dispozita kanë efekt të përkohshëm dhe do të zbatohen deri më 31 dhjetor 2020.

Një paketë e mëtejshme ndryshimesh në ligjet në Shqipëri është aktualisht në proces, përfshirë edhe ndryshimet në dispozitat e kthimit të pasurive. Ndryshime në kuadrin ligjor dhe institucional të kthimit të pasurive u propozuan nga Këshilli i Ministrave më 6 shkurt 2020, duke u përqendruar tek organizimi dhe funksionimi i AAPSK-së dhe zyrës së kthimit të pasurive, e cila do të krijohet së shpejti. Ligji për administrimin e pasurive, ligji nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i cili u miratua në 17 qershor 2019 dhe hyri në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, u ndryshua me ligjin nr. 19/2020 “Për disa shtesat dhe ndryshime në ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, miratuar në 5 mars 2020.

Ligji Antimafia është ndryshuar me ligjin nr. 85/2020, datë 2.07.2020. Pjesa tjetër e paketës që mbulon ndryshimet e KP-së dhe KPP-së nuk është miratuar ende. Deri në hyrjen në fuqi kohët e fundit të ndryshimeve në LAM nuk ka qenë e mundur të zbatohen ndryshimet e ligjit nr. 34/2019 për veprimtaritë e AAPSK-së. Paketa u propozua në 6 shkurt 2020 dhe u miratua të njëjtën ditë. Kjo ka qenë e dobishme për rastet e kthimit të pasurive që aktualisht janë duke vazhduar nën kuadrin ligjor në fuqi, përfshirë aktin normativ nr. 1, datë 31.01.2020, i cili ka fuqi të përkohshme deri në fund të vitit 2020.

Hetimi financiar

Raportet e mëparshme të qendrës AIRE – RAI kanë arritur në përfundimin se, në përgjithësi, aftësia për të kryer hetime financiare si nga agjencitë e zbatimit të ligjit, ashtu edhe nga prokurorët është e ulët. Nuk ka mjaftueshëm persona me aftësi për të kryer hetime financiare të dedikuara posaçërisht për kthimin e pasurive. BE-ja raportoi në vitin 2019 që strukturave të zbatimit të ligjit dhe zyrat e prokurorisë duhet të trajnohen më tej në teknikat e hetimit financiar për të përmirësuar kapacitetin e tyre për të hetuar pasuritë e pajustificuara.

Hetimet paralele financiare ende nuk kryhen në mënyrë sistematike në proceset penale që përfshijnë pasuritë që rrjedhin nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda,

dhe efektiviteti i tyre është i kufizuar. Krijimi i Task-Forcës së Fuqisë së Ligjit ka përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Policisë së Shtetit dhe autoriteteve të ndjekjes penale.

Një faktor tjetër jetik për hetimin efektiv financiar për të gjurmuar dhe identifikuar pasuritë është aftësia për të hyrë shpejt dhe drejtpërdrejt në bazat përkatëse të të dhënave dhe burime të tjera të informacionit. Policisë dhe prokurorëve u është dhënë qasje në regjistrat shtesë kombëtarë (40 gjithsej). Megjithatë, raporti i monitorimit për periudhën janar- qershor 2020 i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 tregon se atyre ende u mungon qasja e drejtpërdrejtë në disa regjistra kryesorë kombëtarë.

Një ndryshim tjetër institucional kryesor në Shqipëri është krijimi i Strukturës Speciale kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), e cila përbëhet nga Zyra e Prokurorisë Speciale dhe Byroja Kombëtare e Hetimit. Deri tani, nuk është krijuar Zyrë Kombëtare e Kthimit të Pasurive, megjithëse ajo është në diskutim dhe përfshihet në të dyja strategjitë kombëtare.

Zyra e Kthimit të Pasurive (ZRP)

Shqipëria nuk ka krijuar ende zyrtarisht një zyrë qendrore kombëtare të kthimit të pasurive, në përputhje me standardet e BE-së^[19] dhe praktikat më të mira globale. Sipas Planit të Veprimit 2020-2023, miratuar më 30 prill 2020, në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale Antikorrupsion, objektivat nën pikën B3 përcaktojnë që gjatë vitit 2020 do të krijohet një grup pune i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Rendit Publik, Prokurorisë së Përgjithshme, Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, me detyrën e vlerësimit të nevojave dhe kërkesave për një ZRP, nxjerrjen e rekomandimeve dhe përgatitjen e dokumenteve përfundimtare për rishikimin e kuadrit ligjor dhe një projektpropozim për krijimin e ZRP-së shqiptare.

Për vitin 2019, synimi ishte përzgjedhja e institucionit ku do të krijohet ZRP-ja dhe hartimi i procedurave standarde të funksionimit të saj. Ky tregues nuk u arrit në vitin 2019 dhe për këtë arsye u zhvendos për në vitin 2020. Për të arritur objektivat e përshkruara në Planin e Veprimit 2020-2023, parashikohen aktivitetet (3) dhe masat (3) e mëposhtme:

“3.2 Baza ligjore e ZRP-së (institucioni pritës dhe procedurat standarde të operimit) të hartuara nga institucioni i propozuar;

3.3 Miratimi i krijimit dhe zbatimit të aktivitetëve të ZRP-së;

3.4 Aktivitete të ndërgjegjësimit në kuadër të luftës kundër krimit ekonomik dhe financiar”.

[19] VENDIMI I KESHILLIT 2007/845/DPB, datë 6 dhjetor 2007, në lidhje me bashkëpunimin midis Zyrave të Kthimit të Pasurive të Shteteve Anëtare në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave nga, ose pasurive të tjera të lidhura me krimin.

Objektivi për vitin 2020 ishte hartimi i bazës ligjore për ZRP-në dhe identifikimi i institucionit ku do të vendoset zyra. Për vitin 2021, objektivi është rënia dakord mbi kuadrin ligjor për funksionimin e zyrës dhe listën e përpiluar të veprave penale për të cilat është i mundur konfiskimi. Për vitin 2022, objektivi është që të arrihet një ZRP plotësisht funksionale dhe njoftimi i krijimit të ZRP-së te Komisioni i BE-së. Për vitin 2023, objektivi është emërimi i prokurorëve të specializuar të dedikuar vetëm për gjurmimin dhe kthimin e pasurive.

Masat pritet të zbatohen përmes aktiviteteve të kryera gjatë 6 muajve të parë të vitit 2021, 6 muajve të parë të vitit 2022 dhe 6 muajve të parë të vitit 2023.

Në përmbledhje, ZRP-ja shqiptare pritet të krijohet dhe të funksionojë plotësisht deri në dhjetor 2023.

Zyra për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Zyra për Administrimin e Pasurive e Shqipërisë, me emërtimin e plotë *Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK)*, u krijua në vitin 2010 dhe tani funksionon brenda kuadrit të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar me ligjin nr. 19/2020 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”. Fillimisht, e themeluar si pjesë e Ministrinë e Financave, ka kaluar nën Ministrinë e Rendit dhe Sigurisë Publike (Ministria e Brendshme e Shqipërisë). Ligji nr. 34/2019 me ndryshimet dhe shtesat e tij përcaktojnë rregullat, procedurat dhe strukturën administrative për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara nga gjyqësori dhe Policia e Shtetit dhe më pas, nën urdhrin e Ministrit të Rendit dhe Sigurisë Publike, kthimin e tyre te komuniteti dhe/ose përdorimin për të kompensuar viktimat e krimit.

Në mënyrë të ngjashme me të gjitha juridiksionet e tjera në rajon, Shqipëria krijoi zyrën e saj të administrimit të pasurive përpara zyrës së kthimit të pasurive. Juridiksioni ka bërë një përparim të dukshëm për përcaktimin e legjislacionit, politikave dhe procedurave në fushën e administrimit të pasurive, në krahasim me shumë fqinjë të saj në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjatë periudhës së projektit rajonal AIRE-RAI, një vëmendje e madhe iu kushtua zhvillimit të AAPSK-së, duke përfshirë ndryshimet në ligjin nr. 34/2019 dhe miratimin e disa vendimeve të Këshillit të Ministrave në lidhje me vlerësimin, përdorimin dhe shitjen e pasurive të konfiskuara, pagave dhe shpërblimeve e krijimin dhe qasjen në Regjistrin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. E rëndësishme për t’u theksuar është që mandati i Agjencisë është ndryshuar për të përfshirë menaxhimin e një fushe më të gjerë pasurish, jo vetëm ato që bien brenda kuadrit të Ligjit Antimafia (2017). Neni 4 i ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar, rendit legjislacionin nga i cili Agjencisë i kërkohet të administrojë pasuritë. Paketa e nevojshme e ndryshimeve ka rritur ndjeshëm ngarkesën e punës dhe përgjegjësinë e Agjencisë. Rritja e efektivitetit të AAPSK-së është një aspekt kryesor i Strategjisë kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit 2020-2030, miratuar më 1 korrik 2020, me anë të VKM-së nr. 516, datë 1.7.2020. Plani i Veprimit, midis objektivave të tij, përcakton masat në lidhje me mbledhjen e statistikave për kthimin e pasurive, krijimin e një regjistri elektronik të pasurive nën administrimin dhe hartimin e ligjit e akteve nënligjore të AAPSK-së përmes krijimit të një grupi pune. Aktualisht po hartohen tetë akte nënligjore në zbatim të ligjit nr. 34/2019, të cilët janë në faza të ndryshme hartimi:

- » Projektvendimi i KM-së “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrave dhe procedurave për përdorimin dhe tjetërsimin e pasurive të konfiskuara”
- » Projektvendimi i KM-së “Për kufijtë e pagave ose shpërblimeve të personelit”
- » Projektvendimi i KM-së “Për kriteret, masat dhe mënyrën e përdorimit të pasurive të paluajtshme dhe ato që shërbejnë për veprimtari ekonomike tregtare”
- » Projektvendimi i KM-së “Për rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”, i cili është miratuar së fundmi përmes VKM-së nr. 835, datë 28.10.2020.
- » Projektudhëzimi “Për procedurat e mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave, rregullat dhe mënyrën e mbajtjes dhe regjistrimit të shpenzimeve, dhe kufijtë për kryerjen e shpenzimeve”
- » Projekturdhri “Për kriteret dhe rregullat për përpilimin e listës së administratorëve të pasurive në AAPSK”.
- » Projekturdhri “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Agjencisë së Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”.
- » Projektvendimi i KM-së “Për krijimin e regjistrimit elektronik për mbajtjen, formën dhe raportimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”.

Funksionet e AAPSK-së parashikohen në nenin 8 të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar me ligjin nr. 19/2020, përfshijnë:

- » organizimin, funksionin, buxhetimin, përgjegjësitë dhe kompetencat e AAPSK-së;
- » pranimin e pasurive nën administrimin e AAPSK-së me anë të një urdhri gjykatë ose urdhri administrativ;
- » nxjerrjen e pasurive nga administrimi i AAPSK-së (shitja);
- » administrimin nga persona të jashtëm (jo AAPSK);
- » si mund të përdoren pasuritë në fazën para dhënies së vendimit nga gjykata dhe pas gjykimit;
- » si mund të transferohen pasuritë te shteti ose te një person i tretë pas vendimit të gjykatës;
- » kthimin e pasurive te pronari origjinal kur anulohen urdhrat e sekuestrimit;
- » si mund të gjenerohen të ardhura nga administrimi i pasurive dhe çfarë ndodh me këto të ardhura;
- » kostot e përfshira në administrimin e pasurive dhe mënyrën se si përmbushen këto kosto;
- » krijimin, qëllimin, administrimin dhe caktimin e të drejtave të qasjes në “regjistrin elektronik” të pasurive.

Rritja e mandatit të AAPSK-së ka qenë e rëndësishme për funksionimin e saj efektiv. Ky zhvillim duhet të vazhdojë në lidhje me përfshirjen e Agjencisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së ciklit të pasurive. Aktualisht, Agjencia nuk është e mandatuar të menaxhojë pasuritë derisa gjykata të marrë një vendim mbi pasurinë përmes një urdhri gjykatë. Prandaj, AAPSK-ja nuk është përfshirë në ndonjë aktivitet para konfiskimit, as në vlerësimin dhe këshillimin për taktikat e konfiskimit në fazën hetimore të operacioneve. Prokuroria ka pranuar se do të ishte e dobishme në të gjitha rastet që ekspertët të bënin një vlerësim të pasurive në një çështje që në fazën e hetimit, në mënyrë që të ketë një vlerësim

paraparak të pasurive që kërkohen të sekuestrohen ose konfiskohen. Ky ndryshim shtesë do të kërkonte ndryshime të mëtejshme në ligjin e AAPSK-së.

Ripërdorimi i pasurive të konfiskuara

Një fond i veçantë për të mbajtur paratë nga pasuritë e konfiskuara, për përdorim të mundshëm në projekte shtetërore dhe të komunitetit social, parashikohet në bazë të nenit 37 të ligjit nr. 10192 të vitit 2009, të ndryshuar në vitin 2017, dhe së fundmi përmes ligjit nr. 85/2020 të quajtur *Fondi Special për Parandalimin e Krimit*. Paratë e mbledhura nga zbatimi i këtij ligji mblidhen në një fond të veçantë për parandalimin e krimit dhe për edukimin juridik. Fondi special dhe shuma e tij përcaktohen në Ligjin Vjetor të Buxhetit.

Ky fond shërben: (a) për të përmirësuar funksionimin e drejtësisë penale, duke caktuar pasuri nën administrimin e Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë Speciale kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Ministrisë së Rendit Publik; (b) për të përmirësuar parandalimin e krimit, hetimet paraprake penale mbi krimin e organizuar përfitues ose krime të tjera, dhe për të zhvilluar programe për të mbrojtur dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë duke caktuar pasuri nën administrimin e Ministrisë së Rendit Publik; c) për të siguruar ndihmë për viktimat e krimit të organizuar, si dhe për të promovuar programe sociale për këto kategori, duke caktuar pasuri nën administrimin e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale; ç) për të dëmshpërblyer viktimat e krimit të organizuar dhe trafikimit në masën e përcaktuar në vendimin e gjykatës; d) për të rimbursimuar diferencën e vlerës që mund të lindë përmes administrimit të pasurive të cilat, përmes një vendimi gjykate, do t'i kthehen pronarit të pasurive, të ngrira ose të konfiskuara (siç është ndryshuar me ligjin nr. 85/2020 (neni 16)) .

Përveç institucioneve të qeverisjes qendrore, përfitues mund të jenë edhe: a) departamentet e qeverisjes vendore, në vendndodhjen gjeografike të pasurive të patundshme të konfiskuara; b) organizata jofitimprurëse, fusha e veprimtarisë së të cilave është rehabilitimi social, kulturor dhe shëndetësor për personat në nevojë. Kjo përfshin posaçërisht ata të prekur nga krimi ose në rrezik krimi, organizata dhe qendra terapeutike, qendra rehabilitimi dhe trajtimi të abuzimit me substanca, dhe qendra rehabilitimi për viktimat e trafikimit njerëzor, të cilat të gjitha të kenë kryer veprimtari për të paktën tre vjet që nga paraqitja e kërkesës. Kërkesat për financimin e projekteve, sipas nenit 37 të LAM, përcaktohen nga Komiteti Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat kundër Krimit të Organizuar, i cili përcakton kriteret për financimin e projekteve, ndërsa zbatimi dhe përdorimi i tij i vazhdueshëm mbikëqyret nga Agjencia. Sipas ligjit të ri nr. 85/2020 (neni 16) Komiteti, përmes një vendimi, përcakton financimin e projekteve dhe mënyrat e përdorimit të fondeve të destinuara për aplikantin. Fondet e destinuara për parandalimin e krimit që nuk përdoren në një vit financiar, do të transferohen në vitin pasardhës buxhetor të Agjencisë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Shqipëria ka një grup të plotë dispozitash ligjore për bashkëpunimin ndërkombëtar në lidhje me kthimin e pasurive. Ligji nr. 10192, (10193) datë 3 dhjetorit 2009, për

marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale (Ligji MLA) përshkruan rregullimet në lidhje me kërkesat drejtuar Shqipërisë për sekuestrim dhe konfiskim (nenet 1, 22 dhe 23). Pas marrjes së kërkesës, sekuestrimi dhe konfiskimi bëhet në përputhje me KP-në dhe KPP-në. Kërkesat ndërkombëtare për zbatimin e sekuestrimit dhe konfiskimit nuk zbatohen drejtpërdrejt në Shqipëri dhe duhet t'i paraqiten gjykatës përkatëse të rrethit për dhënien e një "vendimi të favorshëm" (neni 506 KPP-së). Çështjet rreth ankesave (nenet 274 - 276 KPK-së) zbatohen gjithashtu për pasuritë e sekuestruara në emër të një juridiksioni të huaj dhe mund të përfundojnë në kthimin e pasurive brenda disa javësh nga sekuestrimi.

Për më tepër, neni 10 i LAM-së përfshin dispozitat për ndihmën juridike ndërkombëtare gjatë një procesi gjyqësor, të cilat parashikojnë zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, së bashku me dispozitat përkatëse procedurale.

Standardet ndërkombëtare përcaktojnë gjithashtu që juridiksionet duhet të jenë në gjendje t'u përgjigjen kërkesave të huaja për të hetuar, sekuestruar dhe konfiskuar, bazuar në procedura të bazuara në mosdënim, të paktën në rastin e vdekjes, largimit ose mungesës së të pandehurit, ose nëse i dyshuari është i panjohur. Ligji Shqiptar Antimafia u siguron autoriteteve shqiptare aftësinë për të konfiskuar pas një kërkesë të huaj duke përdorur dispozitat e KPP-së (neni 516-518), të cilat lejojnë njohjen dhe ekzekutimin e dënimeve të huaja gjyqësore. Nëse kërkesa për këtë bazohet në një procedurë penale, atëherë Shqipëria duhet të jetë në gjendje të përgjigjet. Megjithatë, përderisa konfiskimi civil i bazuar në mosdënim nuk mbështetet në një dënim, dhe për këtë arsye nuk është i pranishëm asnjë dënim, autoritetet shqiptare nuk mund të zbatojnë ligjërisht një kërkesë për të sekuestruar ose konfiskuar bazuar në dispozitat civile në bazë të këtij neni të KPP-së.

Shqipëria është anëtare e Rrjetit Ndërinstitucional të Kthimit të Pasurive Camden (CARIN) që nga viti 2006. Kontakti i saj i zbatimit të ligjit, i vendosur brenda Drejtorisë së Krimeve Ekonomike dhe Financiare, Departamenti i Krimeve të Organizuara dhe të Rënda në Policinë e Shtetit Shqiptar, ka qenë fytyra e zbatimit të ligjit brenda rrjetit CARIN për disa vite, duke e vendosur atë dhe Shqipërinë në qendër të bashkëpunimit ndërkombëtar për gjurmimin e pasurive në nivelin global. Kontakti i prokurorisë për rrjetin CARIN për Shqipërinë ndodhet aktualisht brenda Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Me krijimin e ZRA-së së re kombëtare, kontakti i prokurorisë për rrjetin CARIN mund të duhet të ndryshojë, në varësi të ministrisë nën të cilën do të vendoset Zyra e Kthimit të Pasurive. Shqipëria është tashmë e pozicionuar mirë brenda rrjetit informal të menaxhimit të pasurive BAMIN, pasi AAPSK-ja ka qenë anëtare që prej krijimit të tij në vitin 2014. Shqipëria kishte presidencën e BAMIN-it në vitin 2020.

Matja e efektivitetit

Aktualisht nuk ka asnjë sistem qendror për mbledhjen e statistikave për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara dhe vlerën e tyre. Megjithatë, aktualisht po vijon puna në këtë drejtim.

Plani i veprimit 2020-2030, i miratuar për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Antikorrupsion, miratuar në 1 korrik 2020 përmes VKM-së nr. 516, përcakton një

sërë masash për mbledhjen dhe modernizimin e të dhënave statistikore mbi pasuritë e sekuestruara dhe të sekuestruara me vendim gjykate, për veprat penale të korrupsionit dhe krimet të organizuar (siç përshkruhet në Monitorimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Antikorrupsion, datë janar-qershor 2020). Këto statistika duhet t'i përcillen Komisionit Evropian. Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) luan një rol kryesor në këtë fushë. Pas ndryshimeve në ligjin e Agjencisë, ajo tani është mandatuar të krijojë dhe menaxhojë një regjistër elektronik të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (RPSK), ku do të kenë qasje autoritetet ose subjektet e tjera publike. Prezantimi i këtij regjistri do ta vendosë AAPSK-në në një pozitë qendrore në shkallë kombëtare për të mbledhur statistikat për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara dhe vlerat e tyre. Këtu mund të përmendet VKM-ja nr. 512, datë 1.7.2020, "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e të dhënave shtetërore për informacion kundër krimet të organizuar, krimeve të rënda dhe terrorizmit" dhe gjithashtu VKM nr. 835, datë 28.10.2020 "Për rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve ose subjekteve publike që kanë qasje në informacionin e tij".

Edhe pse një sasi e madhe kërkimesh dhe përgatitjeje është kryer tashmë, aspekte të caktuara të regjistrimit janë ende duke u diskutuar. Për shembull, nuk është ende e qartë se si do të merren të dhënat për rastet e referuara ose të ndjekura nga Policia, ose Zyra e Prokurorisë, për të cilat nuk ka asnjë vendim sekuestrimi ose konfiskimi nga gjykata. Parashikohet që aktet nënligjore për regjistrin duhet t'i sqarojnë këto çështje.

Përveç kësaj, ndër objektivat aktualë strategjike dhe politike, është krijimi i Zyrës së Kthimit të Pasurive, e cila gjithashtu mund të ketë në të ardhmen një rol gjithëpërfshirës të mbledhjes së informacionit dhe të dhënave, dhe të koordinimit të të dhënave nga Policia, prokuroritë, gjykatat dhe Agjencia. Do të duhet të vendosen role të qarta ndërmjet ZRP-së dhe AAPSK-së lidhur me mbledhjen e të dhënave për të shmangur dublimin dhe për të maksimizuar efikasitetin. Njëra ose të dyja ato do të priten gjithashtu të kryejnë studime të plota në lidhje me rritjen e efektivitetit të sistemit të kthimit të pasurive.

Ndërkohë, të gjitha autoritetet e përfshira raportojnë për kthimin e pasurive në Ministrinë e Drejtësisë, e cila është përgjegjëse për botimin e statistikave vjetore për çështjet gjyqësore. Deri tani, me krijimin e SPAK-ut, Prokuroria e Posaçme ka raportuar në Prokurorinë e Përgjithshme në lidhje me të dhënat, të cilat janë futur në Raportin Vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme. AAPSK-ja deri tani ka mbajtur regjistrin e vet dhe ka raportuar në Zyrën e Kryeministrit. Së fundmi, standardet e BE-së gjithashtu kërkojnë mbledhjen e statistikave për kërkesat ndërkombëtare hyrëse dhe dalëse për të zbatuar ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin. Informacione të mëtejshme për këtë pikë janë në dispozicion në dokumentin "Monitorimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë kundër Korrupsionit", janar-qershor 2020. Situata aktuale në lidhje me përpilimin, në mënyrë specifike, të kërkesave ndërkombëtare të bazuara në traktate, të dërguara dhe të marra, për të zbatuar urdhrat për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive është e paqartë.

5.2 Bosnjë dhe Hercegovina

Kthimi e pasurive si objektiv politikash

Bosnjë dhe Hercegovina kanë shumë dokumente strategjike të krijuara në nivele të ndryshme të qeverisjes (në nivelin shtetëror të BiH-së, në nivel të entiteteve, distriktit Brckos dhe në nivel kantonesh) që përmbajnë masa specifike në lidhje me kthimin e pasurive (p.sh. Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Krimit të Organizuar, Strategjia Antikorrupsion, Strategjia Antiterrorizëm, Strategjia për Luftimin e Trafikimit të qenieve Njerëzore, etj.). Nga kjo situatë mund të arrihet në përfundimin se kthimi i pasurive është me të vërtetë një pjesë e rëndësishme e politikave kriminale publike për vendin. Aktualisht nuk ka një strukturë kombëtare që mund të presë dhe të drejtojë në mënyrë efektive politikat e kthimit të pasurive për vendin. Megjithatë, kthimi i pasurive duhet të përfshihet në agjendat e politikave në nivelet individuale të shtetit dhe të njëjësive. Ka shenja të kësaj qasjeje. Për shembull, Federata e BiH-së, është një nga dy njësitë në kuadrin kushtetues të decentralizuar që ka një ligj specifik mbi kthimin e pasurive, i cili përcakton që Agjencia Federale për Administrimin e Pasurive do të përgatisë dhe do të dërgojë në Parlament një strategji dhe plan veprimi në fushën e kthimit të pasurive, megjithëse ky dokument nuk është zhvilluar ende. Strategjitë e kthimit të pasurive, komitetet dhe planet e veprimit shpesh përfshihen në strategjitë kombëtare të krimit të organizuar, të antikorrupsionit ose të hetimit financiar dhe kjo mund të funksionojë gjithashtu për të katër fushat juridiksionale në BiH. Megjithatë, aktualisht asnjë nga katër juridiksionet nuk ka zhvilluar ose miratuar një strategji unike për kthimin e pasurive (madje as Federata e BiH-së, megjithëse kjo është e përshkruar me ligj). Prandaj, rekomandohet mbështetje e mëtejshme për të katër fushat, në mënyrë që të përforcohet nevoja që politikat e kthimit të pasurive të zotërohen dhe drejtohen nga një autoritet i veçantë, duke e sjellë atë në përputhje me këtë standard ndërkombëtar.

Dispozitat ligjore për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive

Një analizë e hollësishme e dispozitave ligjore të kthimit të pasurive për Shqipërinë përfshihet në botimet e qendrës AIRE dhe RAI-t "*Kthimi i pasurive në Ballkanin Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës (2018)*", në faqen 55-58 dhe në "*Doracakun mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)*" në faqet 58-83. Kjo pjesë përmban një përmbledhje të kësaj analize si edhe zhvillimet e reja që prej botimeve të qendrës AIRE dhe RAI-t.

Sistemi i së drejtës kushtetuese të Bosnjë dhe Hercegovinës (BiH), përbëhet nga katër sisteme të së drejtës penale. Kthimi i pasurive rregullohet në nivelin shtetëror nga Kodi Penal (KP) dhe Kodi i Procedurës Penale (KPP), plus edhe nga rregulloret për procedurën e përmbarimit. Në entitetet e Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës (FBIH), Republika Srpska (RS) dhe Distriktin i Brčko (BD) kthimi i pasurive rregullohet si nga KP-të edhe nga KPP-të e tyre ashtu edhe nga ligjet e tyre individuale mbi konfiskimin e produkteve të krimit (LKPK)).

Në të katër juridiksionet, ngrirja, sekuestrimi dhe konfiskimi i instrumenteve, objekteve dhe të ardhurave të drejtpërdrejta nga krimi parashikohen brenda KP-së,

KPP-së dhe LKPK-së individuale. Për FBiH-në, RS-në dhe DB-në, miratimi i një LKPK-je ofron qartësi më të hollësishme në lidhje me qëllimin e dispozitës, d.m.th. heqjen e pasurisë së kriminelëve përmes konfiskimit të produkteve të krimit. Ngjashmëritë dhe ndryshimet janë përshkruar në mënyrë gjithëpërfshirëse “*Doracakun mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)*” në faqet 73-83.

Konfiskimi i bazuar në mosdënim

Megjithëse në vend ekzistojnë procedura të ndryshme që parashikojnë konfiskimin, konfiskimi “i zakonshëm” ose klasik penal pas një dënimi sigurohet në të katër juridiksionet. Dispozitat për konfiskimin e bazuar në mosdënim, para një dënimi, por në procese penale, në rastet kur një autor vepre vdes, është mendërisht i papërshtatshëm për ndjekje penale, mungon, ose kur për arsye të tjera parandalohet dhënia e një dënimi përfundimtar, janë të disponueshme, por ndryshojnë në formë dhe lloj nga njëri entitet te tjetri. Konfiskimi në i bazuar në mosdënim parashikohet në nivelin e FBiH-së dhe BD-së kur plotësohen kushtet specifike të ligjit (vdekja e autorit të krimit; në rast të mungesës së autorit të veprës për shkak të arratisjes; dhe kur ekziston një rrezik i afërt i mbarimit të periudhës së parashkrimit). Zhvillimet e fundit legjislative në entitetin e Republika Srpska-s gjithashtu prezantuan konfiskimin në kushtet e mungesës së dënimit në rastin e vdekjes, mungesës etj., Dhe këto dispozita janë shumë të ngjashme me ato të Federatës së BiH-së dhe Distriktit Brčko.

Standardi i BE-së, siç përmbahet në direktivën e BE-së 2014/42/BE, neni 4 paragrafi 2^[20], siguron që juridiksionet të mund të konfiskojnë mjete dhe të ardhura në rastin e të paktën sëmundjes ose ikjes së personit të dyshuar ose të akuzuar, ndërsa FATF-ja, gjithashtu, përfshin vdekjen e tyre në standardin e saj. Rekomandohet që BiH-ja të sigurojë përafrimin e legjislacionit të saj me të paktën standardin e BE-së.

Konfiskimi i zgjeruar

Konfiskimi i zgjeruar është i parashikuar në të gjitha legjislacionet e BiH-së, në shkallë të ndryshme. Ndryshimet në Kodet Penale të BiH-së, FBiH-së dhe BD-së në vitin 2010 hedhin bazat e ligjit material për konfiskimin e zgjeruar, por vetë procedura mbështetet në rregulloret e pakta për sekuestrimin. Federata e BiH-së dhe Distrikti Brčko që atëherë kanë miratuar ligjet e tyre mbi konfiskimin e produkteve të krimit (përkatësisht në vitin 2014 dhe 2016), megjithatë përveç disa përfshirjeve të vogla, konfiskimi i zgjeruar ka mbetur kryesisht i patrajtuar në këto juridiksione. RS-ja është përjashtimi i vetëm pasi LKPK-ja e saj i kushtohet plotësisht konfiskimit të zgjeruar. Një analizë e legjislacionit në vend, siç përshkruhet në “*Doracakun mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)*”, arrin

[20] Kur konfiskimi në bazë të paragrafit 1 nuk është i mundur, të paktën kur një pamundësi e tillë është rezultat i sëmundjes ose arratisjes së personit të dyshuar ose të akuzuar, Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të mundësuar konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave në rastet kur kanë filluar proceset penale në lidhje me një vepër penale e cila mund të shkaktojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përfitim ekonomik, dhe kur procese të tilla mund të çojnë në një dënim penal nëse personi i dyshuar ose i akuzuar do të ishte në gjendje të dilte në gjyq.

në përfundimin se ligjvënësit e BiH-së nuk janë plotësisht të qartë se cilat rrethana specifike duhet të provohen kur vendosin një lidhje mes pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit të zgjeruar dhe krimeve nga të cilat pretendohet se rrjedhin ato. Dispozitat në ligjin e RS-së dhe interpretimi i tërthortë i dispozitave të ligjit penal të BiH-së, FBiH-së dhe BD-së, megjithatë sugjerojnë që pasuria e autorit të krimit, madhësia dhe vlera e së cilës nuk mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme duke e krahasuar me të ardhurat ligjore të tij/saj, i nënshtrohet konfiskimit të zgjeruar. Megjithatë, nëse ligjvënësi nuk shprehet në mënyrë të sigurt, sigurisht që rrjedhimisht profesionistët të cilët do të zbatojnë legjislacionin (gjyqtarët dhe prokurorët) do të jenë të pasigurt, duke çuar në një nivel të ulët përdorimi të këtyre dispozitave.

Konfiskimi civil ose administrativ i bazuar në mosdënim

Konfiskimi civil ose administrativ i bazuar në mosdënim nuk është pjesë e kuadrit legjislativ për të etiketuar pasuritë që rrjedhin nga krimi në BiH.

Hetimi financiar

Megjithëse nuk përmendet shprehimisht si hetim “financiar”, legjislacioni që parashikon hetimin financiar përfshihet në KPP-të e të katër juridiksioneve. Për ato entitete që kanë miratuar një LKPK, parashikohen parashikimet për hetimin financiar, por vetëm për veprat penale të përfshira në fushën e veprimit të LKPK-së. Doracaku, f. 69-73, ofron një koment të hollësishëm mbi mundësitë ligjore për hetimin financiar.

Si përmbledhje, brenda të gjitha juridiksioneve të BiH-së, KPP-të dhe LKPK-të (aty ku ekzistojnë) u japin të drejtë prokurorëve që të fillojnë dhe të kryejnë hetime financiare. Dispozitat e legjislacionit janë vetëm një përbërës i hetimit financiar efektiv. Hetuesit me aftësitë e duhura, koordinimi ndërinstucional dhe qasja e shpejtë (e drejtpërdrejtë nëse është e mundur) të të dhënave përkatëse janë gjithashtu faktorë kryesorë. Këto aspekte janë ende “punë në progres”. Në FBiH, për shembull, disa institucione janë caktuar si “partnerë kryesorë” me zyrat e prokurorisë sa i takon zbatimin të hetimeve financiare (Administrata Tatimore e FBiH-së, Regjistri i Letrave me Vlerë i FBiH-së, Komisioni i Letrave me Vlerë i FBiH-së). Megjithatë, duhet bërë më shumë punë që autoritetet përkatëse të hetimit të kenë qasje të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë të burimeve të informacionit për hetim efektiv financiar, veçanërisht të regjistrat bankarë të personave fizikë. Kjo do të thotë se një fushë tjetër që kërkon vëmendje më të madhe është qasja në informacionet bankare dhe informacione të tjera financiare. Standardet ndërkombëtare dhe rajonale^[21] mbështesin krijimin e regjistrave kombëtarë të llogarive të bankave qendrore, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë të zyrave kombëtare të kthimit të pasurive në to. Deri më sot, BiH-ja nuk ka një regjister kombëtar të llogarive bankare të personave fizikë. Këto kontrolle kryhen përmes një procesi të gjatë kontaktimi të bankave individuale. Në një drejtim pozitiv, RS-ja ka krijuar një njësi të specializuar policie e cila operon si një zyrë e kthimit të pasurive për RS-në dhe ka përfituar nga trajnimi i specializuar për hetimin financiar.

[21] Direktiva e 5-të e pastrimit të parave dhe direktiva e BE-së 2019/1153 që përcakton rregullat që lehtësojnë përdorimin e informacioneve financiare dhe informacioneve të tjera për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të disa veprave penale dhe shfuqizimin e vendimit të Këshillit 2000/642/DCB.

Megjithatë, kjo ndodh rrallë në vend. Raportet e mëparshme të qendrës AIRE dhe RAI-t kanë arritur në përfundimin se aftësia për të kryer hetime financiare si nga zbatimi i ligjit, ashtu edhe nga prokurorët është e ulët. Nuk ka mjaftueshëm persona me aftësitë e nevojshme për të kryer hetime financiare të dedikuara posaçërisht për kthimin e pasurive. Në përgjithësi, kjo mbetet rasti në BiH.

Zyra për Kthimin e Pasurive (ZRP)

Struktura në drejtim të krijimit të një zyre kombëtare efektive për kthimin e pasurive, e cila funksionon mirë, është larg zgjidhjes në BiH dhe në këtë fushë jetike nevojitet ndërtim i mëtejshëm i kapaciteteve, me mbështetje të jashtme nga ekspertët që punojnë në fushën ndërkombëtare të kthimit të pasurive. Për të punuar në mënyrë efektive, ZRA-të kërkojnë një qasje të gjerë në bazat e të dhënave të disponueshme në zonën e tyre gjeografike. Agjencia Shtetërore e Hetimit dhe Mbrojtjes (SIPA) është një agjenci policie e krijuar në nivelin shtetëror të BiH-së, e cila shërben si NJIF kombëtar dhe siguron ndihmë për bashkëpunimin ndërkombëtar, me ndihmën e agjencive policore nga nivelet e tjera të qeverisjes. Kjo zyrë mund të kryejë një rol koordinues për strukturën e përgjithshme të ZRP-së së BiH-së. Megjithatë, kjo do të funksiononte në mënyrë efektive vetëm nëse do të ishte e lidhur mirë me zyrat rajonale të kthimit të pasurive brenda Federatës së BiH-së, Republikës Srpska dhe Distriktit Brčko. Këto zyra duhet të plotësohen me hetues të trajnuar për identifikimin, gjurmimin dhe kthimin e pasurive.

Për sa i përket specializimit, ka disa prokurorë dhe zyrtarë të zbatimit të ligjit në të gjithë vendin të cilët kanë fituar trajnim dhe ekspertizë specifike në këtë fushë, por ata nuk janë caktuar zyrtarisht si prokurorë specialë për kthimin e pasurive dhe nuk mbështeten nga një sistem stimujsh, shpërblimesh dhe vlerësimesh për punën e tyre për kthimin e pasurive siç mbështeten për ndjekjet penale.

Rekomandohet që, si hapi i parë, një fillim i mirë do të ishte caktimi ose krijimi i një ZRP-je brenda secilës prej njësisë të F BiH-së, BD-së dhe në nivelin shtetëror të BiH-së, në mënyrë të ngjashme me ZRP-në e RS-së. Juridiksioni do të ketë nevojë për mbështetje nga partnerë të jashtëm ndërkombëtarë dhe projekte për të zbatuar këtë rekomandim.

Zyra për Administrimin e Pasurive (ZAP)

Ashtu si edhe me situatën për krijimin e një ZRP-je në BiH, struktura e decentralizuar e vendit aktualisht nuk lejon një zyrë të centralizuar të administrimit të pasurive. Sistemet funksionale të administrimit të pasurive ekzistojnë në FBIH, BD dhe RS. LKPK-të gjithashtu themeluan dy agjenci të administrimit të pasurive në FBIH dhe në RS. Në shtator të vitit 2020, Ministria e Drejtësisë e entitetit të Republika Srpska-s miratoi një rregullore të re mbi “Rregullat e procedurave për administrimin e pasurive”, duke siguruar që Agjencia për Administrimin e Pasurive e RS-së të ketë një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për të administruar me efikasitet të gjitha llojet e pasurive që i nënshtrohen konfiskimit të përkohshëm ose sekuestrimit të përhershëm. Kjo rregullore është hartuar me mbështetjen e një projekti të financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Një rregullore e ngjashme është përgatitur për entitetin e F BiH-së, por ajo nuk është miratuar ende.

KPP-të nuk specifikojnë procedurën që ndiqet pas miratimit të vendimi gjykate ose një vendimi tjetër konfiskimi. Kjo do të thotë që zbatohen dispozitat e përgjithshme mbi veprimet gjyqësore pas gjykimit (kopjet e vërtetuara të aktgjykimit u dorëzohen palëve, mbrojtësve, palëve të dëmtuara, personave, sendet e të cilëve janë konfiskuar [kur është e zbatueshme] dhe pronarit të pasurisë objekt konfiskimi në rast se personi nuk është i pandehur. LKPK-të përkatëse përcaktojnë dispozita të ndryshme mbi sistemin e vendosur në lidhje me administrimin e pasurive. Pas marrjes së vendimit përfundimtar, pasuria mund të shitet, ndërsa veprat e artit dhe sende të tjera të rëndësishme kulturore ose historike mund t'u jepet galerive të artit, muzeve dhe institucioneve kulturore për ruajtje dhe përdorim. Një objekt kryesor i një agjencie për administrimin e pasurive është të ruajë vlerën e pasurive në pritje të vendimit përfundimtar të gjykatës dhe të arrijë vlerën më të lartë të mundshme të shitjes pas vendimit përfundimtar. Kjo mund të arrihet vetëm me përfshirjen e miratimit të procedurave të administrimit të pasurisë në ligje dhe posaçërisht në aktet nënligjore të cilat rregullojnë qartë secilën mënyrë administrimi për format specifike të pronës, pavarësisht statusit në proceset gjyqësore (të sekuestruara ose të konfiskuara). Ekspertiza në fushën e kthimit të pasurive është rritur gjatë 10-15 viteve të fundit, me zhvillimin e vazhdueshëm të praktikave më të mira mbi legjislacionin dhe procedurat brenda grupeve të profesionistëve, të tilla si BAMIN. BiH-ja është në pozitë të shkëlqyeshme për të përfituar nga kjo njohuri dhe për të filluar hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore, pasi ajo është anëtare e rrjetit BAMIN që nga viti 2014. Gjithashtu, FBiH-ja, në mungesë të një ZRP-je, ka marrë një rol udhëheqës në politikën e kthimit të pasurive për juridiksionin. RS-ja ka zhvilluar detaje më të hollësishme në legjislacionin e saj brenda LKPK-së. Megjithatë, ka mangësi në sisteme. Për shembull, asnjë nga 4 zonat juridiksionale brenda BiH-së nuk ka krijuar një fond të veçantë për të mbledhur paratë nga pasuritë e konfiskuara, për përdorim të mundshëm në projekte shtetërore dhe projekte sociale të komunitetit. Çështje të tilla, si shitja e pasurive të sekuestruara në fazën përpara marrjes së vendimit dhe përdorimi i pasurive nga institucionet shtetërore ose për qëllime sociale gjithashtu do të kenë nevojë për legjislacion dhe sigurisht që do të kërkojnë rregullim dhe mbikëqyrje të hollësishme. Unë jam e sigurt që profesionistët që punojnë në këtë fushë pajtohen me mua kur them se ka ende shumë punë për t'u bërë në këtë fushë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Kërkesat zyrtare hyrëse dhe dalëse për ndihmë të ndërsjellë juridike në lidhje me BiH-në, të gjitha kalojnë përmes nivelit shtetëror, Departamentit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar të Ministrisë së Drejtësisë dhe nga këtu dërgohen në entitetet përkatëse të BiH-së për ekzekutim. Regjistrimi i statistikave të lidhura me gjurmimin e pasurive ose ekzekutimin e urdhrave të sekuestrimit dhe konfiskimit është aktualisht në zhvillim e sipër pasi HJPS-ja ka zhvilluar një modul të ri statistikor brenda sistemit të centralizuar të menaxhimit të gjykatës. Ky sistem është zhvilluar me mbështetje të fortë financiare nga BE-ja, IPA dhe ekspertizë të Ambasadës Britanike.

Përfitimet operacionale të një vendi që është i lidhur me rrjetet ndërkombëtare të profesionistëve të kthimit të pasurive (CARIN, BAMIN dhe STAR) nuk mund të nënvizohen sa duhet. Në veçanti, për një vend me sfida të bashkëpunimit të brendshëm, siç është BiH-ja, emërimi i një personi kontakti në rrjetin CARIN të zbatimit të ligjit

dhe i një personi kontakti në rrjetin CARIN për prokurorinë për çdo entitet është thelbësor. Aktualisht ekziston një person kontakti nga organet e zbatimit të ligjit brenda zyrës së policisë së RS-së, i cili po realizon paraprakisht funksionin e ZRP-së, dhe një person kontakti nga prokuroria brenda FBiH-së. Ky i fundit u identifikua si rezultat i drejtpërdrejtë i trajnimit të qendrës AIRE dhe RAI-t mbi bashkëpunimin ndërkombëtar dhe shënjon një përparim të madh për vendin. BiH-ja është tashmë e vendosur mirë brenda rrjetit informal të administrimit të pasurive BAMIN.

Emërimi i kontakteve shtesë në rrjetin CARIN nga të gjitha njësitë e BiH-së dhe në nivelin shtetëror do të rrisë shumë mundësitë e kthimit efektiv të pasurive ndërkombëtare në të gjitha fazat e procesit, duke sjellë me vete përfitime shtesë strategjike për BiH-në lidhur me hartimin e legjislacionit, zhvillimin e strukturave dhe procedurave të saj. Duhet të kërkohet ndihmë nga komuniteti ndërkombëtar lidhur me këtë pikë.

Matja e efektivitetit

Mbledhja e të dhënave në lidhje me kthimin e pasurive më parë është përshkruar si e dobët në Bosnjë dhe Hercegovinë. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial (KLGJP) kanë përgjegjësi në nivelin shtetëror për regjistrimin gjyqësor të çështjeve nga gjykatat. Nga 1 janari 2020, KLGJP-ja e BiH-së prezantoi një modul të veçantë brenda Sistemit të Menaxhimit të Gjykatës, i cili do të regjistrojë dhe mirëmbajë në mënyrë selektive të dhënat statistikore mbi pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara. Në kohën e botimit të këtij raporti, raportohet se ky sistem do të sigurojë të dhëna të nevojshme për numrin e çështjeve të përfunduara me sekuestrim dhe konfiskim të pasurive, dhe numrin e sekuestrimeve, konfiskimeve dhe vlerës së pasurive nën administrim në një mënyrë gjithëpërfshirëse efektive. Në mënyrë që të jetë një mjet efektiv për matjen e efektivitetit, sistemi duhet të sigurojë të dhëna që mund të informojnë një proces fillestar të krahasimit kundrejt të cilit mund të matet progresi në të ardhmen. Për të përmbushur këtë nevojë, shumë juridiksione kanë futur sisteme të menaxhimit të pasurive brenda agjencive të tyre (kombëtare) të administrimit të pasurive të cilat, së bashku me regjistrimin e statistikave për pasuritë e sekuestruara, të konfiskuara dhe vlerën e tyre, ofrojnë një sistem të menaxhimit të çështjeve për secilën pasuri, nga fillimi i administrimit të saj nga shteti, deri në asgjësimin ose përdorimin e saj. Moduli i veçantë brenda Sistemit të Menaxhimit të Gjykatës të KLGJP-së aktualisht nuk e përmbush këtë nevojë. Megjithatë, LKPK-të për RS-në dhe FBiH-në ofrojnë kompetenca për të mbledhur statistika për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara (FBiH) dhe për të mbajtur të dhëna dhe përpunuar pasuritë që ata administrojnë (RS). Të dyja agjencitë po punojnë shumë, së bashku me KLGJP-në, për të lidhur regjistrat e tyre me sistemin e ri. Standardet e BE-së tani gjithashtu kërkojnë juridiksione për të monitoruar numrin e kërkesave hyrëse dhe dalëse në lidhje me kthimin e pasurive në mënyrë që të monitorojnë dhe matin kthimin efektiv të pasurive ndërkombëtare. Nuk është e qartë se si BiH-ja do ta arrinte këtë brenda sistemit të KLGJP-së ose sistemeve të Agjencisë. Mund të nevojitet vendosja e një sistemi të tretë brenda Departamentit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë për t'u marrë me kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike.

Raporti i qendrës AIRE dhe RAI-t mbi metodologjinë rajonale të monitorimit arriti në përfundimin e saktë se kthimi i pasurive në BiH nuk menaxhohet në mënyrë të unifikuar, të centralizuar dhe të harmonizuar për shkak të rregullimeve shumë komplekse kushtetuese dhe mungesës së koordinimit midis niveleve të ndryshme të qeverisjes. Megjithatë aktualisht nuk ka mekanizma për shkëmbimin dhe grumbullimin e të dhënave për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, ende po punohet për këtë gjë. Moduli i posaçëm i krijuar brenda Sistemit të Menaxhimit të Gjykatës është një hap pozitiv për BiH-në dhe duhet të përmirësojë ndjeshëm situatën në këtë fushë, duke e sjellë BiH-në në përputhje me Direktivën e BE-së 2014/42. Kjo hap rrugën për punë të mëtejshme për të mbledhur të gjitha statistikat përkatëse në të gjithë BiH-në, përfshirë kërkesat ndërkombëtare.

5.3 Kosova*

Kthimi i pasurisë si objektiv politikash

Kosova* është përqendruar te kthimi i pasurisë në nivelin e qeverisë, përmes fazave të ndryshme të konsolidimit të saj dhe forcimit të shtetit ligjor. Në fillim të projektit rajonal të qendrës AIRE dhe RAI-t, në vitin 2018, Ministria e Drejtësisë, në koordinim me partnerët ndërkombëtarë, ndërmoi një rishikim funksional për të harmonizuar legjislacionin dhe parimet brenda institucioneve përgjegjëse, në mënyrë që të krijonte një kornizë për forcimin e bazave të sistemin e drejtësisë. Ky proces u hartua në tri faza dhe u përqendrua në gjashtë shtylla, duke përfshirë: drejtësinë penale, masat antikorrupsion dhe bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstytucional. Objektiv i shtyllës së *Drejtësisë Penale* është të përmirësojë kornizën ligjore dhe institucionale në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë; të sigurojë integritetin e Policisë së Kosovës* për trajtimin e krimit të nivelit të lartë dhe krijimin e një Task-Force Antikorrupsion në Policinë e Kosovës*; dhe të përmirësojë kornizën ligjore dhe institucionale për ekzekutimin e sanksioneve penale. Objektiv i shtyllës *Antikorrupsion* është të krijojë një kornizë institucionale dhe ligjore në luftën kundër korrupsionit, të përmirësojë rregullat/kornizën për pranimin e dhuratave dhe sistemin e deklarimit të pasurisë dhe të parashikojë kriminalizimin e pasurimit të paligjshëm.

Faza e tretë e rishikimit funksional përfshiu hartimin e një strategjie për Sektorin e Sundimit të Ligjit për periudhën nga 2020 deri në 2025. Do të hartohet gjithashtu edhe një plan veprimi për të zbatuar strategjinë. Procesi i hartimit përfundon me miratimin e strategjisë nga Komiteti Drejtues i Qeverisë. Procesi, i cili është në vazhdim e sipër, po zhvillohet në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës* (KGJK), Këshillin Prokurorial të Kosovës* (KPK) dhe institucione të tjera, përfshirë partnerët ndërkombëtarë. Nga qershori i vitit 2020, Kosova* ka një Ministër të ri të Drejtësisë. Pra, në muajt e ardhshëm priten strategjitë pasuese, objektivat dhe planet e veprimit.

Kosova* ka një koordinator kombëtar për luftën kundër krimit ekonomik, mandati i të cilit përfshin kthimin e pasurisë. Vendi ende nuk ka një strategji specifike kombëtare, komitet ose plan veprimi për kthimin e pasurisë.

Dispozitat ligjore për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë

Një analizë e hollësishme e dispozitave ligjore të kthimit të pasurisë për Shqipërinë përfshihet në botimet e qendrës AIRE dhe RAI-t “*Kthimi i pasurive në Ballkanin Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës (2018)*”, në faqen 58-60 dhe në “*Doracakun mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)*” në faqet 95-104. Kjo pjesë përmban një përmbledhje të kësaj analize, si edhe zhvillimet e reja që prej botimeve të qendrës AIRE dhe RAI-t.

Konfiskimi i pasurisë së fituar me vepër penale në Kosovë* rregullohet nga Kodi Penal (KP, 2019) dhe Kodi i Procedurës Penale (KPP), si dhe ligji “Për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale” (LPKC 2019).

Legjislacioni i kthimit të pasurisë është ndryshuar kohët e fundit, si rezultat i objektivave të fazës së dytë të procesit të rishikimit funksional, duke e sjellë atë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. LCPC Nr. 06/L-087 u miratua në vitin 2018 dhe hyri në fuqi në 2019, ndërsa CC Nr. 06 / L-074 hyri në fuqi në vitin 2019. Gjatë vitit 2019, është kryer puna për hartimin e një KPK-je të re. Votimi i saj ishte planifikuar të bëhej në fillim të vitit 2020, por ajo ende nuk është miratuar.

Si KP-ja e re ashtu edhe LKPK-ja parashikojnë që të konfiskohet vlera ekuivalente e pasurisë, si edhe parashikohet mundësia e ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit nga palët e treta dhe mbrojtja e palëve të treta me mirëbesim.

Konfiskimi i bazuar në mosdënim i pasurisë në pronësi të të akuzuarit ose një personi të tretë është i mundur sipas LKPK-së (2019), në rastin e vdekjes, arratisjes/ ikjes, ose sëmundjes mendore, ose paaftësisë.

Kosova* ende nuk e ka miratuar legjislacionin që lejon konfiskimin civil të bazuar në mosdënim. Megjithatë, ish-Ministri i Drejtësisë i Qeverisë kishte propozuar një ligj të ri civil për konfiskimin e pasurisë së krijuar nga të ardhurat e krimit, pa një dënim, në maj të vitit 2020. Ky ligj i ri do të mundësonte konfiskimin e pasurisë pa një aktakuzë paraprake. Draftdokumenti i konceptit është botuar për konsultim publik. Meqenëse tani është në detyrë një ministër i ri, nuk dihet ende nëse kjo iniciativë do të vazhdojë më tej.

Konfiskimi i zgjeruar

Ashtu si juridiksionet e tjera në rajon, Kosova* i ka përfshirë dispozitat e konfiskimit të zgjeruar brenda LKPK-së së saj të ndryshuar rishtas (2019). Një ndryshim kryesor i dispozitave të konfiskimit të zgjeruar për Kosovën*, në lidhje me ligjet e tjera të ngjashme në rajon, është se pasuria mund t'i nënshtrohet konfiskimit bazuar në supozimin se, në bazë të standardit të “bilancit të probabilitetit”, pasuri janë të ardhurat që rrjedhin nga aktiviteti kriminal. LPKC-ja, gjithashtu, përfshin një fushë më të gjerë të krimeve për të cilat ajo zbatohet, në vend të një reference të thjeshtë të krimeve të referuara në KP, një listë të rishikuar të përkufizimeve në përputhje me dispozitat e reja dhe dispozitat e konfiskimit të zgjeruar të cilat e lejojnë prokurorin të bëjë

një kërkesë brenda afatit kohor të parashkrimeve deri në pesë vjet. Ndërsa shumë juridiksione kanë konstatuar se ligjet e reja të konfiskimit të zgjeruar ofrojnë zgjidhje bashkëkohore të një problemi të vazhdueshëm, sfida kryesore mbetet zbatimi i ligjit. Kosova* e ka përdorur me sukses dispozitën e konfiskimit të zgjeruar. Në shkurt të vitit 2020, Gjykata e Apelit vendosi në një çështje të pastrimit të parave në favor të konfiskimit të pasurisë së shkelësit, me një vlerë prej afërsisht 1 milion euro. Gjithashtu, dënimi plotësues i shqiptuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale në vlerën prej 946.820.84 eurosh ishte mbështetur edhe nga Gjykata e Apelit. Ky është një hap pozitiv jo vetëm për Kosovën*, por për të gjithë rajonin, dhe mësimet e nxjerra nga kjo çështje duhet të ndahen me juridiksionet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Hetimi financiar

Institucionet e mëposhtme kanë kompetenca për kthimin e pasurisë në Kosovë*:

- 1) Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar - Ministria e Drejtësisë
- 2) Zyra e Koordinatorit Nacional për Luftën kundër Krimit Ekonomik - Kryeprokurori i Shtetit, KPC
- 3) Policia e Kosovës* - Departamenti për Krime Ekonomike - Zyra për Kthimin e Pasurisë - Ministria e Brendshme
- 4) Zyrtarët e doganave dhe punonjësit e Administratës Tatimore
- 5) Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF) - Ligji nr. 05/L-096 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit"
- 6) Agjencia kundër Korrupsionit - një institucion i pavarur i themeluar me ligjin nr. 03/ L-159 "Për themelimin e Agjencisë kundër Korrupsionit"

Raportet e mëparshme të qendrës AIRE dhe RAI-t kanë arritur në përfundimin se, në përgjithësi, aftësia për të kryer hetime financiare si nga agjencitë e zbatimit të ligjit, ashtu edhe nga prokurorët është e ulët. Nuk ka mjaftueshëm persona me aftësitë e nevojshme për të kryer hetime financiare të dedikuara posaçërisht për kthimin e pasurisë. Kosova* ende nuk ka hetues financiarë të përkushtuar vetëm për gjurmimin dhe identifikimin e pasurisë që më vonë mund të bëhen objekt i sekuestrimit ose konfiskimit qoftë brenda agjencive të zbatimit të ligjit, organit të akuzës, Zyrës së Kthimit të Pasurisë ose Agjencisë së Administrimit të Pasurisë. Ajo as nuk ka prokurorë të dedikuar specialistë për kthimin e pasurisë brenda Zyrës së Prokurorisë Speciale ose Agjencisë Kundër Korrupsionit, roli i të cilave është të përqendrohen vetëm në ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë. Megjithatë, brenda kontekstit të Këshillit Prokurorial të Kosovës*, përkatësisht Zyrës së Prokurorit të Shtetit, ekziston një Koordinator Kombëtar për Krimet Ekonomike, i cili është një prokuror që merret me rastet që përfshijnë ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë.

Legjislacioni aktual parashikon që të si policët, dhe prokurorët e shtetit mund të fillojnë dhe të kryejnë hetime (për shembull Kodi aktual i Procedurës Penale, neni 6). Sidoqoftë, hetimi financiar për qëllimin specifik të gjurmimit të pasurisë për qëllime konfiskimi nuk është përcaktuar. Ligji i ndryshuar i konfiskimit të zgjeruar brenda LKPK-së (2018) mbulon plotësisht nevojën për hetim financiar për qëllimin e kryerjes

së një hetimi për konfiskim. Kjo iniciohet nga një prokuror i shtetit në mënyrë që të identifikojë pasurinë që mund t'i nënshtrohet një kërkesë për verifikimin e pronës dhe mund të iniciohet në ose gjatë të gjitha fazave të hetimit penal dhe deri në pesë vjet pasi aktgjykimi të marrë formën e prerë. Kodi aktual i Procedurës Penale siguron kompetenca hetimore për të marrë informacion financiar, informacion nga institucionet financiare dhe organet e tjera përkatëse.

LKPK-ja prezantoi kompetenca të reja hetimore dhe kufizuese që nuk janë të disponueshme në ligjet e mëparshme (2013). Për gjurmimin dhe identifikimin e pasurisë, LKPK-ja (2018) dhe KPP-ja përmbajnë dispozita adekuate për qasje në informacionin financiar dhe bazat e të dhënave si nga agjencitë e zbatimit të ligjit, dhe nga prokurorët, përfshirë monitorimin e fshehtë të llogarive bankare. Veprimet specifike hetimore të ndërmarra përpara procedurave penale, në përputhje me nenin 84, paragrafi 1 i KPP-së, mund të autorizohen nga Prokurori i Shtetit, ose ky i fundit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake autorizimin për të ndërmarrë veprime të fshehta ose hetimore teknike, në përputhje me nenet 86-100 të KPP-së, nëse prokurori ka dyshime të arsyeshme se vepra penale e parashikuar në nenin 90 të KPP-së është kryer, po kryhet ose ka të ngjarë të kryhet. Në mënyrë që të paraqesë prova të bazuara në informacionin financiar, prokurori duhet të ketë qasje në të gjitha institucionet ku është regjistruar pasuria, pas lëshimit të urdhrat nga gjyqtari i procedurës paraprake (p.sh. bankat, Administrata Tatimore, Zyra e Kadastrës, etj.). Monitorimi ose kontrolli i llogarive bankare është pjesë e këtyre masave të fshehta.

Zyrtarët doganorë dhe punonjësit e Administratës Tatimore të Kosovës* (ATK) kanë attribute të ngjashme me ato të një organi të "Policisë Financiare". Sipas KPP-së, ata kanë kompetencën, përgjegjësinë dhe detyrimin të hetojnë dhe të zbulojnë veprat penale. Për sa i përket pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (ligji "Për ndryshimet dhe shtesat e ligjit 2013 'Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit'"), të njëjtët zyrtarë janë kompetentë për të hetuar këto vepra penale nën mbikëqyrjen e Prokurorit të Shtetit. Dogana dhe Administratori i Taksave caktojnë një zyrtar ndërmjetësues me Zyrën e Prokurorisë Speciale dhe Zyrat e Prokurorisë për të siguruar bashkëpunim efektiv ndërinstitucional.

Si një mekanizëm specifik hetimor, Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës* (NjIF) është një institucion i pavarur kombëtar përgjegjës për hetimin, mbledhjen dhe analizimin e informacionit të mundshëm të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me Ligjin "*Për Ndryshimet dhe Shtesat në Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (2013)*".

Departamenti Special Antikorrupsion (DSAK) – Task-Forca Antikorrupsion - ishte një njësi e specializuar brenda Departamentit të Hetimeve të Policisë së Kosovës*. Ai u themelua në vitin 2010 dhe ka punuar së bashku me Prokurorinë Speciale të Kosovës* për të hetuar dhe ndjekur penalisht veprat penale të korrupsionit. Megjithëse kjo zyrë u shpërbë në shtator të vitit 2020, çdo çështje e mbetur pezull do të vazhdojë të hetohet nga hetuesit dhe prokurorët përgjegjës të policisë dhe, nëse ekzistojnë prova të veprimitarisë korruptive, do të ndiqen përmes gjykatave.

Zyra për Kthimin e Pasurisë (ZRP)

Në vitin 2018, Drejtori i Policisë së Kosovës* caktoi Departamentin e Krimit Ekonomik të Policisë së Kosovës* si Zyrën Kombëtare të Kthimit të Pasurisë. Edhe pse i disponueshëm për bashkëpunim ndërkombëtar përmes rrjetit CARIN, mandati, fushëveprimi, kompetencat, rolet dhe përgjegjësitë e kësaj zyre janë ende në zhvillim e sipër. Pas emërimit në të ardhmen të një Drejtori të ri të Policisë, komuniteti ndërkombëtar duhet të sigurojë që kjo zyrë të jetë plotësisht funksionale përmes sigurimit të ndihmës së jashtme, ndihmës teknike dhe ndërtimit të kapaciteteve.

Zyra për Administrimin e Pasurisë (ZAP)

Agjencia për Administrimin e Pasurisë të Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AMPSK) u krijua në fund të vitit 2010 dhe u bë funksionale në fillim të vitit 2011. Ajo operon brenda kornizës së ligjit nr. 03/L-141 "Për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar", i cili u plotësua dhe ndryshua me ligjin nr. 05/L-049 "Për administrimin e pasurisë të sekuestruar ose të konfiskuar" në vitin 2016, në mënyrë që të rritet efektiviteti dhe efikasiteti i Agjencisë. Ky ligj e përcakton Agjencinë si një organ qendror kombëtar brenda Ministrisë së Drejtësisë.

Për të përmbushur detyrimet e veta siç përcaktohet në ligj, Agjencia:

- » Menaxhon pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar të përdorur për, ose të dalë nga një vepër penale, përfshirë produktet e terrorizmit, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore;
- » Ekzekuton urdhrat e gjykatës për masa të përkohshme për sigurimin e pasurisë;
- » Ekzekuton vendimin përfundimtar të gjykatës, sipas legjislacionit në fuqi;
- » Vlerëson vlerën e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar;
- » Mban regjistra të pasurisë që administron dhe të vendimeve të gjykatës që vendosin për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë;
- » Administron të dhënat në lidhje me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar në një sistem kompjuterik të centralizuar;
- » Përcakton mënyrën e ruajtjes së vlerës së pronës nën administrimin e saj;
- » Merr pjesë në ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare për të gjitha rastet që përfshijnë pronë të sekuestruar dhe të konfiskuar duke administruar pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bazë të kërkesave të bëra nga një shtet tjetër;
- » Mundëson shitjen e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, sipas vendimit të gjykatës kompetente, duke paguar të ardhurat e mbledhura nga shitja e tyre në Buxhetin e Shtetit * të Kosovës, ose dorëzon pronë për përdorim nga Qeveria;
- » Ofron këshilla për prokurorinë, gjykatën dhe institucionet e tjera në lidhje me natyrën specifike të procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, në mënyrë që të sigurojë ndihmë për planifikimin e sekuestrimeve dhe/ose konfiskimeve të mundshme;
- » Nënshkruan memorandume bashkëpunimi me organet partnere dhe institucionet përkatëse për të rënë dakord mbi marrëdhëniet dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe për të rritur performancën e saj, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.

Agjencia është gjithashtu përgjegjëse për vlerësimin e vlerës dhe menaxhimin e të gjitha pasurive që janë sekuestruar dhe konfiskuar në Kosovë*. Sipas nenit 284 (6) të KPP-së, gjykata i lëshon një urdhër Agjencisë duke e udhëzuar atë të shesë, të likuidojë ose të mbajë prona të patundshme ose të tundshme të konfiskuara. Sidoqoftë, mospërputhjet në të dhënat e mbledhura nga Agjencia dhe Koordinatori Kombëtar për Krimin Ekonomik sugjerojnë, në lidhje me pasuritë e sekuestruara përkohësisht, se gjykatat jo gjithmonë i referohen Agjencisë për vlerësimin dhe administrimin e të gjitha pasurive.

Ripërdorimi i pasurisë të konfiskuara

Aktualisht nuk ka asnjë sistem për ripërdorimin social të pasurisë së konfiskuar. Ekzekutimi i aktgjykimeve të gjykatës në lidhje me konfiskimin e pasurisë dhe pretendimet lidhur me pasurinë juridike vendoset nga gjykata kompetente. Nëse vendimi imponon një konfiskim të sendeve, këto sende automatikisht bëhen pronë e shtetit. Një kopje e vërtetuar e aktgjykimit i dërgohet menjëherë Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, e cila mund t'i shesë objektet ose t'ia dorëzojë ato Qeverisë për përdorim. Paratë e mbledhura nga shitja e pronës shkojnë direkt në buxhetin e shtetit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

KPP-ja (neni 219) parashikon kërkesa ndërkombëtare, duke theksuar se të gjitha kërkesat ndërkombëtare do të bëhen në përputhje me ligjin e Kosovës* “Për bashkëpunimin ligjor ndërkombëtar në çështjet penale” dhe përmes Zyrës së Bashkëpunimit Ligjor Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë. Neni 21 i LKPK-së së re (2018), në mënyrë të dobishme, e përsërit këtë dispozitë duke theksuar se bashkëpunimi ndërkombëtar për qëllim të përmbajtjes dhe konfiskimit do të bëhet në përputhje me ligjin e Kosovës* “Për bashkëpunimin ligjor ndërkombëtar në çështjet penale”. Edhe pse nuk është testuar (nuk ka pasur kërkesa të kësaj natyre), Kosova* nuk ka legjislacion specifik që i lejon asaj të ekzekutojë kërkesa ndërkombëtare bazuar në një procedurë civile të huaj konfiskimi në bazë mosdënimi. Megjithatë, në vitin 2020, Kosova* hartoi një ligj të ri mbi bashkëpunimin juridik ndërkombëtar për çështjet civile. Ky ligj përshkruan kompetencat dhe procedurat kryesore për sigurimin e ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet civile ndërmjet Kosovës* dhe shteteve të huaja. Në veçanti, ligji lehtëson sigurimin e ndihmës së ndërsjellë juridike në çështjet civile në mungesë të një marrëveshjeje të zbatueshme dy ose shumëpalëshe, në rrethanat e reciprocitetit ose të mirëbesimit.

Bashkëpunimi ndërmjet juridiksioneve të tjera dhe institucioneve të Kosovës* përshkruhet nga autoritetet e Kosovës* si i mirë. Kosova* ka shtuar sfidën e bashkëpunimit ndërkombëtar për të mos qenë akoma pjesë e mekanizmave Europol dhe Interpol. Vendi e ka kompensuar këtë duke siguruar që të jenë pjesë integrale e rrjeteve përkatëse për kthimin e pasurive dhe rrjetet e administrimit të pasurive CARIN dhe BAMIN. Koordinatorin Kombëtar për Krimin Ekonomik, i cili është prokurori specialist për kthimin e pasurisë në Kosovë, ka qenë personi i kontaktit i rrjetit CARIN për Kosovën* për disa vite dhe është i njohur mirë në komunitetin global të kthimit të pasurisë. Personi i kontaktit i Kosovës për agjencitë e zbatimit të ligjit ka ndryshuar kohët e fundit dhe mbetet brenda Policisë së Kosovës*.

Sa i takon bashkëpunimit zyrtar, Kosova* ka hyrë në marrëveshje dypalëshe për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale me Shqipërinë, Hungarinë, Italinë, Turqinë, Gjermaninë, Kroacinë dhe Maqedoninë e Veriut. Duke marrë parasysh statusin e saj sfidues politik, Kosova* po punon shumë për krijimin e një bashkëpunimi të mirë ndërkombëtar, përmes Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar brenda Ministrisë së Drejtësisë që luan një rol kryesor. Për shembull, brenda kornizës së projektit rajonal AIRE-RAI, ishte planifikuar një seminar në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar midis Kosovës* dhe Shqipërisë, në mars të vitit 2020. Ky aktivitet fatkeqësisht u shty për shkak të shpërthimit të pandemisë COVID-19.

Matja e efektivitetit

Statistikat për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara mbledhen në nivel qendror në Kosovë* në dy mënyra. Së pari, Agjencia e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar mbledh statistika për pasuritë e vendosura nën administrimin e saj nga gjykatat. Këto statistika përfshijnë numrin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara dhe vlerën e tyre. Për më tepër, Koordinatori Kombëtar për Krimin Ekonomik mbledh rregullisht statistika nga të gjitha institucionet përkatëse. Mbledhja dhe përpilimi i statistikave për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, nga të cilat prodhohet një raport tremujor, është një funksion kryesor i mandatuar i Koordinatorit Kombëtar të Krimin Ekonomik. Aktualisht, agjencitë përkatëse që mbajnë të dhënat (gjykatat, policia, organet e ndjekjes, doganat etj.) nuk janë të lidhura në mënyrë elektronike.

Mbledhja e statistikave nga Koordinatori Kombëtar kryhet manualisht, duke përdorur anëtarët e stafit të caktuar në zyrën e tij. Pa diskutim, udhëtimi në të gjitha zyrat e prokurorisë çdo javë dhe bisedat e drejtpërdrejta me kolegët janë metoda më e saktë për të siguruar kapjen e të gjitha sekuestrimeve dhe konfiskimeve. Nëse është metoda më efikase, kjo është e diskutueshme. Gjithashtu, ndërsa statistikave e mbledhura nga Koordinatori Kombëtar janë kapur në një moment tjetër nga AAPSK-ja, natyrisht do të ketë disa mospërputhje, veçanërisht për pasuritë e konfiskuara, pasi ato ose mund të kthehen në një procedurë së përkohshme të gjykatës, ose nuk janë sjellë në vëmendjen e AAPSK-së pasi gjykatat jo gjithmonë i dorëzojnë ato në Agjenci. Kosova* ka një mundësi të shkëlqyer për të bashkuar proceset dhe burimet dhe për të prodhuar statistika edhe më të sakta sesa aktualisht, duke kombinuar statistikave të Koordinatorit Kombëtar dhe ato të AAPSK, duke i përpunuar ato në një regjistër elektronik.

Në qershor të vitit 2020, Gjykata Themelore e Ferizajt filloi një projekt pilot për të zëvendësuar të gjithë regjistrat manualë të vendimeve gjyqësore me regjistra elektronikë, përmes prezantimit të një sistemi të quajtur CMIS. Të gjitha dokumentet e marra në gjykatë do të hidhen në regjistrat elektronikë përmes sistemit CMIS, duke rritur kështu efikasitetin në gjykatë. Pas përfundimit të projektit pilot në Gjykatën Themelore të Ferizajt, projekti CMIS do të zbatohet në të gjitha gjykatat e tjera në Kosovë*. Nëse rezulton i suksesshëm, ky mund të jetë fillimi i digjitalizimit të regjistrimit të vendimeve, gjë e cila, nga ana tjetër, mund të çojë në shpërndarjen e informacionit tek agjencitë e tjera.

Që nga miratimi i rregullores së BE-së për njohjen reciproke të urdhrave të ngrirjes dhe urdhrave të konfiskimit^[22], standardet evropiane tani kërkojnë gjithashtu mbledhjen e statistikave për kërkesat ndërkombëtare hyrëse dhe dalje për të zbatuar urdhrat për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë. Ministria e Drejtësisë, Departamenti i Bashkëpunimit Ndërkombëtar, është zyra që dërgon dhe merr kërkesa për ndihmë, bazuar në marrëveshje dypalëshe dhe reciprocitet, gjithashtu në lidhje me kthimin e pasurisë dhe angazhimin me juridiksione të huaja për çështje të tilla si ndarja e pasurisë. Nuk është e qartë nëse aktualisht grumbullohen statistika posaçërisht për kërkesat e kthimit të pasurisë, por kjo nuk do të ishte e vështirë të arrihej për këtë zyrë, pasi ajo ka një rekord të dëshmuar të operacioneve të suksesshme në fushën e kthimit të pasurisë në të kaluarën.

5.4 Mali i Zi

Kthimi i pasurive si objekt politikash

Nuk ka asnjë komitet kombëtar të kthimit të pasurive, strategji kombëtare të kthimit të pasurive ose plan veprimi kombëtar të rimëkëmbjes së pasurive në Malin e Zi, brenda të cilit të diskutohen të gjitha aspektet e procesit të kthimit të pasurive. Megjithatë, kthimi i pasurive është në agjendë brenda autoriteteve individuale, aktualisht kryesisht i drejtuar nga sfidat e paraqitura nga dispozitat e konfiskimit të zgjeruar. Konfiskimi i zgjeruar ka qenë një angazhim strategjik dhe politik që nga miratimi i ligjit “Për sekuestrimin dhe konfiskimin e përfitimit material që rrjedh nga aktiviteti penal” (2015). Të gjitha raportet e dërguara në Kuvendin e Malit të Zi mbi punën e gjykatave dhe shërbimet të prokurorisë e trajtojnë gjithashtu këtë çështje të veçantë. Trajnimi i policisë dhe prokurorëve për kryerjen e hetimeve efektive financiare është aktualisht një përparësi politike.

Dispozitat ligjore për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive

Një analizë e hollësishme e dispozitave ligjore të kthimit të pasurive për Shqipërinë përfshihet në botimet e qendrës AIRE dhe RAI-t “*Kthimi i pasurive në Ballkanin Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës (2018)*”, në faqen 64-66 dhe në “*Doracakun mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)*” në faqet 84-94. Kjo pjesë përmban një përmbledhje të kësaj analize, si edhe zhvillimet e reja që prej botimeve të qendrës AIRE dhe RAI-t.

Në Malin e Zi, kthimi i të ardhurave nga krimi rregullohet nga Kodi Penal (KP, 2018) dhe Kodi i Procedurës Penale (KPP, 2018). Për më tepër, Mali i Zi ka ndërmarrë hapin pozitiv të ndërthurjes së dispozitave të tij për kthimin e pasurisë në një ligj të konsoliduar, përmes hartimit të ligjit “Për sekuestrimin dhe konfiskimin e përfitimit material që rrjedh nga aktiviteti penal” (2015) i cili këtu referohet si LKPK. Ky ligj hyri në fuqi në janar të vitit 2016. Ai mbulon procesin e kthimit të të ardhurave ose “përfitimit material” nga krimi përmes dispozitës së konfiskimit të zgjeruar. Ai gjithashtu përfshin dispozita për hetimin financiar, qasjen në informacionin bankar, ngrirjen dhe konfiskimin e përkohshëm, administrimin e pasurisë, konfiskimin, mbrojtjen e palëve

[22] Rregullore (BE) 2018/1805 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 nëntor 2018, mbi njohjen reciproke të urdhrave të ngrirjes dhe urdhrave të konfiskimit.

bona fede, konfiskimin e vlerës ekuivalente, kompensimin e viktimave, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mbledhjen e statistikave (mbajtja e regjistrave). Përfshirja e të gjitha këtyre dispozitave në një instrument e bën LKPK-në një ligj “me një ndalesë” për kthimin e pasurive dhe ligjin më gjithëpërfshirës në rajon. Ligji i ri vë theksin te konfiskimi i të ardhurave nga krimi sesa vetëm në instrumentet ose pasuritë e drejtpërdrejta dhe përmirëson dispozitat e konfiskimit të zgjeruar që ekzistojnë tashmë në KPP-në e vitit 2009.

Në korrik 2019, Parlamenti i Malit të Zi miratoi ndryshime në ligjin “Për konfiskimin e të ardhurave nga krimi”, posaçërisht për të lejuar më shumë kohë për zhvillimin e hetimeve financiare në procedurat e konfiskimit të zgjeruar. Afati i mëparshëm prej 1 viti për prokurorin për të bërë një kërkesë për konfiskimin e përfitimit material, u zgjat në 2 vjet, për të lejuar një periudhë më të gjatë për gjurmimin dhe identifikimin e pasurisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur pasuritë janë transferuar në një juridiksion të huaj, pasi kërkesat ndërkombëtare për informacion mbi vendndodhjen dhe pronësinë e pasurive mund të jenë një proces i gjatë. Mund të jetë shumë shpejt për të vlerësuar nëse kjo ka pasur ndonjë ndikim mbi zbatimin e ligjit.

Konfiskimi i bazuar në mosdënim

Konfiskimi penal i bazuar në mosdënim mund të urdhërohet në rastin e vdekjes, ose kur procesi gjyqësor i hapur nuk mund të vazhdojë për shkak të ekzistencës së rrethanave që përjashtojnë përfundimisht ndjekjen penale. Në raste të tilla, konfiskimi është i mundur vetëm kur gjykata e konsideron të mundshme, në bazë të themelit të provave, që proceset e hapura do të kishin përfunduar me një dënim nëse personi nuk do të kishte vdekur ose nuk do të ishin krijuar rrethanat që përjashtonin përndjekjen në mënyrë të përhershme.

Konfiskimi i zgjeruar

Konfiskimi i zgjeruar ka qenë pjesë e ligjit malazes që nga viti 2009, por nenet e KPP-së të lidhura me këtë dispozitë u shfuqizuan pas miratimit të LKPK-së së re (2015). Rastet që përfshijnë konfiskimin e zgjeruar trajtohen vetëm nga ZPS-ja dhe, megjithëse nuk janë të panjohur me konceptin (pasi ai ekziston që nga viti 2009), prokurorët ende përballen me sfida si për zbatimin e dispozitës, ashtu edhe për përdorimin e saj në mënyrë sistematike. Prokurori duhet të mbledhë prova që tregojnë një shpërpjesëtim të dukshëm midis të ardhurave ligjore dhe pasurive në pronësi, duke argumentuar kështu që pasuritë rrjedhin nga aktiviteti kriminal. Ndryshimet në LKPK që nga fillimi i projektit e kanë zgjatur periudhën gjatë së cilës prokurori duhet të mbledhë këto prova para seancës kryesore nga 1 vit në 2 vjet. Megjithatë, vështirësitë janë të dukshme edhe gjatë seancës kryesore që zhvillohej në fund të periudhës së “hetimit”. Prokurori fillimisht paraqet prova mbi pasuritë që pretendohet të jenë në pronësi të të akuzuarit ose palës së tretë dhe mospërputhjes midis të ardhurave të ligjshme dhe pasurisë. Pas kësaj, barra e provës për të provuar ligjshmërinë e pasurisë zhvendoset tek i akuzuari, i cili më pas ka mundësinë të paraqesë prova për të treguar se pasuria është një përfitim material (neni 40). Pasi të jenë dëgjuar të gjitha provat, gjykata lëshon vendimin e saj. Direktiva e BE-së 2014/42 mbi ngrirjen dhe konfiskimin, parashikon se gjykata duhet të jetë “e kënaqur” që pasuria në fjalë

“rrjedh nga sjellja kriminale”, por nuk thotë për cilin standard, duke e lënë të hapur për juridiksionet që të zgjedhin një standard më të ulët se përtej dyshimit të arsyeshëm, për shembull, standardin e “ekuilibri i probabilitetit”. LKPK-ja (2015) nuk shprehet sa i takon standardit të provës që gjykata duhet të arrijë dhe pasi procesi është proces penal, duket e përshtatshme që gjykata të synojë një standard penal “përtej dyshimit të arsyeshëm”. Në Malin e Zi, ashtu si në juridiksionet e tjera në rajon, ka ende një mungesë udhëzimesh në ligjin përkatës dhe praktikën gjyqësore se si të vendoset për përcaktimin e origjinës së paligjshme të pasurisë. Pas rekomandimeve të bëra në kuadër të projektit rajonal të qendrës AIRE dhe RAI-t, planifikohej të zhvillohej program trajnimi, brenda kurrikulës së Akademisë Gjyqësore. Fatkeqësisht, për shkak të pandemisë COVID-19, ai ende nuk është realizuar. Trajnimi mbi dispozitat ligjore të konfiskimit të zgjeruar dhe zbatimit të tyre do të fillojë sapo të hiqen kufizimet. Për më tepër, për të ndihmuar për zbatimin e dispozitave të konfiskimit të zgjeruar, do të ishte i dobishëm këshillimi i drejtpërdrejtë në bazë të çështjeve, së bashku me një analizë të çështjeve aktuale dhe të mëparshme për të identifikuar pengesat për praktikën më të mira në përdorimin e saj.

Konfiskimi civil ose administrativ i bazuar në mosdënim

Kuadri legjislativ i Malit të Zi nuk parashikon konfiskimin e pasurive të përfituara në mënyrë kriminale, pa dënim, në procedurat civile ose administrative.

Hetimi financiar

Mundësitë ligjore për hetim financiar parashikohen si në KPP (2018), ashtu edhe për LKPK (2015). Neni 11 i LKPK-në (2015) përcakton që një prokuror i shtetit mund të lëshojë një urdhër për fillimin e një hetimi financiar pas përmbushjes së disa kushteve të përcaktuara. Për më tepër, sipas nenit 14 të LKPK-së (2015), policia kryen një hetim financiar për të identifikuar të ardhurat e krimit ose me iniciativën e vet, ose me urdhër të prokurorit të shtetit të ngarkuar me hetimin financiar. KPP-ja (2018) lejon qasjen në informacionin financiar të bankave dhe institucioneve të tjera financiare pasi gjyqtari hetues lëshon një urdhër për bankën për të vënë në dispozicion informacionin bankar dhe llogaritë bankare, me kërkesën e prokurorit të shtetit (KPK neni. 257b). Për më tepër, LKPK-ja (2015) parashikon se gjyqtari hetues mund t'i urdhërojë bankat dhe institucionet e tjera financiare të vënë në dispozicion të dhëna të disponueshme që mund të përdoren si prova për qëllimin e kryerjes së hetimeve financiare. Megjithatë nuk përmendet në mënyrë specifike, monitorimi i llogarive bankare është i mundur sipas ligjit aktual.

Si një aspekt kryesor i LKPK-së së Malit të Zi, neni 16 specifikon në mënyrë specifike se informacioni financiar i mbledhur gjatë hetimit penal mund të përdoret në hetimin financiar, dhe anasjelltas. Megjithatë procesi i hetimit paralel financiar shihet si praktikë e mirë në nivelin global, përfshirë edhe dispozitat e LKPK-së, është e rëndësishme të nënvizojmë relevancën dhe rëndësinë e tij jetike për procesin.

Raportet e mëparshme të projektit AIRE-RAI kanë arritur në përfundimin se, në përgjithësi, aftësia për të kryer hetime financiare si nga organet e zbatimit të ligjit, ashtu edhe nga prokurorët është e ulët. Nuk ka mjaftueshëm persona me aftësitë e

nevojshme për të kryer hetime financiare të dedikuara posaçërisht të kthimi i pasurive. Që nga viti 2018, Zyra e Prokurorisë Speciale (e cila merret me konfiskimin e zgjeruar) ka rekrutuar ekspertë shtesë dhe është bërë përparim për të përmirësuar hetimet financiare.

Projekti EUROL 2 ka organizuar trajnime për prokurorët dhe policinë në Akademinë e Policisë, në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit Gjyqësor. Programi i trajnimit fillestar u pasua nga një vizitë studimore disaditore në Itali në korrik të vitit 2019.

Zyra për Kthimin e Pasurive (ZRP)

Që nga fillimi i projektit rajonal AIRE-RAI, Mali i Zi ka krijuar një Zyrë Kombëtare të Kthimit të Pasurisë (ZRP), brenda Divizionit të Policisë për Bashkëpunimin Policor Operacional, e cila është gjithashtu zyra që lehtëson shkëmbimin e informacionit me Interpolin, Europolin dhe Sirenen. ZRP-ja është themeluar në vitin 2019, në bazë të ligjit “Për punët e brendshme” dhe ka lehtësuar shumë kërkesa duke përdorur kanalet ARO, CARIN, Interpol dhe Europol. Bashkëpunimi midis ZRP-së dhe AMP-së me zyrat e kthimit të pasurive të BE-së parashikohet ligjërisht sipas LKPK-së (neni 79), i cili parashikon se njësi policore organizative kompetente për hetime financiare vepron sipas kërkesave në përputhje me vendimin e Këshillit të BE-së 2007/845/DPB, datë 6 dhjetor 2007. Megjithatë, nuk është e qartë nëse Divizioni për Bashkëpunim Policor Ndërkombëtar është “njësia policore organizative kompetente për hetimet financiare”. Vendndodhja e NjIF-it të Malit të Zi ka ndryshuar kohët e fundit. Njësia ka kaluar nga Ministria e Financave te Ministria e Punëve të Brendshme, duke e vendosur atë nën të njëjtën ministri me ZRP-në, megjithëse brenda një vendi tjetër në organigramë. Direktiva e sapomiruar (BE) 2019/1153 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit që përcakton rregullat që lehtësojnë përdorimin e informacionit financiar dhe informacionit tjetër për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të disa veprave penale, përcaktohet në nenin 3, paragrafi 1, të saj se autoritetet mund të kenë qasje të drejtpërdrejtë dhe të kërkojnë në regjistrat kombëtarë të llogarive të centralizuara bankare, duke deklaruar se “këto autoritete kompetente do të përfshijnë të paktën zyrat e kthimit të pasurive. Lejimi i aksesit të drejtpërdrejtë të ZRP-së së Malit të Zi në Regjistrin e Bankës Qendrore Kombëtare, i cili mbahet nga Banka Qendrore e Malit të Zi, mund të kërkojë një ndryshim të LKPK-së (2015).

Zyra për Administrimin e Pasurive (ZAP)

“Doracak u mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)” ofron një ndarje të dobishme të dispozitave ligjore brenda LKPK-së (2015) për menaxhimin e pasurisë në Malin e Zi, përfshirë funksionet e ZAP-së (neni 53) dhe informacionin që regjistrohen. Përveç LKPK-së, kompetencat e ZAP-së përcaktohen në dekretin “Për qiradhënien e produkteve të sekuestruara/konfiskuara të krimit” dhe dekretin “Për shitjen e produkteve të sekuestruara nga krimet”. Zyra për Administrimin e Pronës Shtetërore, nën Ministrinë e Financave, ka kryer funksionet e zyrës kombëtare të administrimit të pasurisë për disa vite. Ndërsa juridiksioni ka përmirësuar zbatimin e ligjit për konfiskimin e zgjeruar, kësaj zyre do t’i kërkohej të administrojë një numër të rritur të pasurive që çojnë në testimin e legjislacionit, proceseve dhe kapaciteteve ekzistuese për efektshmëri.

Ripërdorimi i pasurive të konfiskuara

Nuk ka një fond të veçantë ku mbledhen paratë nga pasuritë e konfiskuara për përdorim të mundshëm në projektet shtetërore dhe sociale të komunitetit. Paratë e mbledhura nga shitja e pasurive të konfiskuara derdhen në buxhetin e shtetit. Në rast të një shitjeje të pasuksesshme, pasuria e konfiskuar mund të dhurohet për qëllime humanitare ose t'i besohet për përdorim një organi shtetëror ose një organi administrativ publik.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Neni 78 i LKPK-së (2015) përmban dispozita të bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me ngrirjen dhe sekuestrimin, konfiskimin dhe administrimin e produkteve kriminale, përmes traktatit ndërkombëtar ose reciprocitetit. Baza për bashkëpunimin ndërkombëtar në Malin e Zi, si në shumicën e juridiksioneve, janë dispozitat për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale. Nuk është e qartë nëse Mali i Zi është në gjendje t'u përgjigjet kërkesave nga një juridiksion i huaj për të zbatuar urdhrat e ngrirjes, të sekuestrimit dhe të konfiskimit bazuar në proceset e konfiskimit civil të bazuar në mosdënim pasi kjo nuk është testuar kurrë, megjithëse kjo është e dyshimtë.

Neni 83 i ligjit "Për sekuestrimin dhe konfiskimin" parashikon afatet kohore për masat e përkohshme mbi pasuritë e administruara në Mal të Zi për llogari të një juridiksioni kërkues. Pas 18 muajsh, juridiksioni kërkues informohet se pasuria do të kthehet pas dy vitesh. Kjo periudhë mund të zgjatet maksimumi deri në 3 vjet pas aplikimit nga shteti kërkues në gjykatë.

Nevoja për të përdorur mekanizmat rajonalë të krijuar për të lehtësuar kthimin e pasurive ndërkombëtare, d.m.th. CARIN, BAMIN dhe STAR, është theksuar brenda "*Doracakut mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)*". Personi i kontaktit i zbatimit të ligjit në rrjetin CARIN në Malin e Zi ndodhet brenda Departamentit të Krimit Financiar dhe Ekonomik të Policisë. I njëjti person ka mbetur personi kontakti për disa vjet, gjë e cila është një qasje e shkëlqyeshme për ndërtimin e marrëdhënieve me jashtë në nivel ndërkombëtar. Si porta e vetme e kontaktit me rrjetet globale të kthimit të pasurive (rrjetet ndërinstitucionale të rimëkëmbjes së pasurive), personi i kontaktit i zbatimit të ligjit në rrjetin CARIN duhet të jetë i njohur dhe i lidhur mirë brenda vendit si për hetimet operacionale, kërkesat, ashtu edhe për zhvillimin strategjik. Në fillim të projektit AIRE-RAI, Mali i Zi nuk kishte caktuar një kontakt nga prokuroria në rrjetin CARIN. Kjo mangësi operacionale është plotësuar me caktimin e personit të kontaktit në rrjetin CARIN nga brenda Zyrës së Prokurorit të Posaçëm.

Neni 79 i ligjit "Për sekuestrimin dhe konfiskimin" mandaton njësinë organizative të policisë kompetente për hetime financiare (brenda së cilës gjendet pika e kontaktit në rrjetin CARIN) të merret me çdo kërkesë për pasuritë që vjen nga juridiksionet e BE-së, bazuar në vendimin e Këshillit 2007/845/DPJ, datë 6 dhjetor 2007 (shih seksionin për krijimin e ZRP-së në Mal të Zi).

Matja e efektivitetit

Neni 77 i LKPK-së (2015) përshkruan mbajtjen e regjistrave për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin. Në të parashikohet që regjistrat mund të mbahen në formë manuale ose në mënyrë elektronike. LKPK-ja sugjeron një listë gjithëpërfshirëse të statistikave që do të mblidhen, në përputhje me direktivën e BE-së “Për ngrirjen dhe konfiskimin” dhe standardet e FATF-së. Megjithatë, nuk përcaktohet se cili institucion është përgjegjës për mbajtjen e regjistrave. Institucionet malazeze kompetente dhe përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave për kthimin e pasurisë në vend janë Gjykata e Lartë, Prokurori i Lartë i Shtetit, Policia, Agjencia për Pronën dhe Zyra e Qeverisë për Integrimin Evropian. Juridiksionet e tjera në rajon kanë mandatuar jo në mënyrë të papritur zyrat e tyre kombëtare të administrimit të pasurive për të mbledhur statistikën kombëtare të kthimit të pasurive. Përmes caktimit të Zyrës Kombëtare të Administrimit të Pasurive, edhe Mali i Zi mund ta konsiderojë atë vendin më të përshtatshëm për t’u mbajtur Regjistri Elektronik Kombëtar i Statistikave për Pasuritë e Sekuestruara dhe të Konfiskuara, në mënyrë që të vërë në dispozicion shifra gjithëpërfshirëse. Që nga viti 2016, të dhënat statistikore vjetore mbahen nga Zyra e Prokurorit Special. Këto regjistra tregojnë numrin dhe llojin e çështjeve në kuadër të të cilave ka ndodhur sekuestrimi dhe konfiskimi i përkohshëm, qoftë përmes një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë, ose me urdhër të gjykatës, dhe shumat përkatëse. Kjo qasje ofron në një farë mënyre statistika bazë për vlerësim.

5.5 Maqedonia e Veriut

Kthimi i pasurive si objekt politikash

Kthimi i pasurisë është një pjesë formale dhe integrale e të gjitha strategjive të mëparshme kombëtare për reformimin e gjyqësorit. Agjencia Kombëtare e Administrimit të Pasurive, e krijuar në kuadër të ligjit “Për administrimin e pasurive të konfiskuara” (2008), ka hartuar dy plane strategjike, (për periudhat 2014-2016 dhe 2018-2020). Plani Strategjik 2018 - 2020 përfshin edhe një plan veprimi për të forcuar kapacitetin për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurive, duke parashikuar krijimin e një Komisioni Kombëtar për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Ky duhet të njihet si hap pozitiv drejt futjes së një qasjeje sistematike për kthimin e pasurive. Sidoqoftë, ai duhet të zbatohet në praktikë dhe të zhvillohet më tej, gjë që mund të kërkojë mbështetje të mëtejshme nga specialistë të jashtëm ndërkombëtarë.

Dispozitat ligjore për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive

Një analizë e hollësishme e dispozitave ligjore të kthimit të pasurive për Shqipërinë përfshihet në botimet e qendrës AIRE dhe RAI-t “*Kthimi i pasurive në Ballkanin Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës (2018)*”, në faqen 60-64 dhe në “*Doracakun mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)*” në faqet 105-114. Kjo pjesë përmban një përmbledhje të kësaj analize, si edhe zhvillimet e reja që prej botimeve të qendrës AIRE dhe RAI-t.

Në Maqedoninë e Veriut, legjislacioni për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e mjeteve dhe të ardhurat nga krimi parashikohet në Kodin Penal (2018) dhe Kodin e Procedurës Penale (2018). Nuk është miratuar asnjë ligj i veçantë për konfiskimin dhe nuk ka plane për hartimin e një ligji të tillë. Duke qenë kështu, dispozitat thelbësore për konfiskimin e zgjeruar përfshihen në dispozitat e KP-së dhe dispozitat procedurale në KPP-së. Një shpjegim gjithëpërfshirës i dispozitave të kthimit të pasurive në Maqedoninë e Veriut gjendet në *“Doracakun mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)”*, botim i qendrës AIRE dhe RAI-t. Nuk ka pasur ndonjë instrument të ri të kthimit të pasurive të miratuar ose ndryshime të dispozitave ekzistuese të kthimit të pasurive që nga viti 2018. Megjithatë, aktualisht është krijuar një grup pune brenda Ministrisë së Drejtësisë për të shqyrtuar disa ndryshime në KPK për të siguruar një perspektivë më të mirë për konfiskimin. Ministria e Drejtësisë gjithashtu ka krijuar një grup pune për të punuar për hartimin e një KP-je të re, duke përfshirë çështjet në lidhje me konfiskimin.

Konfiskimi i instrumenteve dhe objekteve të drejtpërdrejta të krimit, dhe i të ardhurave nga krimi, konfiskimi i bazuar te vlera dhe konfiskimi i palëve të treta janë të gjitha të parashikuara brenda KP-së dhe KPP-së, siç janë mbrojtja e të drejtave të palëve të treta *bona fide*; megjithatë jurisprudenca e analizuar në kuadër të raporteve të mëparshme të qendrës AIRE dhe RAI-t ka theksuar se dispozitat dhe garancitë lidhur me konfiskimin për palët e treta dhe mbrojtja e të drejtave të palëve të treta *bona fide* do të përfitonin nga ndryshimet e legjislacionit.

Raportet e botuara brenda projektit rajonal AIRE-RAI sugjerojnë se ekziston nevoja për të përcaktuar më mirë instrumentet, institucionet dhe procedurat që lejojnë kthimin e pasurive në Maqedoninë e Veriut, veçanërisht në lidhje me konfiskimin e zgjeruar, dhe kjo nevojë mbetet ende aktuale në kohën e shkrimit të këtij raporti. Grupi i punës i MD-së për hartimin e Kodit të ri Penal i trajton këto çështje.

Konfiskimi i bazuar në mosdënim

Konfiskimi i bazuar në mosdënim brenda proceseve penale përfshihet brenda kornizës legjislative të Maqedonisë së Veriut. Pasuritë të cilat duhet të konfiskohen sipas KP-së konfiskohen gjithashtu edhe kur proceset penale nuk kanë përfunduar me një vendim që konstaton fajësinë e të akuzuarit, për shembull në rast të vdekjes ose mungesës së të dyshuarit. Në këtë rast zbatohet një procedurë e veçantë për konfiskimin e pasurive dhe të produkteve të veprës penale dhe konfiskimin e mjeteve kur ka pengesa faktike ose ligjore për të kryer procese penale kundër autorit të një vepre penale. Në këto raste, gjykata, me një propozim të prokurorit publik, zhvillon procese të posaçme gjyqësore për konfiskimin e pasurive dhe produkteve të veprës penale dhe konfiskimin e instrumenteve, nëse plotësohen kushtet e Kodit Penal.

Konfiskimi i zgjeruar

Si KP-ja (neni 98a), edhe KPP-ja përfshijnë dispozita për konfiskim të zgjeruar, të cilat përshkruhen plotësisht në *“Doracakun mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)”*. Sugjerohet se ekzistojnë shumë pak raste kur është aplikuar ose kur është tentuar të aplikohet konfiskimi i

zgjeruar. Arsyet për këtë, siç shpjegohet në doracak, mbeten ende të pranishme dhe përfshijnë mungesën e përgatitjes së prokurorëve, proceset gjyqësore shumë të gjata dhe mungesa e përgjithshme e të kuptuarit të prokurorëve dhe gjyqtarëve se si të zbatojnë ligjin. Ndryshe nga shumica e juridiksioneve të tjera në rajon, me përjashtim të Kosovës*, prova e bilancit se vlera e pasurisë së të pandehurit tejkalon të ardhurat e tij ligjore dhe se rrjedh nga një krim për të cilin zbatohet konfiskimi i zgjeruar kryhet nga gjykata në bazë të standardit të 'bilancit të probabilitetit'. Megjithatë, nuk ka asnjë dispozitë që përcakton shprehimisht mënyrën e përcaktimit të origjinës së paligjshme të pasurisë. Neni 98-a (1) i KP-së përcakton qartë se, brenda një periudhe të caktuar kohe dhe pas dënimit për krime të caktuara, kur gjykata "është e bindur mirë se pasuria i tejkalon të ardhurat e ligjshme të autorit dhe buron nga krime të tilla" mund të konfiskohen pasuritë. KPP-ja (2018) gjithashtu ofron dispozita të konfiskimit të zgjeruara për përcaktimin e fakteve të çështjes për të cilat lejohen proceset penale. Megjithatë, mbeten ende të pranishme problemet rreth përcaktimit të origjinës së paligjshme të pasurisë sipas standardit të kërkuar.

Konfiskimi civil ose administrativ i bazuar në mosdënim

Maqedonia e Veriut nuk ka përfshirë dispozitat për konfiskimin civil ose administrativ në kornizës ligjore për kthimin e pasurive kriminale në mënyrë që të mbledhë produktet e krimit.

Hetimi financiar

Neni 530 i KPP-së parashikon bazën ligjore për gjurmimin dhe identifikimin e pasurive dhe të ardhurave të fituara përmes kryerjes së një veprë penale. Prokurori publik është i detyruar të mbledhë prova gjatë proceseve gjyqësore dhe të hetojë rrethanat me rëndësi për përcaktimin e pasurive dhe të ardhurave dhe të propozojë masat e përmendura në nenin 202 të KPP-së. Gjatë përcaktimit të shumave të pasurive ose të të ardhurave të fituara nga një veprë penale, prokurori publik mund të kërkojë një raport nga organe të tjera shtetërore, institucionet financiare ose persona juridikë ose qytetarë, të cilët janë të detyruar të paraqesin informacionin pa asnjë vonesë. Nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se pasuritë gjenden jashtë shtetit, gjykata është e detyruar të lëshojë një kërkesë ndërkombëtare.

Zyra e Prokurorisë Publike (ZPP) është në përgjithësi përgjegjëse për hetimet financiare. Gjatë trajtimit të çështjeve nën juridiksionin e ZPP-së, prokurori publik bashkëpunon me një gamë të gjerë agjencish dhe organeve, duke përfshirë Policinë Financiare, Ministrinë e Brendshme, Zyrën e të Ardhurave Publike, doganat, Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Zyrën e Kontrollit të Shtetit, Zyrën e Auditimit të Valutave të Shtetit, Inspektoratin Shtetëror të Tregut dhe organe të tjera inspektimi, organe shtetërore dhe persona juridikë të ngarkuar me detyrat e parandalimit dhe zbulimit të veprave penale sipas ligjit. Organet e administratës shtetërore dhe organet e tjera shtetërore, institucionet ose personat juridikë që mbledhin të dhëna dhe mbajnë regjistra, në përputhje me ligjin, janë të detyruar t'i paraqesin këto të dhëna me kërkesë të prokurorit publik ose nëse kërkohet nga Policia Financiare. Prokurori publik gjithashtu mund të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion me prokurorët, polici të huaja dhe organe shtetërore nga vendet dhe

organizatat e tjera që veprojnë në fushën e krimit financiar, në bazë të marrëveshjeve bilaterale dhe traktateve ndërkombëtare të ratifikuara në lidhje me çështjet që bien në juridiksionin e prokurorit. Megjithatë, prokurori publik mund të bëjë kërkime në të gjitha bazat e të dhënave, llogaritë bankare, shënimet dhe pasqyrat e Zyrës së të Ardhurave Publike, Zyrën e Kadastrës, regjistrat e letrave me vlerë, regjistrat e automjeteve motorike dhe në baza të tjera të të dhënave vetëm në bazë të një urdhri gjykate. Kjo nuk është një procedurë efikase dhe ndryshimet legislative dhe procedurale do të sillnin ndryshime pozitive.

Legjislacioni, gjithashtu, lejon që llogaritë bankare të monitorohen në kushte të caktuara të parashikuara në KPP. Gjatë fazës së hetimit paraprak ose fazës së hetimit, me kërkesë të prokurorit publik në lidhje me pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme, gjyqtari i procedurës paraprake mund të marrë një vendim për monitorimin e llogarisë, ndërsa një vendim i tillë, pas ngritjes së padisë, merret nga gjyqtari i procesit. Gjyqtari i procedurës paraprake duhet të marrë vendim brenda 12 orëve nga momenti i marrjes së kërkesës. Nëse gjyqtari nuk e pranon kërkesën e prokurorit publik, ai ose ajo i kërkon trupit gjykues të vendosë për kërkesën pa asnjë vonesë. Trupi gjykues merr vendim brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së kërkesës së prokurorit publik. Me kërkesë të prokurorit publik, gjyqtari i procedurës paraprake mund të lëshojë urdhër për një bankë ose institucion tjetër financiar për të monitoruar qarkullimin financiar në lidhje me atë person dhe për t'i raportuar rregullisht prokurorit publik në intervalet e kohës të specifikuara në vendim. Në bazë të kërkesës së arsyetuar të prokurorit publik, gjykata mund të urdhërojë gjithashtu një institucion financiar ose një subjekt tjetër juridik të ndalojë ekzekutimin e transaksioneve të caktuara financiare ose të konfiskojë përkohësisht aktive të caktuara.

Në raste urgjente, prokurori publik mund të përcaktojë masa të veçanta në lidhje me transaksionet financiare ose pasuritë pa një urdhër gjykate. Në raste të tilla, prokurori publik informon menjëherë gjyqtarin e procedurës paraprake, i cili, brenda 72 orëve, duhet të nxjerrë një urdhër. Nëse gjyqtari nuk e nxjerr urdhrin, prokurori publik do të kthejë të dhënat dhe nuk mund të mos i hapë ato përpara vendimit të gjyqtarit.

Maqedonia e Veriut ka krijuar një Njësi të Policisë Financiare të veçantë, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për Policinë Financiare” (Fletorja Zyrtare nr. 12/14, botuar më 22.01.2014). Ligji “Për Policinë Financiare” mbulon hetimin financiar dhe parashikon një gamë të gjerë detyrash dhe mekanizmash hetues, duke përfshirë:

- » Zbulimin dhe kryerjen e hetimeve penale për vepra penale që ndiqen *ex officio*, të tilla si pastrimi i parave dhe të ardhura të tjera nga një vepër penale (neni 273), tregtia e paautorizuar (neni 277), kontrabandimi (neni 278), evazioni fiskal (neni 279);
- » Grumbullimin dhe analizimin e të dhënave të transaksioneve në para (*cash*);
- » Marrjen e masave gjatë fazës së hetimit paraprak dhe masave të tjera kur ka dyshime të arsyeshme për vepra penale të kryera;
- » Monitorimin e lëvizjes së parave me qëllim zbulimin e veprave penale të përcaktuara me ligj;
- » Kryerjen e analizave kompjuterike kriminalistike të sistemeve kompjuterike të konfiskuara përkohësisht dhe pajisjeve të tjera elektronike;

- » Depozitimin e kallëzimeve penale para prokurorit publik kompetent për t'u marrë me veprat penale që bien në juridiksionin e tij/saj, të cilat ndiqen penalisht *ex officio*;
- » Depozitimin e një iniciative për nxitjen e procedurave tatimore ose procedurave të tjera për përcaktimin dhe mbledhjen e detyrimeve publike para organeve kompetente;
- » Koordinimin, fillimin dhe ngritjen e akuzave për veprime të dënueshme.

Neni 200 i KPP-së, parashikon dispozita për qasjen në informacionin bankar, me kërkesë të një prokurori para gjykatës. Për më tepër, Policia Financiare, brenda kuadrit të ligjit “Për Policinë Financiare”, ka qasje të drejtpërdrejtë në informacione bankare dhe të tjera financiare pa pasur nevojë për të marrë një urdhër nga gjykata.

Raportet e mëparshme të qendrës AIRE dhe RAI-i kanë arritur në përfundimin se aftësitë për të kryer hetime financiare si nga agjencitë e zbatimit të ligjit, ashtu edhe nga prokurorët janë të ulëta. Edhe duke marrë parasysh ligjin “Për Policinë Financiare”, studimi i qendrës AIRE dhe RAI-t nënvizoi disa mangësi të instrumenteve efektive për gjurmimin dhe identifikimin e pasurive, regjistra jo të plotë të pasurive, mungesën e njësive të specializuara për gjurmimin e pasurive dhe mungesën e koordinimit ndërinstytucional.

Që nga viti 2018, Maqedonia e Veriut ka krijuar qendra hetimore brenda zyrave të prokurorisë. Megjithëse është shumë herët për të vlerësuar ndikimin e këtij ndryshimi, kjo duket një lëvizje pozitive e ndërmarrë si kundërpërgjigje e njohjes së kapacitetit të dobët në këtë fushë, të ngritur gjithashtu edhe nga raportimi i qendrës AIRE dhe RAI-t.

Trajnimet mbi hetimet financiare të prokurorëve dhe gjyqtarëve organizohen në mënyrë të rregullt nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, nuk ka edukim dhe trajnim të specializuar për zyrtarët e zbatimit të ligjit në lidhje me hetimin financiar për të gjurmuar dhe identifikuar pasuritë të cilat më vonë mund t'i nënshtrohen konfiskimit.

Zyra për Kthimin e Pasurive (ZRP)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ende nuk ka caktuar zyrtarisht një zyrë kombëtare për kthimin e pasurive (ZRP) për t'u marrë me pasuritë e fituara përmes veprimtarisë kriminale. Pavarësisht kësaj, një prokuror i lartë brenda Prokurorisë Publike në Shkup është emëruar si “eksperti” kombëtar për çështjet që lidhen me kthimin e pasurive, duke e kryer këtë rol së bashku me shumë angazhime të tjera. Kërkohet si përparësi mbështetja e mëtejshme për këtë prokuror dhe për planin për krijimin e një ZRP-je, pra ndërtimi i kapaciteteve dhe njohurive më të konsoliduara, në mënyrë që të krijohet një ZRP plotësisht funksionale në përputhje me standardet e BE-së. Kjo mund të përfshijë ndryshime legjislative, veçanërisht në lidhje me qasjen te bazat e të dhënave pa nevojën e një urdhri gjykate. Një grup pune i përbërë nga profesionistë të fushës dhe përfaqësues akademikë dhe shkencorë kanë hartuar një version pune të ligjit për ZRP-në, i cili së shpejti do të futet në procedurën e miratimit. Praktika më e mirë e BE-së përfshin si qasjen e drejtpërdrejtë te bazat e të dhënave për gjurmimin e pasurive edhe lehtësinë e qasjes në të dhëna (pa një urdhër gjykate)

si tregues të efektivitetit për ZTP-të kombëtare, brenda një liste prej 11 treguesish të efektivitetit. Sipas standardeve të BE-së, ZRP-të duhet të kenë qasje në një regjistrë qendror kombëtar të llogarive bankare^[23].

Zyra për Administrimin e Pasurive (ZAP)

Zyra e Administrimit të Pasurive (Agjencia për Administrimin e Pronës së Sekuestruar (AAPS) u krijua në janar të vitit 2009, me hyrjen në fuqi të ligjit “Për administrimin e pasurive të konfiskuara, të ardhurave dhe instrumenteve të konfiskuara në proceset penale dhe kundërvajtje”, nr. 98, datë 04.08.2008). Ajo është një agjenci e pavarur, e cila varet drejtpërdrejt nga qeveria. Agjencia menaxhohet nga një bord menaxhues i përbërë nga pesë anëtarë. Këta anëtarë ishin përfaqësues zyrtarë të secilës prej ministrive (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Zyra e Avokatit të Shtetit), një përfaqësues nga secila prej tyre. Megjithatë, pas një ndryshimi ligjor në vitin 2016 kjo situatë ndryshoi, duke lejuar që anëtarët e bordit të rekrutohen drejtpërdrejt nga të gjitha sferat e shoqërisë.

Funksionet e AAPS-së rregullohen me ligj. Mandati i Agjencisë është të administrojë pasuritë e konfiskuara, të ardhurat kriminale dhe mjetet e konfiskuara dhe, me pëlqimin e gjykatës dhe autoriteteve kompetente, të administrojë pasuritë e ngrira dhe të sekuestruara përkohësisht, të ardhurat dhe instrumentet kriminale në mënyrë që të ruajë vlerën e këtyre pasurive. Agjencia kryen të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me administrimin e pasurive, duke përfshirë ruajtjen, kryerjen e vlerësimeve të gjendjes fizike dhe vlerës, mirëmbajtjen e regjistrave të të gjitha pasurive nën administrimin e saj dhe shitjen e pasurive. Ajo është gjithashtu përgjegjëse për mirëmbajtjen e raporteve statistikore, financiare dhe raporteve të tjera mbi pasuritë nën administrim. Zyra është udhëheqëse sa i takon trajnimit në lidhje me menaxhimin e pasurisë si për punonjësit e Agjencisë, ashtu edhe për subjektet dhe organet e tjera të përfshira në procedurën e sekuestrimit dhe konfiskimit. Ajo ofron mendime në lidhje me zbatimin e ligjit “Për administrimin e pasurive të konfiskuara” dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj.

Ligji për administrimin e pasurive është aktualisht nën rishikim. Një grup pune, i krijuar në vitin 2020, ka hartuar një ligj të ri për administrimin e pasurive duke përfshirë një paketë gjithëpërfshirëse të ndryshimeve të cilat do të miratohen nga Parlamenti.

Ripërdorimi i pasurive të konfiskuara

Aktualisht nuk ka një fond të veçantë ku mblidhen paratë nga pasuritë e konfiskuara për përdorim të mundshëm në projektet shtetërore dhe sociale të komunitetit në Maqedoninë e Veriut. Pavarësisht kësaj janë vërejtur shembuj të mirë të ripërdorimit të objekteve të drejtpërdrejta nga krimi. Pasuritë që prishen ose që kanë vlerë të ulët u janë dhuruar organizatave bamirëse nga Agjencia.

[23] Direktiva (BE) 2019/1153 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit që përcakton rregullat që lehtësojnë përdorimin e informacionit financiar dhe informacionit tjetër për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të disa veprave penale, përshkruan në nenin 3, paragrafi 1 autoritetet që mund të kenë qasje të drejtpërdrejtë dhe të kërkojnë në regjistrat kombëtar të llogarive të centralizuara bankare, duke deklaruar se: “Këto autoritete kompetente do të përfshijnë të paktën Zyrat e Kthimit të Pasurive’.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Baza për bashkëpunim zyrtar ndërkombëtar në lidhje me kthimin e pasurive është ligji “Për bashkëpunim ndërkombëtar në çështjet penale” (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 124/10). Për më tepër, janë përfunduar marrëveshje bilaterale me shtetet fqinje. Republika e Maqedonisë së Veriut është palë në disa traktate kryesore ndërkombëtare për kthimin e pasurive, përfshirë Konventën evropiane për ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale dhe protokollet e saj shtesë (ETS 3016, 9917 dhe 18218); Konventën evropiane për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi (ETS 1419); Konventën evropiane të së drejtës penale për korrupsionin (ETS 17320) dhe protokollin e saj shtesë (ETS 19121); Konventën e KiE-s për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe financimin e terrorizmit (CETS 19822).

Maqedonia e Veriut është anëtare e rrjetit CARIN që nga viti 2014. Republika e Maqedonisë së Veriut kohët e fundit ka emëruar “prokurorin special” të saj për kthimin e pasurive brenda ZPP-së, i parashikuar të jetë pjesë e ZRP-së, për të qenë kontakti i saj në rrjetin CARIN, krahas personit të kontaktit të emëruar brenda policisë. Ky përbën hap pozitiv dhe e vendos Maqedoninë e Veriut në mënyrë të konsoliduar brenda rrjetit global të ekspertëve të kthimit të pasurive si për angazhimin operacionale, ashtu edhe për atë strategjik. Republika e Maqedonisë së Veriut është e harmonizuar me organet institucionale të BE-së, Europolin dhe Eurojustin. Ajo ka një marrëveshje operacionale me Europolin që nga viti 2011 dhe që nga viti 2015 ka një oficer ndërlidhës të atashuar në selinë e Europolit në Hagë. Republika e Maqedonisë së Veriut nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Eurojustin në vitin 2008, e cila hyri në fuqi në vitin 2010. Ajo është gjithashtu anëtare e rrjetit BAMIN.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e kthimit të pasurive kërkon që juridiksionet të kenë aftësinë ligjore dhe procedurale për t’iu përgjigjur shpejt kërkesave për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive në emër të një juridiksioni tjetër, ose pas marrjes së informacionit nga një juridiksion tjetër. Shfaqja e efektivitetit në këtë fushë kërkon mirëmbajtjen e statistikave në nivelin qendror për kërkesat ndërkombëtare (shih pjesën *Matja e efektivitetit*). Megjithëse statistikave nuk janë gjithëpërfshirëse në këtë fushë, Maqedonia e Veriut mund të japë shembuj të rasteve të bashkëpunimit ndërkombëtar aktualisht në vijim e sipër në lidhje me kthimin e pasurive.

Legjislacioni i brendshëm i Maqedonisë së Veriut parashikon sekuestrimin ose konfiskimin e me bazë mosdënimi në procedurat penale, në lidhje me personat fizikë dhe personat juridikë që kanë kryer vepra penale, përfshirë këtu kur një i dyshuar ka vdekur, është larguar në drejtim të paditur ose është ndryshe i padisponueshëm (neni 540, LKP). Përgjigja ndaj urdhrave nga juridiksionet e huaja është gjithashtu e mundur, duke e sjellë Maqedoninë e Veriut në përputhje me standardet ndërkombëtare. Nuk është e qartë nëse janë marrë kërkesa nga juridiksionet e huaja bazuar në procedura civile ose administrative të bazuara në mosdënime, megjithatë për shkak se Maqedonia e Veriut nuk ka një ligj të brendshëm për këtë, është e dyshimtë nëse Maqedonia e Veriut do të ishte në gjendje t’u përgjigjej kërkesave të tilla.

Gjatë periudhës së projektit, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 12 qershor 2019, nënshkroi një memorandum mirëkuptimi dhe marrëveshje të bashkëpunimit të ndërsjellë me Drejtorinë Kombëtare për Ndjekjen e Mafies dhe Terrorizmit të Republikës së Italisë, e cila parashikon ndarjen e pasurive ndërmjet juridiksioneve.

Deri më sot, nuk ka shembuj të ndarjes së pasurive me një juridiksion tjetër, megjithëse parashikohet një marrëveshje dhe ndarje e pasurive në të ardhmen me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në lidhje me një çështje pezull.

Matja e efektivitetit

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka të dhëna të centralizuara për pasuritë e ngrira, të sekuestruara dhe të konfiskuara dhe për vlerën e tyre. Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave statistikore është detyrë e disa institucioneve. Statistikat për punën e gjykatave dhe gjyqtarëve mbahen për nevojat e tyre nga institucione dhe organe të ndryshme të pavarura nga njëri-tjetri, përkatësisht: Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Lartë dhe Byroja Shtetërore e Statistikave. Mungesa e një metodologjie të unifikuar për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave statistikore ka çuar në statistika të paqëndrueshme dhe të pakrahasueshme.

Raporti i qendrës AIRE dhe RAI-t “Mbi metodologjinë rajonale të monitorimit” ofron një përmbledhje të hollësishme të zhvillimeve të Maqedonisë së Veriut në këtë fushë, duke nënvizuar se Ministria e Drejtësisë e ka përcaktuar miratimin e Metodologjisë për Statistikat e Gjykatës si përparësi kryesore në Programin Kombëtar për Miratimin e Legjislacionit të Bashkimit Evropian. Brenda komponentit 4 të projektit të binjakëzimit IPA 2010 “Mbështetje për parandalimin efektiv dhe luftën kundër korrupsionit”, u hartua një specifikim teknik dhe u zhvillua një softuer për uebin “Sistemi për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit” (‘Akstats’). Nga data 1 prill 2019, 49 institucione kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi që i lejon ata të hyjnë në sistemin Akstats si institucione përfituese, përfshirë Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara. Megjithatë, nuk është e qartë nëse ky sistem do të ofrojë mjaftueshëm statistika gjithëpërfshirëse të kthimit të pasurive kombëtare të nevojshme për të qenë në përputhje me standardet e BE-së dhe nivelin bazë të zhvilluar në raportin e *Metodologjisë së Monitorimit Rajonal* të qendrës AIRE dhe RAI, e cili përfshin numrin dhe vlerën e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, numrin e rasteve në të cilat janë konfiskuar pasuri dhe numrin e kërkesave ndërkombëtare për kthimin e pasurive.

5.6 Serbia

Kthimi i pasurive si objekt politikash

Megjithëse nuk ka një strategji të veçantë për kthimin e pasurive në nivelin kombëtar, ‘agjenda’ e rigjenerimit të pasurive serbe përshkon një numër strategjish kombëtare, përfshirë Strategjinë Kombëtare Antikorrupsion dhe Strategjinë Kombëtare të Krimit të Organizuar. Riparimi i pasurive është përgjegjësi e organeve të ndryshme

qeveritare, të ngarkuara me luftën kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit. Këto organe ndërsektoriale përbëhen nga përfaqësues të ministrive të ndryshme, organizatave shtetërore dhe shërbimeve. Riparimi i pasurive ka qenë një objektiv politik në Serbi që nga viti 2002, kur u ngrit për herë të parë në Strategjinë e Krimit të Organizuar. Miratimi i një ligji të veçantë për kthimin e pasurive u vendos si një synim në atë kohë dhe miratimi i tij u parapri nga ndryshimet në Kodin Penal. Një 'grup pune' i ngarkuar me hartimin e Ligjit për Konfiskimin e të Ardhurave të Krimit (LPKK) filloi punën në 2005 dhe LPKP-ja u miratua më 23 tetor 2008, duke hyrë në fuqi më 1 mars 2009. Ky ligj u pa si revolucionar për kohën.

Dispozitat ligjore për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive

Një analizë e hollësishme e dispozitave ligjore të kthimit të pasurive për Shqipërinë përfshihet në botimet e qendrës AIRE dhe RAI-t "*Kthimi i pasurive në Ballkanin Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës (2018)*", në faqen 66-69 dhe në "*Doracakun mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)*" në faqet 115-127. Kjo pjesë përmban një përmbledhje të kësaj analize, si edhe zhvillimet e reja që prej botimeve të qendrës AIRE dhe RAI-t.

Kuadri ligjor që rregullon konfiskimin e produkteve të krimit në mungesë të një vendimi dënimi në Serbi përbëhet nga Kodi Penal (KP, 2016) dhe Kodi i Procedurës Penale (KPP, 2014). Përveç kësaj, siç është përmendur më sipër, Serbia ka marrë vendimin pozitiv për të krijuar një ligj të veçantë për kthimin e pasurisë në formën e ligjit "Për konfiskimin e të ardhurave nga krimit" (LPKP, 2016), i cili parashikon, përveç dispozitave në KP dhe KPK, përkufizime të qarta të mjeteve, pasurisë dhe të ardhurave, dispozitat për konfiskimin e zgjeruar, konfiskimin e bazuar në vlerë, konfiskimin e palës së tretë dhe mbrojtjen e palëve të treta me mirëbesim. Ndryshimi i vetëm i fundit në legjislacion ka qenë një ndryshim i LKPK-së, neni 2, në maj të vitit 2019, në lidhje me veprat penale për të cilat zbatohet ligji, në përgjigje të ndryshimeve në dispozitat e KP-së mbi krimet për abuzim detyre. Përveç kësaj, kuadri legjislativ mbetet i njëjtë.

Konfiskimi i bazuar në mosdënim

Dispozitat ligjore të Serbisë parashikojnë konfiskimin e bazuar në mosdënim vetëm në proceset penale. Përveç dispozitave të konfiskimit të zgjeruar të parashikuara në LKPK (shih seksionin për konfiskimin e zgjeruar më poshtë), pasuritë mund të konfiskohen në rastin kur autori vdes, kur ai arratiset ose është i paaftë mendërisht për t'u gjykuar. Neni 3 (4) i LKPK-së përshkruan të gjithë personat që konsiderohen pronarë të pasurive, përveç të pandehurve. Ato përfshijnë të pandehur bashkëpunëtorë, trashëgimlënës, trashëgimtarë ligjorë dhe palë të treta.

Termi "trashëgimtar" përdoret për një person kundër të cilit nuk është filluar procedim penal, ose kur procedimi është ndërprerë për shkak të vdekjes së tij/saj dhe kur është konstatuar, gjatë proceseve penale kundër personave të tjerë, se ata kishin kryer një vepër penale sipas nenit 2 të LKPK-së në bashkëpunim me personat e gjykuar. Në praktikë, kjo do të thotë që pasuria mund të konfiskohet nga

trashëgimtarët e trashëgimlënësve, pra të pandehurve kundër të cilëve proceset penale janë ndërprerë për shkak të vdekjes, ose të cilët nuk janë gjykuar. Kjo ka ndodhur vetëm një herë në Serbi, kur janë gjykuar anëtarët e të ashtuquajturit *Klani Zemun*. Fajësia e dy organizatorëve kryesorë të klanit, të cilët u qëlluan për vdekje nga policia, u vërtetua gjatë gjyqimit. Gjykata vendosi në vendimin e saj për konfiskimin e pasurive me vlerë të konsiderueshme, përfshirë një shtëpi, nga të vejat e tyre. Për më tepër, të pandehurit në përgjithësi mund të gjykohen në mungesë në kushte specifike dhe pasuria e tyre mund të konfiskohet. Sipas KPP-së, megjithatë, në rast se arrestohen, të ndaluarit mund të kërkojnë një rigjykim, për të cilin duhet të merret vendim. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik i të pandehurve të sëmurë mendorë mund të urdhërohet në kushte specifike të parashikuara nga ligji dhe në këtë rast, pasuria e tyre, gjithashtu, mund të konfiskohet.

Konfiskimi i zgjeruar

Ligji “Për konfiskimin e të ardhurave të krimit” (LPAK, 2016) është i vetmi ligj që lejon konfiskimin e zgjeruar të të gjithë pasurisë që supozohet se rrjedh nga aktiviteti kriminal në Serbi. Pas dënimit penal, bëhet përcaktimi i lidhjes shpërpjestimore midis të ardhurave ligjore të të pandehurit dhe pasurive në pronësi dhe kur prokuroria provon se bëhet fjalë për një shpërpjesëtim të dukshëm, gjykata mund të urdhërojë konfiskimin bazuar në “dyshimin e arsyeshëm” që pasuria që rrjedh nga veprimtari kriminale. Për vepra të caktuara, vlera e të ardhurave nga krimi duhet të kalojë shumë prej 1.5 milion RSD (afërsisht 12,750 EUR). Barra e provës i takon fillimisht prokurorisë për të treguar pasurinë joproporcionale dhe më pas kalon tek i pandehuri ose pronari i palës së tretë, të cilët kanë mundësinë e shpjegimit të ligjshmërisë së pasurisë para gjykatës.

Ka ende vështirësi me dispozitat e konfiskimit të zgjeruar si për prokurorët për të provuar që pasuritë janë produkte të veprave penale, ashtu edhe për gjyqtarët të pranojnë prova në lidhje me pronësinë e paligjshme të pasurive. Kjo vlen si në fazën e përkohshme të ngrirjes dhe konfiskimit, ashtu edhe në fazën e sekustrimit. Gjyqtarët dëgjojnë prova nga prokurori për pabarazinë ose “shpërpjesëtimin e dukshëm” midis të ardhurave ligjore dhe pasurive në pronësi. Megjithatë, kur i pandehuri ose një pronar i pretenduar kanë mundësinë të japin shpjegime në lidhje me pasurinë e ligjshme (zhvendosja e barrës së provës), gjyqtarët kanë vështirësi për pranimin e të gjitha provave të parashikuara në “mocionin” e prokurorit, përfshirë edhe provat rrethore dhe, për këtë arsye, kanë vështirësi në rrëzimin e shpjegimeve nga “pronarët” e pasurisë. Pasuritë shpesh kthehen. KPP-ja rregullon vetëm konfiskimin e instrumenteve dhe të përfitimeve nga vepra penale që i nënshtrohet akuzës. Të gjitha çështjet në lidhje me konfiskimin e zgjeruar parashikohen në LKAP. Çdo udhëzim për gjyqtarët i lihet jurisprudencës dhe harmonizimit të praktikës gjyqësore. Prokurorët dhe gjykatësit ende nuk i kanë përqaftuar plotësisht mundësitë e konfiskimit të zgjeruar dhe, për këtë arsye, dispozita ligjore nuk përdoret aq gjerësisht sa ligji i jep mundësi të përdoret.

Konfiskimi civil ose administrativ i bazuar në mosdënim

Serbia vazhdon t'i zgjerojë mundësitë legjislative në fushën e kthimit të pasurive dhe aktualisht është duke hartuar një ligj “Për përcaktimin e origjinës së pronës

dhe për një tatim të veçantë”, i cili parashikon përcaktimin e pasurive të rritura përkundrejt të ardhurave të mundshme të ligjshme. Çdo pasuri e pashpjegueshme do t’i nënshtrohet tatimit. Kjo masë administrative, megjithëse një dispozitë tatimore që bie nën juridiksionin e Gjykatës Administrative, do t’i shtohet legjisllacionit ekzistues serb për shënjestrimin e pasurive të pashpjegueshme. Parashikohet që ky ligj të hyjë në fuqi në vitin 2021.

Dispozitat e kthimit të pasurisë ligjore në Serbi janë në përputhje me standardet e nevojshme rajonale dhe ndërkombëtare, por lejojnë vetëm konfiskimin si pjesë e proceseve penale. Eksplorimi i mjeteve juridike civile dhe/ose administrative për konfiskim të bazuar në mosdënim do të lejonte një qasje më të shënjestruar për konfiskimin e pasurive të vëna në mënyrë kriminale, pa shqyrtimet e veçanta dhe shpesh të vështira të përfshira në procesin penal që varen nga ekzistenca e një dënimi penal. Për shembull, gjatë proceseve penale dhe të konfiskimit të zgjeruar, palët e treta, në përputhje me standardet evropiane^[24], mund të tregojnë me të drejtë se kanë fituar pronë në mënyrë të ligjshme. Ata kanë të drejtë të apelojnë vendimet e gjykatës dhe, në fund, ata mund të padisin shtetin në çështje civile kompensimi dhe të provojnë se ata e kanë fituar në mënyrë të ligjshme pronën e tyre. Gjykata e Lartë e Serbisë shqyrtoi çështjen e së drejtës së një pale të tretë për të kërkuar rigjykim pas një vendimi përfundimtar konfiskimi të dhënë në procedurë penale, një mjet juridik i rezervuar vetëm për të pandehurin. Duke qenë se pronarët e pasurive janë palë në proceset e konfiskimit të zgjeruar dhe ato mund të përfshijnë jo vetëm të pandehurit, por edhe palë të treta, Gjykata e Lartë vendosi që palët e treta kishin të drejtë të kërkonin rigjykim penal të çështjes sipas KPP-së. Më tej, Gjykata gjithashtu vendosi që vetëm pasuria e të pandehurit mund të konfiskohej nën një marrëveshje të pranimit të fajësisë, ndërsa konfiskimi i pasurisë së palëve të treta kërkonte zhvillimin e procedimeve të veçanta akuzatore. Megjithëse pikëpamjet dhe mendimet e Gjykatës së Lartë nuk janë detyruese, ato janë të rëndësishme për praktikën gjyqësore.

Në mënyrë që të kapërcehen këto kufizime, Serbia mund të shqyrtojë mundësinë e dispozitave ligjore për konfiskimin e pasurive në mënyrë të pavarur nga proceset penale, ku do të mjaftonte vetëm të provohej, me një standard civil të provës, jo me standard penal, se ekziston një lidhje midis pasurive në fjalë dhe sjelljes së përgjithshme kriminale. Nëse miratohet dhe zbatohet me sukses, ligji i ri “tatimor” administrativ mund të mbushë ndërkohë deri në një farë mase këtë hendek.

Hetimi financiar

Dispozitat ligjore në Serbi përmbajnë dispozita adekuate për qasje në informacionin financiar dhe bazat e të dhënave si nga zbatuesit e ligjit, dhe nga prokurorët. Këto dispozita jepen në LKAP dhe KPK dhe ofrojnë një gamë të gjerë mekanizmesh për profilizimin financiar të të dyshuarve dhe pasurive të tyre. Legjisllacioni përshkruan autoritetet që kanë qasje në informacionin financiar, llojet e informacionit, kushtet dhe kufizimet. Ai gjithashtu parashikon një sërë teknikash bashkëkohore të veçanta hetimore financiare. Qasja te të dhënat bankare është e mundur me urdhër të prokurorit publik, me Bankën Qendrore të Serbisë që cakton një nëpunës të ngarkuar

[24] Direktiva 42/2014 e BE-së, neni 6 (2)

për të vepruar si ndërlidhës i organeve të zbatimit të ligjit. Për më tepër, Njësia e Hetimit Financiar, e cila funksionin si ZRP kombëtare, ka qasje të drejtpërdrejtë në shumë baza të dhënash, përfshirë llogaritë bankare të personave juridikë dhe fizikë. Bashkëpunimi i shpejtë ndërinstucional midis agjencive që mbajnë dhe kërkojnë të dhëna financiare është po aq i rëndësishëm sa edhe mundësia ligjore e qasjes të dhënash. NjHF-ja ka një listë kontakti të stafit të bankave të ngarkuar për të bashkëpunuar me të drejtpërdrejt. Hetuesit financiarë të dedikuar vetëm për gjurmimin dhe identifikimin e pasurive dhe profilizimin financiar punojnë në Njësinë e Hetimeve Financiare.

Raportet e mëparshme të qendrës AIRE dhe RAI-t kanë arritur në përfundimin se aftësitë për të kryer hetime financiare si nga organet e zbatimit të ligjit, ashtu edhe nga prokurorët janë të ulëta. Që nga botimi i këtyre raporteve, numri i stafit në Njësinë e Hetimit Financiar është rritur, megjithëse akoma jo mjaftueshëm. Numri i prokurorëve është rritur gjithashtu. Ekzistenca e ekspertëve financiarë në departamentet e Zyrës së Prokurorisë është gjithashtu një faktor pozitiv. Përkundër kësaj, është i nevojshëm forcimi i mëtejshëm i Zyrës së Prokurorit, veçanërisht përsa i përket hetimit financiar dhe prezantimit të provave financiare në gjykatë.

Gjatë periudhës së zbatimit të projektit janë organizuar trajnime të shumta për hetuesit e policisë, prokurorët dhe gjyqtarët nga Akademia Gjqësore. Në vitin 2018 u organizuan disa tryeza të rrumbullakëta, veçanërisht domethënëse në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve për të kryer kthimin efektiv të pasurive, përfshirë hetimin financiar. Në periudhën shtator 2019 - mars 2020 u organizuan dymbëdhjetë trajnime për luftën kundër pastrimit të parave dhe krimit të organizuar. Ato përfshinë leksione mbi hetimet financiare proaktive të personave fizikë dhe juridikë. Në nëntor të vitit 2019 u organizua një aktivitet dyditor në kuadrin e projektit rajonal AIRE-RAI, i cili iu kushtua ekskluzivisht kthimit të pasurive. Për më tepër, Njësia e Hetimit Financiar ka marrë pjesë në disa tryeza të rrumbullakëta, duke diskutuar bashkëpunimin efektiv me organet e tjera, raportet e përfshira në këtë bashkëpunim dhe cilësinë e tyre, dhe aftësinë e tyre për të shërbyer prova në proceset penale. Trajnimet përfshinë elemente të hetimeve financiare si ndaj personave fizikë, ashtu edhe ndaj personave juridikë.

Dy manualët e përgatitura në kuadër të projektit rajonal AIRE-RAI janë promovuar në mënyrë aktive dhe janë mbajtur ligjërata të shkurtra në konsultimin vjetor të organizuar nga Gjykata e Lartë në Vrnjačka Banja në tetor të vitit 2019. Aktivitetet dhe studimet e ndërmarra nga projekti Rajonal AIRE-RAI kanë rritur ndërgjegjësimin midis prokurorëve dhe policisë për rëndësinë e hetimeve financiare dhe kthimin e pasurive. Ndikimi i kësaj pune mund të reflektohet vetëm përmes rritjes së statistikave gjatë viteve të ardhshme, pasi proceset gjyqësore të krimit të organizuar marrin shumë kohë për të arritur në një përfundim.

Zyra për Kthimin e Pasurive (ZRP)

Njësia e Hetimit Financiar, e themeluar brenda kornizës së LKAP-së, aktualisht funksionon si ZRP-ja kombëtare. Kjo njësi operon nën Ministrinë e Punëve të Brendshme, domethënë nën policinë, si një njësi e veçantë organizative. Në shumicën e rasteve

dhe me urdhër të prokurorit publik përkatës, njësia kryen hetime financiare për të gjetur dhe identifikuar pasuritë dhe për të mbledhur prova mbi të ardhurat e ligjshme, mënyrën e jetesës dhe shpenzimet e jetesës së të pandehurve, të bashkëpandehurve ose trashëgimlënësve. Njësia gjithashtu mbledh prova të pasurive të trashëguara nga pasardhësit e ligjshëm, domethënë prova të pasurive dhe kompensimit të transferuara te palët e treta. Veprimet individuale hetimore kryhen *ex officio* dhe me urdhër të prokurorit publik. Autoritetet, organizatat dhe shërbimet publike shtetërore, dhe të tjera duhet t'u përcjellin njësive pa vonesë të dhënat e kërkuara. Prokurorët publikë mund të urdhërojnë bankat dhe organizatat e tjera financiare të përcjellin të dhënat mbi statusin e biznesit të pronarëve, llogaritë private dhe kutitë e depozitave të sigurisë të Njësia e Hetimit Financiar dhe të udhëzojnë njësinë të bëjë përpunimin automatik të këtyre të dhënave. Banka Kombëtare e Serbisë ka caktuar një oficer për ndërlidhjen me njësinë. Njësia, gjithashtu, kryen kërkime në shtëpi dhe kërkime në ambiente të tjera të pronarëve ose personave të tjerë, me urdhër të gjykatës përkatëse, dhe të pronarëve ose personave të tjerë nëse ka të ngjatë që në to të gjenden prova. Njësia është e autorizuar të sekuestrojë objekte, regjistra, dokumente dhe të dhëna që mund të shërbejnë si prova. Autoritetet, organizatat dhe shërbimet publike shtetërore dhe të tjera duhet t'i sigurojnë njësisë qasje në të dhëna, regjistra, dokumente dhe sende të tjera; ato mund të mos kërkojnë përmbushjen e parimit të konfidencialitetit. Personat fizikë dhe juridikë që posedojnë dokumente në lidhje me burimin e të ardhurave dhe pasurive, për çfarëdo lloj arsyeje, duhet t'i dorëzojnë ato pa vonesë në njësi, me kërkesën e saj, nëse ka të ngjarë që ato të mundësojnë lehtësimin e identifikimit të produkteve të veprës penale. Njësia përgatit profilet e pronarëve të pasurive nën hetim me kërkesë të prokurorit përgjegjës. Raportet e tilla përfshijnë të dhëna për aktivitetet kriminale të individëve dhe të dhënat e tyre penale, nëse ka, një analizë të pasurive dhe të ardhurave të tyre të ligjshme, së bashku me një analizë të "shpërpjesëtimit të dukshëm" midis të ardhurave të tyre të ligjshme dhe të ardhurave aktuale, duke provuar mënyrën e shtrenjtë të jetesës, e cila është në shpërpjesëtim me të ardhurat e ligjshme. Gjatë vitit të kaluar, njësia kreu disa analiza të tilla me kërkesë të Prokurorit të Krimin të Organizuar.

Që nga viti 2016, Njësia e Hetimit Financiar ka ligjërisht të drejtë të angazhojë profesionistë që punojnë në autoritete ose institucione të tjera shtetërore në mënyrë që të marrë ndihmë të specializuar ekspertit. Për shembull, vitin e kaluar, ajo ka angazhuar në disa raste ekspertë që punojnë brenda Administratës Tatimore. Duke vepruar si ZAP-ja e Serbisë, njësia gjithashtu përpunon kërkesat hyrëse dhe dalëse para NNJ-së për bashkëpunim ndërkombëtar për zbulimin dhe identifikimin e produkteve të krimit me qëllim sekuestrimit ose konfiskimit të tyre. Njësia ka një kanal të sigurt konfidencial për shkëmbimin e informacionit me ZAP-të e tjera përmes Europolit dhe platformës së saj të shkëmbimit të informacionit në rrjetin SIENA. Zyra ka shkëmbyer informacion duke përdorur këtë metodë në dhjetë raste gjatë vitit të kaluar.

Megjithëse e themeluar brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme, njësia gëzon reputacion të mirë për bashkëpunim me Zyrën e Prokurorisë së Krimin të Organizuar dhe Prokurorinë Speciale kundër Korrupsionit. Numri i stafit u rrit gjatë vitit të kaluar ndërkohë që trajnimit i kushtohet një vëmendje e madhe. Megjithatë Zyra ka qenë me staf të paplotësuar që kur është krijuar dhe ende ka mungesë ekspertësh në ekspertizën financiare.

Zyra e Administrimit të Pasurive (ZAP)

Drejtoria e Administrimit të Pasurive e Serbisë u krijua në vitin 2008 brenda Ministrisë së Drejtësisë. Ajo ekziston si një ent juridik autonom, me seli në Beograd, dhe mund të krijojë njësi organizative në qytete të tjera të vendit. Roli dhe funksionet e saj parashikohen në nenin 9 të LKAP-së. Pasuritë që përfshihen në fushën e veprimit të Drejtorisë së Administrimit të Pasurive përfshijnë të ardhurat e sekuestruara/konfiskuara të krimit, pasuritë e sekuestruara me urdhër të prokurorit publik (LKPK neni 24), instrumentet e krimit (KP neni 87), përfitimet materiale të nxjerra nga vepra penale (nenet e KP 91 dhe 92), pasuritë e lëna peng si sigurim padie në proceset penale, sendet e sekuestruara në proceset penale dhe pasuritë, disponimi i të cilave është i kufizuar nga vendimet e Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare ku Republika e Serbisë është anëtare. Në lidhje me këto pasuri, Drejtoria ka përgjegjësinë për vlerësimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shitjen e tyre. Ajo administron gjithashtu fondet e nevojshme për të administruar pasuritë.

Ripërdorimi i pasurive të konfiskuara

Para vitit 2016, paratë e grumbulluara nga pasuritë e konfiskuara shkonin në buxhetin e shtetit. Ndryshimet në LKPK në vitin 2016 parashikojnë që paratë nga pasuritë e konfiskuara shkojnë në buxhetin e shtetit, por specifikojnë se 30% e tyre do të përdoren për të financuar nevojat sociale dhe shëndetësore në përputhje me vendimet e Qeverisë. Paratë zakonisht jepen për projekte sociale që lidhen me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, strehëzat dhe qendrat e punës sociale. Ka po ashtu shembuj kur qeveria vendos që pasuritë të shkojnë për “përdorim” të drejtpërdrejtë, për shembull shtëpi dhe automjete për qendrat e komunitetit, strehëzat, qendra për luftën kundër dhunës në familje dhe disa automjete për departamentet e policisë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Legjislacioni që i lejon autoritetet të kërkojnë dhe t’u përgjigjen kërkesave të juridiksioneve të tjera, për të gjurmuar, ngrirë, sekuestruar dhe konfiskuar pasuri është i përshtatshëm dhe përfshin instrumente, të ardhura që rrjedhin nga aktiviteti kriminal dhe pronë me vlerë ekuivalente me produktet e krimit. Legjislacioni që përmban dispozitat e bashkëpunimit ndërkombëtar përfshin LKPK-në (neni 64 deri 78), ligjin “Për ndihmën ndërkombëtare në çështjet penale” dhe konventat e ratifikuara, veçanërisht Konventën e OKB-së kundër krimit të organizuar, Konventën për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe Konventën e Varshavës të KiE-s. Ai nuk përfshin legjislacion që mundëson ekzekutimin e kërkesave ndërkombëtare në bazë të procedurës së konfiskimit civil ose administrativ pa vendim dënimi. Pavarësisht legjislacionit efektiv, në praktikë, procesi i marrjes së informacionit nga juridiksionet e huaja është jashtëzakonisht sfidues dhe kërkon që si prokurorët, ashtu edhe autoritetet e zbatimit të ligjit të përdorin mekanizmat e disponueshëm rajonalë dhe ndërkombëtarë, të tillë si rrjeti CARIN, StAR dhe BAMIN.

Për sa i përket bashkëpunimit të organeve të zbatimit të ligjit për hetimet paraprake për të gjurmuar pasuritë, Serbia ka marrëveshje operacionale për të shkëmbyer të

dhëna me EUROPOL-in që nga viti 2014, me një oficer të përhershëm ndërlidhës të vendosur në selinë e EUROPOL-it. Serbia është anëtare e rrjetit CARIN që nga viti 2009. Personi i kontaktit në rrjetin CARIN për zbatimin e ligjit ndodhet brenda Njësisë së Hetimit Financiar. Si porta e vetme drejt Rrjetit Global të Kthimit të Pasurive (rrjetet ndërinstitucionale të kthimit të pasurive), si kontaktet e organeve të zbatimi i ligjit, ashtu edhe ato të prokurorisë në rrjetin CARIN duhet të njihen mirë dhe të jenë të lidhura mirë brenda vendit si për hetimet operacionale, ashtu edhe për ato strategjike. Serbia do të përfitonte nga emërimi i një prokurori të dedikuar për t'u marrë me kthimin e pasurive kombëtare dhe ndërkombëtare si kontakt i saj në rrjetin CARIN.

Serbia ka ndarë pasuri në nivel dypalësh me juridiksione të tjera dhe aktualisht është e përfshirë në hartimin e një marrëveshjeje për ndarjen e pasurive rajonale dhe shumëpalëshe që përfshin FBIH-në, Republika Srpska-n dhe Mali i Zi, me mbështetjen e projektit rajonal AIRE-RAI.

Matja e efektivitetit

Lloje të ndryshme statistikash për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin, dhe vlerat e tyre mblidhen nga disa agjenci dhe autoritete dhe analizohen nga të tjera institucione duke përfshirë gjykatat, prokurorët, policinë dhe Drejtorinë e Administrimit të Pasurive. Më tej, për periudhën e projektit AIRE-RAI janë vënë në dispozicion statistika, të cilat janë regjistruar në mënyrë të dobishme në botimin e projektit AIRE-RAI “studimi rajonal i metodologjisë së monitorimit” (2019). Serbia përshkruhet brenda studimit si një vend me një sistem të mirë të mbledhjes së të dhënave që mundëson kryerjen e një analize të shkëlqyeshme të të dhënave për kthimin e pasurive.

Matja e efektivitetit të çdo sistemi të kthimit të pasurive mbështetet jo vetëm te statistikave të kthimit të pasurive, por edhe te faktorë të tjerë, përfshirë nivelin dhe llojin e kriminalitetit në juridiksionet përkatëse dhe kërcënimet e sjella prej tyre. Megjithatë, qasja në statistikave gjithëpërfshirëse të mbledhura në një instancë qendrore është thelbësore për procesin. Masa e Serbisë për ta arritur këtë, duke mbledhur të gjitha të dhënat e nevojshme brenda Drejtorisë së Administrimit të Pasurive, është një zhvillim pozitiv.

Drejtoria e Administrimit të Pasurive kryen grumbullimin qendror kombëtar të statistikave për pasuritë e ngrira, të sekuestruara dhe të konfiskuara, përfshirë vlerën e tyre të parashikuar, dhe i hedh ato në “Regjistrin Qendror”. Softueri i bazës së të dhënave u përditësua në vitin 2019 dhe ky Regjistër Qendror ka aktualisht një rëndësi të madhe për përpilimin e statistikave kombëtare. Ai është i aksesueshëm drejtpërdrejt nga policia, prokurorët, gjykatat dhe institucionet e tjera përgjegjëse.

Standardet e BE-së (Direktiva 2014/42 e BE-së dhe Rregullorja 2018/1805 e BE-së) gjithashtu kërkojnë mbledhjen e statistikave në lidhje me kërkesat hyrëse dhe dalëse për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive. Aktualisht, gjykatat po regjistrojnë lëshimin e urdhrave nga kërkesat ndërkombëtare hyrëse dhe dalëse për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive manualisht në një format standard. Të dhënat mund të mblidhen, megjithëse manualisht. Prandaj, statistikave janë të

disponueshme, nëse kërkohen për monitorim dhe raportim të brendshëm, ose me kërkesë të BE-së dhe për vlerësime të jashtme. Parashikohet që këto funksione të jenë të mundshme përmes një metode elektronike në të ardhmen.

6. Ndikimi i pandemisë COVID-19 mbi kthimin e pasurive në Ballkanin Perëndimor

Pa diskutim, kriza shëndetësore e pandemisë COVID-19 dhe kriza ekonomike pasuese, ka pasur efekt negativ mbi sistemin e drejtësisë penale në nivelin global. Kohë të paprecedenta kanë kërkuar masa të domosdoshme dhe të pashembullta. Megjithatë, kjo situatë ka hapur mundësi të padëshiruar për mashtrim, korrupsion dhe rritje të kostos së mallrave të paligjshme, të tilla si droga, duke ndikuar potencialisht edhe në nivelet e kriminalitetit. Përveç kësaj, disa juridiksione në rajon i janë nënshtruar zgjedhjeve në vitin 2020 duke çuar në aktivitet më të ngadalësuar se zakonisht të qeverisë dhe mungesë të vazhdimësisë dhe vendimmarrjes së unifikuar. Kjo paqëndrueshmëri politike ngre shqetësime shtesë gjatë krizës.

Në përgjigje të ndryshimit të klimës kriminale pas krizës globale shëndetësore, komuniteti ndërkombëtar është ngritur në nivelin e sfidës së të qenit i informuar për situatën, duke botuar përditësime të rregullta mbi ndikimin në krime të veçanta, të tilla si droga dhe veprat seksuale dhe kërcënimi i ardhshëm kriminal^[25], në lidhje, për shembull, me shpërndarjen e vaksinave^[26].

Implikimet mbi proceset gjyqësore në Ballkanin Perëndimor

Në periudhën raportuese midis marsit deri në maj të vitit 2020, të gjitha shtetet treguan se hetimet dhe ndjekjet penale dhe niveli i pasurive të sekuestruara dhe të ngrira mbetën në nivele të ngjashme me ato para shpërthimit të pandemisë. Kjo pavarësisht se burimet kishin qasje të kufizuar në mjediset e tyre normale të zyrës. Agjencitë e policisë dhe të prokurorisë ndryshuan numrin e personelit të pranishëm fizikisht në zyrë, duke i lënë të tjerët të vazhdonin të punonin nga shtëpia. Megjithatë, faktorët të cilët kanë kufizuar praktikën normale të punës gjatë një periudhe të gjatë përgjatë gjithë verës dhe “valës së dytë”, kanë ushtruar padyshim ndikim mbi përparimin e rasteve. Si pasojë, nivelet e të ardhurave kriminale të identifikuara, të sekuestruara dhe të konfiskuara pritet të bien. Juridiksionet në Ballkanin Perëndimor kanë raportuar faktorët e mëposhtëm si faktorë që ndikojnë në atë që do të ishte praktikë normale e punës:

- » Burimet e stafit janë zvogëluar, pasi stafi ose është prekur nga virusi, ose është detyruan të qëndrojë në shtëpi në karantinë pasi ka qenë në kontakt me një individ të infektuar;

[25] Botim i Europolit *How COVID 19 Related Crime Infected Europe During 2020*, 11 nëntor 2020, <https://www.europol.europa.eu/activities-services/staying-safe-during-covid-19-what-you-need-to-know>

[26] Interpoli paralajmëron për kërcënimet e krimit të organizuar ndaj vaksinave të COVID-19-ës <https://www.interpol.int/en/News-and-Events/News/2020/INTERPOL-warns-of-organized-crime-threat-to-COVID-19-vaccines>

- » Personeli të cilit i është kërkuar të punojë nga shtëpia, ka pasur qasje të kufizuar te pajisjet teknike të nevojshme për të kryer kërkime në lidhje me kthimin e pasurive, për shembull te posta elektronike në intranet, te softueri i analizës financiare, qasje në bazat e të dhënave për gjurmimin e pasurive, qasje në platformat e sigurta të shkëmbimit të informacionit ndërinstucional dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për gjurmimin e pasurive;
- » Akses i kufizuar në gjykata për të aplikuar për masa shtrënguese për hetime financiare;
- » Akses i kufizuar te dëshmitarët për të marrë deklaratat për qëllime provuese, për shembull nga bankat dhe institucionet financiare;
- » Personel i kufizuar (policia, përmbaruesit) për të zbatuar në mënyrë aktive urdhrat e ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit;
- » Më pak çështje të ndjekura penalisht në gjykata, do të sjellin më pak sekuestrime dhe konfiskime të pasurive. Për shembull, në njërin prej juridiksioneve, rekomandimi i Ministrisë së Drejtësisë për procese gjyqësore me videolidhje u kritikua nga avokatët dhe Shoqata e Gjyqtarëve, të cilët i cilësuan këto procese si të paligjshme dhe këmbëngulën që çështja të trajtohej në përputhje me ligjin dhe Kushtetutën. Profesionistët e së drejtës pretenduan se proceset gjyqësore me videolidhje nuk garantonin të drejtën për gjykim të drejtë pasi të pandehurit, për shkak se nuk ishin në sallën e gjyqit, nuk kishin mundësinë të kishin bisedime konfidenciale me avokatët e tyre mbrojtës. Në disa raste, avokati mbrojtës nuk pranonte të merrte pjesë në procese gjyqësore me videolidhje dhe seancat u ndërpreu;
- » Propozimet për ndryshime në legjislacionin për kthimin e pasurive, ose brenda Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, ligjeve për konfiskimin e produkteve të veprave penale ose ligjeve të administrimit të pasurive janë pezulluar. Në një rast, një ligj i ri thelbësor mbi konfiskimin civil u propozua në vitin 2019, por më pas u la mënjanë në pritje për shkak të krizës.

Rreziqet e identifikuara

1. U bënë ndryshime të jashtëzakonshme në buxhetet e institucioneve publike, për të reflektuar ndryshimin e përparësive kombëtare të shkaktuara nga pandemia. Këto ndryshime u bënë urgjente dhe për këtë arsye pa bashkëpunim ose mbikëqyrje të zakonshme dhe shpesh pa transparencë. Lëvizja urgjente dhe e pazakontë e fondeve shtetërore ofron rritjen e mundësisë për abuzim të pushtetit dhe keqpërdorim të fondeve publike brenda institucioneve shtetërore.
2. Barnat dhe pajisjet mbrojtëse mjekësore ishin të nevojshme menjëherë dhe për këtë arsye nuk u ndoqën procedurat e zakonshme të prokurimit. Disa juridiksione kanë raportuar që këto prokurime urgjente janë kryer përmes negociatave të drejtpërdrejta me kompani, pa botimin paraprak të një njoftimi publik dhe pa një mendim paraprak të zyrës së prokurimit publik. Shumë juridiksione të Ballkanit Perëndimor raportuan për pagesa të shumave jashtëzakonisht të rritura për medikamente dhe pajisje mbrojtëse (doreza, maska, kostume mbrojtëse, maska, etj.). Blerjet e organizuara në këtë mënyrë padyshim që paraqesin një rrezik në rritje të korrupsionit për shkak të mungesës së konkurrencës së ndershme në përzgjedhjen e kompanive, rritjes së kostos së blerjeve dhe siç raportohet, mungesës së transparencës së dukshme të procedurave.

3. Mbetet rrezik i vazhdueshëm keqpërdorimi i dhurimeve dhe ndihmave ndërkombëtare që u dhanë për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe për të mbështetur situatën ekonomike të secilit juridiksion.
4. Ka tregues se paratë e dhëna me fajde nxisin korrupsionit dhe investime të paligjshme të biznesit, për shembull në industrinë e ndërtimit, dhe rritet rreziku i ndikimit të paligjshëm ekonomik nga grupet kriminale.
5. Shtetet që mbështesin pjesën më të madhe të të ardhurave të tyre të turizmit mund të vuajnë nga rritja e përdorimit të paligjshëm të fondeve shtetërore, korrupsioni dhe rekrutimi i anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të rinj të krimit të organizuar për shkak të krizës ekonomike.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 mbi kthimin e pasurive

Pandemia COVID-19 ka ofruar mundësi për rritjen dhe diversitetin e kriminalitetit përfitues, në veçanti të mashtrimit dhe korrupsionit, por edhe të krimit kibernetik, vjedhjeve, fajdeve dhe falsifikimit, përfshirë edhe shitjen e pajisjeve mbrojtëse të falsifikuara, duke përfshirë këtu maska, xhel dezinfektues dhe barna, të cilat kanë shënjuar rritje të ndjeshme që nga shpërthimi i krizës. Kjo shoqërohet me rritjen e vlerës së mallrave të paligjshëm për shkak të kufizimeve të lëvizjeve ndërkombëtare dhe të brendshme, duke sjellë një rritje të aktivitetit të zakonshëm kriminal.

Paralelisht me këtë, gjatë pandemisë, shumë prej institucioneve, fokusi i të cilave zakonisht është lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, kanë punuar me një intensitet të reduktuar. Gjykatat, gjithashtu, kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë me një ritëm më të ngadaltë se zakonisht dhe nuk kanë qenë në gjendje të procedonin me çështje të caktuara penale. Ndërsa sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive në të gjitha juridiksionet e Ballkanit Perëndimor varet nga ekzistenca e një hetimi dhe ndjekjeje penale, niveli i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në vitin 2020 dhe 2021 (të paktën) padyshim që do të ulet. Të dhënat statistikore të regjistruara për numrin e ndjekjeve penale dhe konfiskimet e produkteve të veprës penale do të japin një panoramë më të qartë të situatës në juridiksionet që prodhojnë me sukses statistika.

Si zhvillim pozitiv vlen të theksohet se akademitë e trajnimit të policisë dhe gjyqësorit në përgjithësi kanë qenë në gjendje të vazhdojnë me aktivitetet e planifikuara të trajnimeve, duke kryer trajnime *online* për gjyqtarë, prokurorë dhe hetues.

Rekomandime të lidhura me pandeminë COVID-19

1. Qeveritë duhet të inkurajohen të botojnë rregullisht informacione mbi burimet e fondeve të marra për përballimin e krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19, si dhe mbi mënyrën e shpenzimit të tyre.
2. Qeveritë duhet të inkurajohen të botojnë informacione mbi kontratat e marra përmes mbështetjes financiare të BE-së dhe organizata të tjera ndërkombëtare dhe rajonale.
3. Qeveritë duhet të inkurajohen të botojnë rregullisht informacione se si shpenzohen fondet e marra nga të gjitha burimet për të trajtuar pandeminë.
4. Prokurimi publik për t'u marrë me pandeminë ose si rezultat i pandemisë duhet të kryhet me transparencë të plotë.

5. Shpenzimet institucionale shtetërore të fondeve të mbledhura në buxhet në lidhje me COVID-19-ën përmes dhurimeve nga persona fizikë, persona juridikë dhe organizata ndërkombëtare duhet të jenë transparente dhe të disponueshme për publikun.
6. Lista e donatorëve dhe informacioni se ku dhe si shpërndahen fondet e dhuruara duhet të mirëmbahen dhe të botohet rregullisht.
7. Mbikëqyrja dhe kontrolli i vazhdueshëm dhe i shtuar nga autoritetet shtetërore kompetente (Policia Financiare, Departamenti i të Ardhurave Publike, Zyra e Prokurorisë Publike) dhe sektori i shoqërisë civile është i domosdoshëm, të paktën përgjatë vitit 2021/2022.
8. Juridiksionet dhe asistenca e jashtme teknike duhet të përqendrohen te mbështetja e bashkëpunimit të ardhshëm ndërkombëtar në hetimet financiare dhe penale dhe konfiskimi i pasurive, duke përfshirë brenda projektit rajonal AIRE-RAI, pasi prokurimi i pajisjeve mjekësore dhe mbrojtëse është kryer qartë përmes juridiksioneve të ndryshme. Prokurimi ndërkombëtar ishte kompleks, pasi pajisjet ishin të pakta, dhe kushtet e prokurimit dhe pagesës përfshinin ndërmjetës të ndryshëm në kontrata jotransparente.
9. Ekziston nevoja për të analizuar më në detaje rreziqet e kaluara, aktuale dhe të ardhshme dhe ndikimin e pandemisë dhe për të përgatitur një plan të aktiviteteve për të përmirësuar efikasitetin e luftës kundër krimit, duke përfshirë konfiskimin e produkteve të krimit. Ofruesit e asistencës teknike duhet të rishikojnë mundësinë e angazhimit të një eksperti për të përgatitur një analizë të këtyre rreziqeve dhe ndikimit të tyre në klimën e pandemisë COVID-19.

7. Përfundime dhe rekomandime

Ky kre ofron përfundime përmbledhëse mbi kapacitetin aktual për kthimin e pasurive në rajonin e Ballkanit Perëndimor, së bashku me sugjerime dhe rekomandime për një sistem të përmirësuar dhe më efektiv të kthimit të pasurive. Këto rekomandime duhet të përfshihen në strategjitë e brendshme të kthimit të pasurive dhe planet e veprimit. Raporti mund të shërbejë gjithashtu si një dokument udhëzues për ndërtimin e kapaciteteve të rajonit në të ardhmen. Rekomandimet paraqiten me *shkrim të pjerrët* në fund të secilës pjesë.

Është raportuar se tre doracakët e përgatitur në kuadër të projektit rajonal AIRE-RAI janë promovuar në mënyrë aktive nga ekipi i menaxhimit të projektit, koordinatorët kombëtarë dhe trajnerët. Janë organizuar ligjërime brenda vendit, ashtu sikur edhe aktivitete në nivel kombëtar dhe rajonal. Aktivitetet dhe studimet e ndërmarra nga projekti rajonal AIRE-RAI kanë rritur ndërgjegjësimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe ekspertëve të drejtësisë penale për rëndësinë e kthimit të pasurive. Ndikimi i kësaj pune mund të reflektohet vetëm përmes rritjes së statistikave të konfiskimit gjatë viteve të ardhshme, pasi proceset gjyqësore të lidhura me krimin e organizuar kërkojnë shumë kohë për të arritur në një përfundim.

Projekti rajonal AIRE-RAI ka luajtur një rol unik për zhvillimin e kapacitetit lidhur me kthimin e pasurive në Rajonin e Ballkanit Perëndimor. Hartimi i katër botimeve specifike rajonale mbi kthimin e pasurive u ka siguruar juridiksioneve një kategorizim gjithëpërfshirës të ligjit dhe procedurave të brendshme të kthimit të pasurive, standardeve të zbatueshme të KEDNJ-së dhe GJEDNJ-së, metodologjisë për bashkëpunimin ndërkombëtar të kthimit të pasurive dhe qasjen që duhet zbatuar kur grumbullohen statistikat e kthimit të pasurive.

Rekomandohet fuqimisht që juridiksionet të përdorin përshkrimet e qarta të legjislativës, institucioneve dhe procedurave të përshkruara në botimet AIRE-RAI para miratimit të dispozitave të reja të kthimit të pasurive dhe strukturave institucionale dhe për të ndihmuar për hartimin e tyre.

Kthimi i pasurive si objekt politikash

Sipas standardeve ndërkombëtare^[27], në mënyrë që juridiksionet të shënjojnë dhe zvogëlojnë në mënyrë efektive aktivitetin kriminal përmes përdorimit të kthimit të pasurive, kthimi i pasurive duhet të jetë fokusin specifik të ministrave, politikëbërësve, ligjvënësve dhe profesionistëve të të gjitha agjencive. Kjo mund të realizohet plotësisht nëse kthimi i pasurive shihet si *objektiv politikash*. Sigurimi i kthimit të pasurive është në vetvete një *objektiv politikash* i cili gjithashtu kërkon vullnet të fortë politik. Për atë arsye, ky raport fillimisht vlerësoi politikën e kthimit të pasurive të juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor.

[27] Rekomandimi 2 i FATF-së, Politikat dhe Koordinimi i LPP/LFT-së - Vendet duhet të kenë politika kombëtare LPP/LFT, të informuara nga rreziqet e identifikuara, të cilat duhet të rishikohen rregullisht, si edhe duhet të caktojnë një autoritet ose të kenë një koordinim ose mekanizëm tjetër që është përgjegjës për këto politika.

Një çështje thelbësore që duhet të merret parasysh për të përcaktuar nëse juridiksionet në Ballkanin Perëndimor kanë arritur standardet e FATF-së - Rezultati i menjëhershëm (8) është:

“8.1. Deri në çfarë mase ndiqet si objektiv politikash konfiskimi i të ardhurave kriminale, mjeteve dhe pasurisë me vlerë ekuivalente?”

Brenda juridiksioneve në rajon, ekzistojnë disa strategji dhe plane veprimi që përfshijnë kthimin e pasurive (si, për shembull, Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe Strategjia Ndërsektoriale kundër Krimit të Organizuar e Shqipërisë, Plani Strategjik 2018 - 2020 dhe Plani i ndërlidhur i Veprimit i Agjencisë Kombëtare të Administrimit të Pasurive të Maqedonisë së Veriut, Strategjia Kombëtare e Antikorrupsionit dhe Strategjia Kombëtare e Krimit të Organizuar e Serbisë). Megjithatë, nuk ka komitete specifike funksionale për kthimin e pasurive në asnjë nga gjashtë shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Kthimi i pasurive është pjesë integrale e drejtësisë penale dhe është e nevojshme të ndryshohen proceset e përditshme të agjencive për të realizuar kthimin e pasurive. Kjo përfshin ndryshime të prekshme që mund të zbatohen vetëm nga profesionistët. Ekzistenca e një plani veprimi pa një komitet zbatues është një dobësi themelore për zbatimin e kthimit efektiv të pasurive. Për më tepër, strategjitë ekzistuese kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe antikorrupsionit nuk janë specifike për kthimin e pasurive dhe përmbajnë vetëm një numër të vogël objektivash për të konfiskuar produktet nga verat penale.

Strategjitë dhe planet e veprimit ecin përpara vetëm kur dikush ka “pronësi” mbi to. Kthimi i pasurive prek një gamë të gjerë të ministrive dhe agjencive, duke përfshirë organet e zbatimit të ligjit brenda Ministrisë së Brendshme, prokurorive, Ministrisë së Drejtësisë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe Ministrisë së Financave për administrimin e pasurive. Brenda BE-së, zyra kombëtare e kthimit të pasurive shpesh është qendra e të gjitha agjendave të përcaktimit të politikave. Kosova* ka ndërmarrë një hap progresiv në emërimin e një Koordinatori Kombëtar për Krimin Ekonomik, i cili është përgjegjës edhe për kthimin e pasurisë. Kjo është praktikë e mirë dhe juridiksionet e tjera në rajon duhet të shqyrtojnë mundësinë e emërimit të një koordinatori kombëtar të kthimit të pasurive, i cili do të kryesonte një komitet kombëtar ose një grup pune për kthimin e pasurive.

Rekomandohet që, në mënyrë që të sigurohet kthimi i pasurive si objektiv politikash, duke nxitur ndryshimin e nevojshëm për të rritur nivelet e konfiskimit, juridiksionet duhet të zhvillojnë një strategji specifike të kthimit të pasurive, një plan veprimi dhe grup pune për këtë qëllim. Një ekspert i shquar në fushën e kthimit të pasurive duhet të caktohet për të kryesuar grupin e punës dhe për të drejttojë politikën dhe praktikën e lidhur me kthimin e pasurive në të gjitha agjencitë përkatëse.

Dispozitat ligjore për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive

Botimet e projektit AIRE-RAI përshkruajnë situatën ligjore dhe të politikave në secilin juridiksion, së bashku me aktivitetet e projektit dhe trajnimet e kryera që nga viti 2018, dhe u kanë mundësuar juridiksioneve në nivel politik dhe profesionistësh të vlerësojnë se ku ndodhen në shkallën e efektivitetit të kthimit të pasurive. Juridiksionet

kanë vazhduar të zhvillohen gjatë gjithë periudhës së projektit, pa dyshim me ndihmën e madhe të projektit për “hartëzimin e situatës”. I njëjti përshkrim vlen edhe për zhvillimin e vazhdueshëm të legjislacionit në rajon, me ndryshimet në lidhje me kthimin e pasurive në KK, KPP dhe LKPK.

Megjithëse nuk përcaktohet si i tillë në legjislacion dhe në standardet ndërkombëtare, ekziston një trend në rritje në nivelin global për të kombinuar të gjitha, ose shumicën, e dispozitave kombëtare të kthimit të pasurive në një ligj të konsoliduar. Ky vjen si reagim ndaj rritjes së numrit të dispozitave ndërkombëtare dhe rajonale që po miratohen, për ta bërë më efektiv hartimin e legjislacionit të ri për të përmbushur një qasje të re dhe jo thjesht të bëhen ndryshime në legjislacionin ekzistues. Jo të gjitha juridiksionet në rajon kanë miratuar një ligj të konsoliduar bashkëkohor për kthimin e pasurive. Maqedonia e Veriut nuk ka një LKPK dhe aktualisht nuk ka plane për miratimin e një ligji të tillë. Shqipëria, që nga viti 2009, ka miratuar Ligjin Antimafia dhe nuk do të miratojë në këtë fazë një ligj të veçantë për të përfshirë të gjitha aspektet e kthimit të pasurive për një gamë më të gjerë të veprave penale. *“Doracaku mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)”* i projektit rajonal përcakton qartë përmbajtjen e ligjit të secilit juridiksion mbi të ardhurat nga krimi, duke i mundësuar rajonit të bëjë krahasime me praktikën e vendeve të tjera dhe të përmirësojë legjislacionin e vet, duke bërë ndryshime nëse është e nevojshme. Si shembull i mirë, LKPK-ja e Malit të Zi përfshin një gamë të gjerë të dispozitave të nevojshme për kthimin e pasurive, të cilat mbulojnë të gjitha fazat e procesit të kthimit të pasurive, duke siguruar një ligj “me një ndalesë” për kthimin e pasurive dhe ligjin më gjithëpërfshirës në të gjithë rajonin. Megjithëse është e vështirë t’ia atribuosh drejtpërdrejt miratimin e ligjeve të reja informacionit dhe trajnimit të ofruar nga projekti rajonal AIRE-RAI, gjatë hartimit të këtij raporti u raportua se botimet e projektit ishin referuar nga prokurorët dhe ligjvënësit përpara se të hartohej dhe të ndryshohej legjislacioni.

Rekomandohet fuqimisht që botimet e projektit rajonal AIRE-RAI, në veçanti “Doracaku mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)”, të vihen në dispozicion të komisioneve vendore të kthimit të pasurive dhe paneleve të rishikimit legjislativ në rajon si referencë e praktikës së mirë kur hartohen ligje për kthimin e pasurive.

Konfiskimi i zgjeruar

Më parë është rekomanduar që dispozitat të konfiskimit e zgjeruar në juridiksionet e BP-së duhet të rishikohen pasi këto dispozita nuk përdoren aq gjerësisht sa duhet dhe nuk janë të suksesshme kur përdoren. Nuk ekziston asnjë praktikë e re gjyqësore për të ndihmuar këtë proces dhe mungesa e trajnimit dhe mentorimit në këtë fushë pengon zbatimin e suksesshëm nga prokurorët dhe gjykatësit. Çështjet me konfiskim të zgjeruar kanë të bëjnë kryesisht me fushën e zbatimit (llojet e veprave penale mbi të cilat zbatohet konfiskimi i zgjeruar), periudhat kohore që i nënshtrohen shqyrtimit (prapaveprues) për të përcaktuar origjinën ligjore të pasurisë dhe standardin e provës mbi të cilin merret vendimi për ligjshmërinë e pasurisë. Prokurorët dhe gjyqtarët ende nuk janë plotësisht të qartë se cilat rrethana specifike duhet të provohen kur vendosin një lidhje midis pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit të zgjeruar dhe krimeve nga të

cilat produktet pretendohet të rrjedhin. Kjo pasiguri mund të çojë në një nivel të ulët të përdorimit të kësaj dispozite të re dhe kërkon trajnim të mëtejshëm.

Në të gjitha juridiksionet, me përjashtim të Kosovës* dhe Maqedonisë së Veriut, standardi i provës është standardi penal, më i lartë se standardi civil i aplikuar në shumë juridiksione jashtë BP-së duke përdorur këtë dispozitë ligjore. Kosova* është juridiksioni i vetëm në rajon që përdor standardin civil. “Konfiskimi i përfitimit material” i parashikuar në legjislacionin e saj parashikon përdorimin e standardit të “bilancit të probabilitetit”. Kosova* gjithashtu ka raportuar për një rast të suksesshëm të konfiskimit të zgjeruar në vitin 2020. Mësimet e nxjerra nga kjo çështje duhet të ndahen me juridiksionet e tjera të BP-së. Në disa juridiksione ligji është ende relativisht i ri dhe zbatimi i tij nuk është testuar ende për të vlerësuar se sa efektiv është ai.

Doracaku i projektit AIRE-RAI (2019) ka sugjeruar në mënyrë të dobishme që, për të kuptuar sfidat e zbatimit të ligjeve që parashikojnë konfiskimin e zgjeruar, juridiksionet duhet të sigurojnë monitorimin e rregullt të jurisprudence përkatëse (të gjykatave të brendshme dhe GJEDNJ-së), veçanërisht nga zyrat e prokurorisë. Institucionet përkatëse gjyqësore duhet të caktojnë personel të posaçëm për të monitoruar vendimet në fushat përkatëse dhe për të raportuar mbi praktikën e mira të identifikuar prej tyre si të dobishme në takimet e stafit. Meqenëse këto sfida ende ekzistojnë, por tani njihen më gjerësisht, rekomandohet një qasje më rajonale për monitorimin e pengesave ndaj konfiskimit të zgjeruar dhe praktikave të mira.

Përveç kësaj, trajnimi mbi dispozitat ligjore të konfiskimit të zgjeruar dhe zbatimi i tyre është akoma i nevojshëm. Për të ndihmuar në zbatimin e dispozitave të konfiskimit të zgjeruar, është i dobishëm këshillimi i drejtpërdrejtë në bazë çështjesh.

Pas identifikimit fillimisht të sfidave legjislative dhe të zbatimit të konfiskimit të zgjeruar në rajon, projekti rajonal AIRE-RAI ndërmori një analizë të detajuar unike të legjislacionit, zbatimit dhe çështjeve ekzistuese në secilin juridiksion. Përfituesit e kësaj analize kanë raportuar se analiza i ka ndihmuar prokurorët dhe gjyqtarët të identifikojnë disa pengesa për zbatimin e suksesshëm të tij. Sidoqoftë, ky është një ligj i komplikuar dhe një qasje e re bashkëkohore ndaj konfiskimit që kërkon përqendrim të mëtejshëm.

Rekomandohet që monitorimi i jurisprudence dhe vendimeve të GJEDNJ-së dhe gjykatave kombëtare në lidhje me konfiskimin e zgjeruar duhet të vazhdojnë të raportohen në platformat vendore dhe rajonale, përfshirë Rrjetin Rajonal të Alumnive të projektit AIRE-RAI.

Rekomandohet gjithashtu që trajnimi për organet e zbatimit të ligjit, në veçanti mentorimi i bazuar në çështje, duhet të vazhdojë t’u ofrohet hetuesve financiarë dhe prokurorëve që ndërtojnë çështje me konfiskim të zgjeruar dhe prokurorëve dhe gjyqtarëve që vlerësojnë lidhjet midis pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit të zgjeruar dhe krimeve nga të cilat pretendohet se rrjedhin këto pasuri.

Për të mbështetur zbatimin rajonal të konfiskimit të zgjeruar, shembujt e rasteve të suksesshme që ekzistojnë, përfshirë shembujt e dhënë në raportin e projektit AIRE-RAI

“Zbatimi efektiv i masave të kthimit të pasurive në Ballkanin Perëndimor: përmbledhje e metodologjisë rajonale të monitorimit, treguesit kryesorë krahasimorë dhe raste studimore të praktikave të mira” (2020) duhet të ndahen si brenda vendit, ashtu edhe brenda rajonit, si në nivelin ndërqeveritar, ashtu edhe midis forumeve publike dhe organizatave të shoqërisë civile. Kjo do të ndihmojë në ndryshimin e perceptimeve negative të publikut për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Konfiskimi civil ose administrativ i bazuar jo në dënim

Kuadri legjislativ i juridiksioneve në rajonin e Ballkanit Perëndimor ende nuk parashikon konfiskimin e pasurive të krijuara me anë të produkteve të krimin pa dënim në proceset gjyqësore civile ose administrative *in-rem* (në vend të *in person*). Megjithatë, që nga fillimi i projektit rajonal AIRE-RAI, Kosova* ka propozuar një ligj të ri me bazë civile për konfiskimin e pasurive të krijuara nga të ardhurat e krimin pa nevojën e një dënimi paraprak, i cili aktualisht është në konsultim. Ky është një zhvillim interesant në rajon, i cili duhet të ndiqet nga afër nga ligjvënësit, agjencitë zbatuese dhe projektet. Eksplorimi i mjeteve juridike civile dhe/ose administrative të bazuara në mosdënim do të lejonte një qasje më të shënjestruar të konfiskimit të pasurive të nxjerra në mënyrë kriminale, pa konsiderata të veçanta, shpesh të vështira, të përfshira në procesin penal që varen nga ekzistenca e një dënimi penal, për shembull, vështirësitë e përshkruara në proceset gjyqësore të konfiskimit të zgjeruar.

Rekomandohet që, në të ardhmen, juridiksionet e BP-së të shqyrtojnë mundësinë e hartimit të legjislacionit për konfiskimin e pasurive në mënyrë të pavarur nga proceset penale in-persona, ku do të mjaftonte të provohej, në procese gjyqësore in-rem, përmes standardit civil të provës, jo përmes standardit penal, se ekziston një lidhje midis pasurive në fjalë dhe sjelljes së përgjithshme kriminale.

Në nivelin praktik, rekomandohet mbështetja e mëtejshme nga Mbretëria e Bashkuar, si një vend shembull lidhur me zbatimin e konfiskimeve civile të bazuara në mosdënim dhe pasurinë e pajustificuar.

Hetimet financiare

Raportet e mëparshme të projektit AIRE-RAI kanë arritur në përfundimin se aftësitë për të kryer hetime financiare si nga organet e zbatimit të ligjit, ashtu edhe nga prokurorët janë të ulëta. Në përgjithësi, kjo është situata. Gjatë analizimit të informacionit të doracakut të prodhuar nga projekti AIRE-RAI, është e qartë se problemi nuk qëndron te legjislacioni, i cili parashikon në mënyrë adekuate teknikat e hetimit dhe përcakton kushtet dhe objektivat e hetimeve financiare. Doracaku shprehet se specializimi për detyrat e hetimit financiar është padyshim një trend i përgjithshëm që do të vazhdojë në periudhën e ardhshme (f. 143). Megjithatë, dhe përparimi i bërë duket se është minimal. Mbetet fakt që nuk ka mjaftueshëm persona me aftësitë e nevojshme për të kryer hetime financiare, jo vetëm për kthimin e pasurive, por edhe për hetimin e përgjithshëm penal. Personat që ekzistojnë janë të izoluar brenda njësive të specializuara dhe nuk janë të “integruar” në të gjithë autoritetet e zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit. Mungesa e vullnetit politik për të sjellë ndryshim në këtë fushë është një pengesë për progresin.

Rekomandohet që integrimi i përgjithshëm i hetuesve dhe prokurorëve financiarë me përvojë duhet të jetë një objektiv politikash brenda strategjisë dhe planeve të veprimit të kthimit të pasurive.

Rekomandohet që në rajon të kërkohet trajnim i mëtejshëm për hetimin financiar me qëllim kthimin e pasurive, për shembull profilizimi financiar i të dyshuarve dhe identifikimi i pronarëve të vërtetë përfitues të të gjitha llojeve të pasurive.

Çështja e aksesit të shpejtë në informacionin bankar është jetike për gjurmimin efektiv të pasurive. Ka ende sfida në këtë fushë në të gjitha juridiksionet. Legjislacioni aktualisht lejon që bankat t'i japin informacion prokurorit, me urdhër të gjykatës. Kjo nuk e zgjidh sfidën e marrjes së menjëhershme të informacionit bankar. Kjo çështje është diskutuar në shumë forume të hetimit financiar në të gjithë botën, veçanërisht brenda BE-së dhe platformës së saj ZRP, e cila tani ka zhvilluar një praktikë të mirë në krijimin e regjistrave të bankave qendrore dhe kush duhet të ketë qasje në to. (d.m.th. ZRP-të). Reformat e ardhshme të rregulloreve për bankat shpresojnë të liberalizojnë konceptin e sekreteve bankare, në përputhje me standardet e BE-së, duke u siguruar kështu prokurorëve që kryejnë hetime financiare duke pasur qasje të drejtpërdrejtë edhe në përmbajtjen e llogarive bankare, në përputhje me urdhrat e gjykatës, nëse është e nevojshme.

Rekomandohet që juridiksionet të krijojnë regjistra kombëtarë të bankave qendrore, në përputhje me standardet e BE-së, dhe të hartojnë dispozita për qasje të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë në këto regjistra, në veçanti nga zyrat kombëtare të kthimit të pasurive (ose ARP-të e entiteteve në rastin e BiH), mundësisht pa nevojën e një urdhri gjykate.

Siç u tha, informacioni financiar është pjesë integrale e çdo hetimi penal. Juridiksionet duket se e njohin dhe e pranojnë këtë, por ka ende pak prova që njësitet që mbledhin informacion financiar të bashkëpunojnë në mënyrë efektive me agjencitë hetimore të krimeve dhe prokuroritë. Si aspekt kryesor i LKPK-së së Malit të Zi, neni 16 specifikon në mënyrë specifike se informacioni financiar i mbledhur gjatë hetimit penal mund të përdoret në hetime financiare dhe anasjelltas. Kjo dispozitë është përfshirë edhe në LKPK-në e Serbisë, neni 4 paragrafi 2, ku parashikohet se provat e mbledhura në hetimin penal mund të përdoren në procedurën e konfiskimit të zgjeruar. Procesi i hetimit paralel financiar shihet si praktikë e mirë në nivelin global, duke përfshirë edhe futjen e tij si dispozitë në LKPK, siç është rasti i Malit të Zi dhe Serbisë.

Rekomandohet që juridiksionet në rajon të parashikojnë që informacioni financiar që mbledhet gjatë hetimit penal të përdoret edhe në hetimet financiare, dhe anasjelltas.

Zyrat e Kthimit të Pasurive

Për t'i sjellë juridiksionet në përputhje me standardet e BE-së dhe praktikën më të mira të njohura globalisht, kërkohet mbështetje e mëtejshme për secilin juridiksion të Ballkanit Perëndimor për krijimin dhe zhvillimin e zyrave efektive të kthimit të pasurive (ZRP). Zyrat qendrore kombëtare të kthimit të pasurive duhet të jenë të ligjshme dhe proceduralisht në gjendje t'u shërbejnë të gjitha agjencive hetimore dhe prokuroriale,

në të gjitha zonat e krimit, me gjurmimin efektiv të pasurive dhe identifikimin e pasurive që mund të bëhen objekt i sekuestrimit dhe konfiskimit. Jo të gjitha juridiksionet në rajon kanë caktuar zyrtarisht një zyrë qendrore kombëtare të kthimit të pasurive (Shqipëria është aktualisht në proces për përcaktimin e kësaj zyre, ndërsa jo të gjitha entitetet e BiH-së kanë një ZRP), në përputhje me standardet^[28] e BE-së dhe praktikat më të mira globale. Ka nga ato shtete që ende kërkojnë mbështetje për sjelljen e zyrave në kapacitetin e tyre të plotë operacional (për shembull Maqedonia e Veriut (ligji i ri për ZRP-në në versionin në draft), Kosova* dhe disa prej entiteteve të BiH-së). Pozicioni është thelbësor për suksesin e një zyre kombëtare të kthimit të pasurive. Zyra duhet të jetë në gjendje të kryejë funksionet e përshkruara në 11 treguesit e efektivitetit të përpunuar nga platforma e BE-së për ZRP-të. Këta tregues janë pranuar nga hetuesit ekspertë financiarë dhe prokurorët që tashmë punojnë në ZRP-të e BE-së. Për të mbështetur procesin e të nxënit dhe zhvillimit, Ballkani Perëndimor do të përfitonte nga qasje rajonale për ndërtimin e kapaciteteve për ZRP-të, për shembull nga konferencat rajonale dhe vlerësimet e ZRP-ve nga kolegë të ZRP-ve të tjera (siç ndodh në BE). Për më tepër, ZRP-të individuale, nëse nuk janë mbështetur deri tani nga projekte të tjera, kërkojnë prezantimin e procedurave dhe zhvillimin e trajnimeve të mëtejshme në lidhje me aktivitetet e nevojshme për t'i bërë ato plotësisht efektive.

Juridiksionet e BP-së kanë krijuar kryesisht zyrat e tyre të administrimit të pasurive brenda kuadrit përkatës ligjor (me përjashtim të Malit të Zi që ka të përcaktuar rolin e administrimit të pasurive brenda Ministrisë së Financave, Zyra e Pronës Shtetërore). Juridiksionet mund të kenë nevojë të marrin parasysh një qasje të ngjashme për krijimin e ZRP-ve kombëtare dhe për këtë gjë do të nevojitet mbështetje e mëtejshme. Për shembull, do të nevojitet mbështetje në formën e ndryshimeve legjislative ose ndryshimeve të politikave, për t'iu përshtatur direktivës së re për qasjen në informacionin bankar^[29]. Praktika më e mirë e BE-së përfshin nivelin e qasjes së drejtpërdrejtë të bazat e të dhënave për gjurmimin e pasurive dhe lehtësinë e qasjes (pa urdhër gjykate) në këto baza të të dhënave si tregues të efektivitetit për ZRP-ve kombëtare brenda indikatorëve të efektivitetit.

Rekomandohet zhvillimi i një programi rajonal mbështetjeje për Zyrat e Kthimit të Pasurive për të ndihmuar për shkëmbimin e njohurive me kolegët. Për më tepër, ZRP-të kombëtare do të përfitonin nga këshillimi i mëtejshëm për të siguruar efektivitet të plotë, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe treguesit e efektivitetit. Shqipëria duhet të vazhdojë të ecë përpara për përcaktimin zyrtar të një ZRP-je qendrore kombëtare, me legjislacion që përshkruan mandatin dhe kompetencat e saj. BiH-ja duhet të shqyrtojë mundësinë e krijimit ose përcaktimit të një ZRP-je brenda secilit prej entiteteve të saj dhe në nivelin shtetëror.

[28] VENDIMI I KËSHILLIT 2007/845/DPB, datë 6 dhjetor 2007, në lidhje me bashkëpunimin midis Zyrave të Kthimit të Pasurive të Shteteve Anëtare në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave nga krimi, ose pasurisë tjetër të lidhur me krimin.

[29] Direktiva (BE) 2019/1153 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit që përcakton rregullat që lehtësojnë përdorimin e informacionit financiar dhe informacionit tjetër për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të disa veprave penale, përshkruan në nenin 3, paragrafi 1 autoritetet që mund të kenë akses të drejtpërdrejtë dhe të kërkojnë informacion në regjistrat kombëtarë të centralizuara të llogarive bankare, duke parashikuar se: "Këto autoritete kompetente do të përfshijnë të paktën Zyrat e Kthimit të Pasurive".

Administrimi i pasurive

Zhvillimet ndërkombëtare dhe rajonale për kthimin e pasurive gjatë dy dekadave të fundit kanë ngritur rëndësinë e rolit të Zyrave Kombëtare të Administrimit të Pasurive (ZAP), duke i dhënë më shumë vëmendje nevojës për dispozita më efektive për këtë aspekt të kthimit të pasurive dhe vendosjes së tij brenda arkitekturës kombëtare të kthimit të pasurive. Standardet ndërkombëtare ekzistojnë^[30], megjithëse ato janë relativisht të pakta. Më shumë ekzistojnë praktikrat e mira, sesa standardet^[31]. Funkzioni i administrimit të pasurive duhet të rregullohet që në fillim të procesit. ZMP-të duhet të përfshihen që në një fazë të hershme të procesit të kthimit të pasurive, dhe jo vetëm pas urdhrimit të gjykatës, për arsye të tilla si këshillimin për heqjen dhe ruajtjen e pasurive dhe gjithashtu edhe për vlerësimin. Prokurorët dhe agjencitë e zbatimit të ligjit aktualisht i paraqesin informacion gjykatave mbi vlerën e përafërt të pasurive, përpara përfshirjes së ZAP-së (për shembull në Shqipëri). ZAP-të janë zyrat kombëtare që duhen përfshirë në këtë proces. Ata duhet të këshillojnë prokurorët dhe oficerët e zbatimit ligjit përgjatë rrugës.

Të gjitha juridiksionet në rajon kanë krijuar ose caktuar një ZAP që mbështet ciklin e kthimit të pasurive në shkallë të ndryshme. Në shumicën e rasteve, zyrat janë themeluar dhe funksionojnë brenda legjislacionit për administrimin e pasurive. Ato ose ndodhen nën Ministrinë e Brendshme ose Ministrinë e Drejtësisë, ose brenda Agjencisë Shtetërore të Pronave në Ministrinë e Financave. Është e rëndësishme që ZAP-ja të jetë në dijeni të fazave të çështjes në mënyrë që të përgatitet për të administruar më tej pronën ose për ta shitur atë. Kjo punë bëhet më mirë kur ZAP-ja, prokurori dhe gjykatat janë të lidhur në mënyrë elektronike. Asnjë nga ZAP-të e Ballkanit nuk është i lidhur në mënyrë elektronike, duke u mbështetur kryesisht në postën standarde, postën elektronike ose telefonin për të marrë njoftimin për ndryshimet e kushteve të urdhrave të ngrirjes dhe konfiskimit, për shembull pas apelimit. Një numër i vogël juridiksionesh kanë zhvilluar kohët e fundit sisteme elektronike që lidhin këto agjenci, për qëllime të regjistrave statistikore (Shqipëria, BiH-ja), por asnjëri nuk është ende plotësisht funksional dhe nevojitet punë e mëtejshme për sistemet e digjitalizuara të administrimit të pasurive. Në mënyrë të ngjashme, në shumicën e rasteve, ZAP-të nuk informohen për gjasat se policia do të sekuestrojë pasuritë, për shembull gjatë një kontrolli të planifikuar paraprakisht. ZAP-ja duhet të ketë ekspertizën e nevojshme për të sekuestruar në mënyrë efektive pasuritë. Për pasojë, ajo duhet të udhëheqë planifikimin para sekuestrimit në rastet kur kontrollet policore ka të ngjarë të çojnë në sekuestrim të pasurisë. Planifikimi para sekuestrimit para kontrolleve të policisë ende nuk është i pranishëm në asnjë nga vendet e rajonit.

Ballkani Perëndimor ka bërë përparim të madh në fushën e administrimit të pasurive, jo vetëm gjatë periudhës së projektit, por edhe gjatë viteve para tij. Megjithatë, rekomandohet që të kërkohet ndërtim i mëtejshëm i kapaciteteve në fushën e administrimit të pasurive në formën e ligjeve dhe akteve nënligjore, planifikimit para sekuestrimit dhe krijimit të regjistrave për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, të cilat mund të ndërveprojnë me bazat e të dhënave gjyqësore për kthimin e pasurive.

[30] Direktiva 2014/42/BE për ngrirjen dhe konfiskimin, neni 11.

[31] Dokumenti i praktikave të mira i FATF-së 2012, rekomandimi 33, udhëzime jodetyruese të UNCAC-ut për administrimin e pasurisë dhe rekomandime të rrjetit CARIN, 2008.

Përdorimi i pasurive të konfiskuara

Juridiksionet po shqyrtojnë gjithnjë e më shumë mundësinë e ripërdorimit të pasurive të konfiskuara që nuk i nënshtrohen kompensimit për viktimat për qëllime sociale ose gjyqësore. Sistemet për ripërdorim nga shteti ose ripërdorim social ndryshojnë në të gjithë rajonin. Jo të gjitha juridiksionet kanë aftësinë për të dhuruar pasuri që prishen, për shembull, për bamirësi ose projekte të komunitetit. Në mënyrë të ngjashme, jo të gjitha juridiksionet kanë krijuar një fond ku të gjitha ose një pjesë e pasurive të konfiskuara mund të depozitohen për përdorim shtetëror ose social. Megjithatë, ka disa shembuj të shkëlqyer të ripërdorimit të pasurive të konfiskuara në rajon për qëllime sociale, për shembull në Shqipëri dhe Serbi. Këto përvoja duhet të ndahet për të mirën e zhvillimit të praktikës së ngjashme në juridiksione të tjera.

Rekomandohet që të punohet më tej për të zhvilluar politikat dhe praktikën e ripërdorimit shtetëror dhe social në të gjitha juridiksionet e Ballkanit Perëndimor.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Pranohet ndërkombëtarisht se është pikërisht shumëllojshmëria e ligjeve, politikave dhe procedurave të brendshme që i bën çështjet teknike të kthimit të pasurive një sfidë për bashkëpunimin ndërkombëtar, madje edhe për juridiksionet më të përparuara. Prandaj nuk është për t'u habitur që gjatë periudhës së projektit AIRE-RAI, prokurorët e raportuan këtë si një nga sfidat më të mëdha, veçanërisht gjatë fazës së hetimit dhe gjurmimit të pasurive. Për shembull, afatet e shkurtra brenda legjislacionit të konfiskimit të zgjeruar që duhet të respektohen nga prokurorët për t'i dëshmuar gjykatës se pasuritë zotërohen nga të pandehurit e tyre në juridiksione të huaja e bëjnë detyrën e tyre pothuajse të pamundur. Pas identifikimit të bashkëpunimin ndërkombëtar si sfidë, projekti AIRE-RAI u përqendrua tek ofrimi e një programi trajnimi në temën e bashkëpunimit ndërkombëtar për kthimin e pasurive dhe prodhoi një manual referues mbi mjetet dhe praktikat më të mira për kthimin e pasurive ndërkombëtare. Trajnimi specifik rajonal në lidhje me këtë temë, ofruar nga projekti, u mirëprit nga prokurorët dhe duhet të lavdërohet. Megjithatë, kjo është një temë e vështirë dhe për juridiksionet e rajonit do të ishte i vlefshëm trajnimi i më shumë prokurorëve.

Rekomandohet trajnimi i më shumë prokurorëve për kthimin e pasurive ndërkombëtare si për hetimin e vendndodhjes së pasurive në juridiksionet e huaja, ashtu edhe për hartimin e kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike për të zbatuar urdhrat e ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit. Shkëmbimi i përvojave me ekspertë nga Mbretëria e Bashkuar në këtë fushë ka rezultuar i suksesshëm gjatë projektit dhe prandaj rekomandohen trajnime dhe mbështetje e mëtejshme.

Zotërimi i një baze të shëndoshë ligjore për bashkëpunimin ndërkombëtar për kthimin e pasurive ndihmon pjesërisht për sigurimin e një sistemi efektiv. Nevoja për të përdorur mekanizmat rajonale të krijuar posaçërisht për të lehtësuar kthimin e pasurive ndërkombëtare, d.m.th. CARIN, BAMIN dhe StAR, tani njihet si praktikë e mirë ndërkombëtare dhe theksohet brenda manualit të projektit AIRE-RAI "Për instrumentet dhe praktikat e mira për kthimin e pasurive ndërkombëtare". Të gjitha

juridiksionet e Ballkanit Perëndimor tani kanë emëruar një person kontakti nga organet e zbatimit të ligjit dhe një person kontakti nga zyrat e prokurorive, megjithatë juridiksionet duhet të sigurojnë që pikat e kontaktit të jenë caktuar nga brenda agjencive të duhura dhe ata të jenë personi më i përshtatshëm për rolin, si për t'u shërbyer kolegët në institucionet e tyre, ashtu edhe partnerëve ndërkombëtarë të kthimit të pasurive. Është shënjuar progres si rezultat i drejtpërdrejtë i mbështetjes së ofruar nga projekti rajonal AIRE-RAI, gjatë trajnimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në vitin 2019, me caktimin e një personi kontakti nga prokuroria e BiH-së për rrjetin CARIN. Kjo është hera e parë që një entitet i BiH-së ose shteti i BiH-së përfaqësohet nga një prokuror që nga koha kur u bë anëtar i rrjetit në vitin 2012 dhe kjo përbën një përparim të madh.

Rekomandohet që juridiksionet të sigurojnë përfaqësimin nga agjencitë korrekte në platformat ekzistuese të kthimit të pasurive, në mënyrë që të lehtësohet bashkëpunimi operacional ndërkombëtar i kthimit të pasurive (CARIN, StAR dhe BAMIN).

Përveç rrjeteve specifike të kthimit të pasurive tashmë të disponueshme, dhe si rezultat i reagimeve të marra nga koordinatorët e projektit gjatë trajnimeve dhe vizitave studimore, juridiksionet përfituese të projektit AIRE-RAI propozuan krijimin e një Rrjeti Rajonal të Alumnive. U vendos që ky rrjet të përbëhet nga pjesëmarrës në aktivitetet e projektit dhe ai të shtrihet në secilin prej juridiksioneve përfituese për të siguruar qëndrueshmërinë e rezultateve të projektit. Ekipi i projektit ka hartuar Udhëzimet e Rrjetit të Alumnive dhe ua ka shpërndarë ato Koordinatorëve Kombëtarë (KK). Më pas, KK-të kanë krijuar rrjete kombëtare të alumnive brenda juridiksioneve të tyre përkatëse të financuara nga projekti. Në takimet e zhvilluara nga KK-të, alumnitë tashmë kanë identifikuar një sërë problemesh praktike të cilat mund të trajtohen në një nivel rajoni. Për shembull, është propozuar krijimi i një Platforme Rajonale të Rrjetit të Alumnive, e cila do të lehtësonte shkëmbimin e praktikave të mira dhe do të forconte bashkëpunimin rajonal për kthimin e pasurive.

Rekomandohet krijimi i Rrjetit Rajonal të Alumini-t të projektit rajonal AIRE-RAI si në nivel kombëtar, dhe rajonal për të identifikuar problemet e zakonshme për kthimin e pasurive, të cilat kërkojnë një qasje rajonale. Ky burim duhet të kultivohet me kujdes dhe të pajiset me opsionet e duhura për shkëmbimin e përvojës dhe shpërndarjen e njohurive. Rrjeti duhet të identifikojë një listë të ekspertëve të shquar të kthimit të pasurive në rajon si për t'u ndarë me pjesëmarrës të tjerë të rrjetit, ashtu edhe për t'u përfshirë në këtë rrjet. Këta ekspertë duhet të ndihmojnë për shkëmbimin e praktikave të mira dhe për rishikimet dhe ndryshimet legjislative.

Përveç trajnimit jetik, dhe me kërkesë të juridiksioneve përfituese, projekti rajonal AIRE-RAI ka mbështetur një takim fillestar konsultimi mbi hartimin e një marrëveshjeje rajonale, shumëpalëshe për ndarjen e pasurive midis Serbisë, FBiH-së, Republika Srpska-s dhe Malit të Zi. Kjo marrëveshje do të ofrojë një rregullim ligjor për ndarjen e pasurive me origjinë kriminale, pas konfiskimit, dhe duhet të përdoret si model i praktikës më të mirë për marrëveshje të tjera të ngjashme në rajon.

Matja e efektivitetit dhe mbledhja e statistikave

Matja e efektivitetit të çdo sistemi të kthimit të pasurive mbështetet në shumë faktorë, përfshirë statistikën e kthimit të pasurive, por edhe në nivelin dhe llojin e kriminalitetit të juridiksioneve dhe kërcënimit që sjell ai. Megjithatë, qasja në statistikën gjithëpërfshirëse të vendosura në një vend qendror është thelbësore për procesin. Rajoni ka një synim të qartë për ta arritur këtë, i motivuar dhe mbështetur nga kërkimi i ndërmarrë në kuadër të projektit rajonal AIRE-RAI. Mungesa e monitorimit dhe e mbledhjes së statistikave të kthimit të pasurive identifikohet dhe raportohet në botimin e parë të projektit AIRE-RAI, *“Kthimi i pasurive në Ballkanin Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës (2018)”*, në faqen 73^[32], ku flitet për mungesën e monitorimit dhe mbledhjes së statistikave për kthimin e pasurive në rajon. Kjo nuk është unike vetëm për Ballkanin pasi edhe BE-ja ende po merret me krahasimin e statistikave për sekuestrimet, konfiskimet dhe vlerat e tyre midis Shteteve Anëtare të BE-së (SHA). Në përgjigje të drejtpërdrejtë të kësaj, projekti ka përfunduar kërkime unike për të skicuar situatën në secilin prej juridiksioneve të vendeve anëtare të BP-së, dhe për ta krahasuar atë me standardet më të rëndësishme të nxjerra nga burimet ndërkombëtare, në veçanti nga Bashkimi Evropian, duke arritur kulmin me botimin e projektit AIRE-RAI *“Raport mbi zbatimin efektiv të masave të kthimit të pasurive në Ballkanin Perëndimor: përmbledhje e metodologjisë rajonale të monitorimit, standardevë krahasuese dhe rasteve studimore të praktikave të mira”*.

Përveç krahasimit të statistikave mbi numrin e sekuestrimeve dhe konfiskimeve dhe vlerës së tyre, standardet e BE-së gjithashtu kërkojnë që juridiksionet të monitorojnë numrin e kërkesave hyrëse dhe dalëse të lidhura me kthimin e pasurive në mënyrë që të monitorojnë dhe matin kthimin efektiv të pasurive ndërkombëtare. Ka ardhur koha që juridiksionet e BP-së të përqendrohen te statistikën e kthimit të pasurive. Rajoni ka një mundësi të shkëlqyer për ta bërë këtë gjë falë mbështetjes së ofruar nga projekti rajonal AIRE-RAI dhe për ta bërë këtë punë siç duhet. Raporti i projektit AIRE-RAI *mbi metodologjinë e monitorimit rajonal* përcakton qartë statistikën e kthimit të pasurive që duhet të mblidhen në rajonin e BP-së për të monitoruar aktivitetin e kthimit të pasurive në mënyrë të tillë që lejon matjen e efikasitetit.

Për vlerësimin e situatës aktuale, projekti mund të arrijë në përfundimin se shumë juridiksione kanë futur sisteme të menaxhimit të pasurive brenda agjencive të tyre (kombëtare) të administrimit të pasurive, të cilat, së bashku me regjistrimin e statistikave për pasuritë e sekuestruara, të konfiskuara dhe vlerën e tyre, sigurojnë një sistem të menaxhimit të çështjeve për secilën pasuri, që nga fillimi i menaxhimit të pasurisë nga shteti, deri në asgjësimin ose përdorimin e saj (p.sh. Shqipëria, Kosova* dhe Serbia). Për më tepër, gjatë periudhës së projektit janë krijuar sisteme të ndryshme, disa prej të cilëve elektronike, në mënyrë që gjykatat të përpilojnë dhe regjistrojnë vendimet, duke përfshirë edhe konfiskimet (BiH-ja dhe Serbia). Megjithatë, në këto sisteme jo gjithmonë regjistrohen detajet e nevojshme për të siguruar përputhshmëri

[32] Në studim përcaktohet «nevoja për mbledhjen e grupeve specifike të të dhënave që do të mundësonin një vlerësim më të mirë të efektivitetit dhe efikasitetit të procesit të kthimit të pasurive, si dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të mbledhjes së të dhënave në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive».

me standardet e BE-së. Mënyra e vetme për t'u siguruar që statistikave përkatëse janë mbledhur me saktësi, është përdorimi i një sistemi të përbashkët nga të gjitha agjencitë e përfshira në sekuestrim dhe konfiskim. Ky është rasti, për shembull, në Serbi. Përvoja e Serbisë përshkruhet brenda studimit me përshkrimin se ajo ka një sistem të mirë të mbledhjes së të dhënave që mundëson kryerjen e një analize të shkëlqyer të të dhënave për kthimin e pasurive. Kur statistikave përpilohen për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara dhe për vlerën e tyre, ato rrallë përmendin ndonjë marrëveshje me juridiksione të tjera. Bashkëpunimi ndërkombëtar, në procesin e kthimit të pasurive, është pjesë jetike e çdo suksesi. Standardet e BE-së tani kërkojnë mbledhjen e statistikave për kërkesat ndërkombëtare hyrëse dhe dalëse për zbatimin e urdhrave të sekuestrimit dhe konfiskimit^[33] dhe ky është standardi që duhet të synohet nga rajoni.

Rekomandohet që, për të matur efektivitetin e kthimit të pasurive në të gjithë rajonin, duhet të inkurajohet një model standard për mbledhjen e statistikave, bazuar në nivelin bazë të përshkruar në raportin e AIRE-RAI-it. Shembuj të mirë të regjistrave elektronikë ekzistojnë në rajon (RPSK-u e AAPSK-së në Shqipëri, Regjistri Prokurorial dhe Gjyqësor brenda CMS-së në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Regjistri Qendror në Serbi), por juridiksionet ende kanë nevojë për mbështetje me këtë pikë.

Trajnimi

Nevoja për ndërtimin e kapaciteteve në formën e trajnimeve përmendet në të gjithë këtë raport. Trajnimet për prokurorët dhe gjyqtarëve mbi hetimin financiar kryhen në disa juridiksione në mënyrë të rregullt (p.sh. nga Maqedonia e Veriut, Serbia) dhe madje shfaqet edhe në agjendën politike të disa juridiksioneve (p.sh. në Mal të Zi). Megjithatë ekziston ende një mungesë e dukshme e edukimit dhe trajnimit të specializuar të brendshëm për punonjësit e zbatimit të ligjit në lidhje me hetimin financiar për të gjurmuar dhe identifikuar pasuritë, të cilat më vonë mund t'i nënshtrohen konfiskimit.

Për shembull, Serbia raporton një hendek në hetimin financiar si për policinë, ashtu edhe për prokurorët, si dhe nevojë për trajnim për prezantimin e provave financiare përpara gjykatës. Të gjitha juridiksionet në rajon mund të kenë të njëjtën nevojë, megjithatë raportet nga koordinatorët kombëtarë sugjerojnë nivele të ndryshme të njohurive dhe përvojave. Nevoja për trajnim të mëtejshëm të prokurorëve në nivelin rajonal mbi temën e bashkëpunimit ndërkombëtar tashmë ka dalë e qartë si përfundim nën seksionin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Sidoqoftë, para se të fillohet me trajnime të përgjithshme në të gjitha juridiksionet, pika fillestare duhet të jetë realizimi i një ankete kombëtare mbi aftësitë aktuale në mënyrë që nevojat për trajnim të analizohen me kujdes për t'u siguruar që trajnimet i përshtatet nevojave të secilit juridiksioni dhe secilës audience të veçantë.

Rekomandohet ofrimi i trajnimeve të mëtejshme për të rritur aftësitë hetimore, për të gjurmuar pasuritë, për të prezantuar pronësinë mbi pasurinë dhe pasurinë

[33] RREGULLORJA (BE) 2018/1805 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KESHILLIT, datë 14 nëntor 2018, mbi njohjen reciproke të urdhrave të ngrirjes dhe urdhrave të konfiskimit.

joproporcionale para gjykatës, për të ndihmuar gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe stafin e policisë në njësitë e hetimit financiar të kuptojnë rëndësinë e provave rrethore gjatë proceseve gjyqësore të konfiskimit të zgjeruar dhe për t'u angazhuar për bashkëpunimin ndërkombëtar. Rekomandohet që projektet e ardhshme të ndërtimit të kapaciteteve të analizojnë nevojat për trajnim të juridiksioneve individuale para se të fillojnë me trajnime të përgjithshme që mund të jenë interesante, por jo veçanërisht të dobishëm.

Qendra AIRE

Qendra AIRE është organizatë jo-qeveritare e cila promovon zbatimin e të Drejtës Evropiane dhe ofron mbështetje për viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut. Një ekip juristësh ndërkombëtarë ofron ekspertizë dhe këshilla praktike në lidhje me standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës dhe ka përvojë të posaçme mbi jurisprudencën Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, ku ka marrë pjesë në më shumë se 150 raste.

Gjatë këtyre 20 viteve, Qendra AIRE ka ndërtuar reputacionin e saj të fortë në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke vepruar në të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë në rajon. Ajo punon në bashkëpunim të ngushtë me ministritë e drejtësisë, shkollat e trajnimit gjyqësor, gjykatat e larta dhe kushtetuese dhe me prokuroritë për të drejtuar, mbështetur dhe ndihmuar në drejtim të zhvillimit të shtetit ligjor dhe projekteve të reformave në kuadër afatgjata. Gjithashtu, Qendra AIRE bashkëpunon me sektorin e organizatave jo-qeveritare në mbarë rajonin me qëllim mbështetjen e reformave në fushën e ligjit dhe të respektimit të të drejtave të njeriut. Puna e organizatës ka qenë gjithmonë e përqendruar te garantimi që secili mundet praktikisht dhe efektivisht të gëzojë të drejtat e tij. Në praktikë kjo do të thotë promovim dhe lehtësim i zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare të zbatimit të të drejtave ligjore dhe të drejtave të njeriut, duke ndihmuar në procesin e Integritimit Evropian përmes forcimit të shtetit të së drejtës, garantimit të njohjes së plotë të të drejtave të njeriut dhe inkurajimit të bashkëpunimit mes gjyqtarëve dhe profesionistëve në fushën e së drejtës në mbarë rajonin.

RAI

Nisma Rajonale Anti-Korrupsion (RAI) është një organizatë ndërqeveritare me nëntë vende anëtare: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Mali i zi, Rumania dhe Serbia. Polonia, Gjeorgjia dhe Sllovenia janë vende me statusin e vëzhguesit. Misioni i RAI-t është udhëheqja e bashkëpunimit rajonal për mbështetjen e përpjekjeve kundër korrupsionit duke ofruar një platformë të përbashkët për diskutime përmes ndarjes së njohurive dhe të praktikave më të mira. Sekretaria e Organizatës e ka selinë në Sarajevë, ndërsa ka projekte në mbarë Evropën Juglindore, duke u përqendruar në radhë të parë te forcimi i bashkëpunimit rajonal për konfliktin e interesit dhe deklarimin e pasurisë, legjislacionin me masa paraprake parandaluese kundër korrupsionit, vlerësimin e rrezikut nga korrupsioni, sinjalizuesit, krijimin e integritetit të zbatuesve të ligjit dhe forcimin e kapaciteteve vendase për kthimin e pasurisë.

8. Shtojca 1: Lista e raporteve të AIRE – RAI-t të prodhuara gjatë periudhës së raportimit

Zbatimi efektiv i masave të kthimit të pasurive në Ballkanin Perëndimor: vështrim i përgjithshëm i metodologjisë së monitorimit rajonal, treguesit kryesorë krahasimorë dhe raste studimore të praktikave të mira

Raporti përfshin një përmbledhje të metodologjisë rajonale të monitorimit, praktikave të mira dhe hapave përpara, dhe paraqet standardet më të rëndësishme të nxjerra nga burimet ndërkombëtare, veçanërisht nga Bashkimi Evropian. Ai jep një listë të standardeve dhe rekomandimeve, të cilat synojnë t'u ofrojnë autoriteteve kombëtare udhëzime të dobishme dhe praktike për krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës, të saktë dhe të besueshëm për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave për kthimin e pasurive. Raporti gjithashtu përmban histori suksesi, të cilat paraqiten në formën e rasteve studimore duke mbuluar aspekte të ndryshme të kthimit të pasurive.

- » Botuesi: Qendra AIRE dhe RAI
- » Autorët: E. Mujanović, L. Mandia, M. L. Trajkovska, R. D. Dicic, G. Ismajli, A. Ivanovic
- » Viti i botimit: 2020
- » Versione në gjuhë të tjera: në gjuhën shqipe, gjuhën boshnjake/kroate/malazeze/serbe, maqedonase

Doracak mbi kthimin efektiv të pasurive në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (2019)

Ky manual ofron një përmbledhje të standardeve ndërkombëtare për konfiskimin e produkteve të krimit dhe korrupsionit. Së pari, ai trajton pyetjet se çfarë është konfiskimi dhe pse është i rëndësishëm ai. Së dyti, doracaku identifikon konventat kryesore ndërkombëtare dhe jep një tregues të fushës së veprimit të secilës prej tyre. Së treti, doracaku shpjegon qasjen që marrin këto standarde lidhur me aspektet kryesore të konfiskimit.

- » Botuesi: Qendra AIRE dhe RAI
- » Autorët: K. Kamber, W. Ferris, C. Harby, E. Haxhia, A. Selmani, E. Mujanovic, D. Datzer, G. Ismajli, A. Ivanovic, M. L. Trajkovska, R. D. Dicic
- » Viti i botimit: 2019
- » Versione në gjuhë të tjera: në gjuhën shqipe, gjuhën boshnjake/kroate/malazeze/serbe, maqedonase/rumune

Doracak për Praktika të mira për bashkëpunimin ndërkombëtar për kthimin e pasurive

Ky botim synon t'u vijë në ndihmojë profesionistëve të kthimit të pasurive për të kryer kthimin efektiv ndërkombëtar të pasurive duke siguruar udhëzime për praktikën më të mirë për bashkëpunimin ndërkombëtar. Ai përmban legjislacionin përkatës ndërkombëtar dhe evropian të kthimit të pasurive, standardet dhe mekanizmat për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe synon të jetë një mjet praktik për hetuesit, prokurorët, gjyqtarët dhe institucionet e tjera të përfshira në gjurmimin dhe identifikimin e pasurive, ngrirjen dhe sekuestrimin, konfiskimin (përfshirë konfiskimin e bazuar në mosdënim) dhe asgjësimin e pasurive ndërkombëtare.

- » Botuesi: Qendra AIRE dhe RAI
- » Autorët: AML Consulting (Global) Ltd: J. Thomas, L. Day, F. Jackson
- » Viti i botimit: 2019
- » Versione në gjuhë të tjera: në gjuhën shqipe, gjuhën boshnjake/kroate/malazeze/serbe, maqedonase/rumune

Kthimi i pasurive në Ballkanin Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë mekanizmat aktualë të sekuestrimit dhe konfiskimit të disponueshëm në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që të përcaktohet përdorimi i tyre efikas dhe efektiv në kontekstin e procesit të kthimit të pasurive.

- » Botuesi: Qendra AIRE dhe RAI
- » Autor: Pedro Gomes Pereira
- » Viti i botimit: 2018
- » Versione në gjuhë të tjera: në gjuhën angleze

Kthimi i pasurive - analizë krahasuese e legjislacionit dhe praktikës: Bullgaria, Kroacia, Moldavia dhe Rumania

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë mekanizmat aktualë të sekuestrimit dhe konfiskimit që përdoren në Bullgari, Kroaci, Moldavi dhe Rumani, në mënyrë që të përcaktojë përdorimin e tyre efikas dhe efektiv në kontekstin e procesit të kthimit të pasurive.

- » Botuesi: Qendra AIRE dhe OSBE
- » Autor: Pedro Gomes Pereira
- » Viti i botimit: 2018
- » Versione në gjuhë të tjera: në gjuhën angleze

Qendra AIRE

Qendra AIRE është organizatë jo-qeveritare e cila promovon zbatimin e të Drejtës Evropiane dhe ofron mbështetje për viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut. Një ekip juristësh ndërkombëtarë ofron ekspertizë dhe këshilla praktike në lidhje me standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës dhe ka përvojë të posaçme mbi jurisprudencën Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, ku ka marrë pjesë në më shumë se 150 raste.

Gjatë këtyre 20 viteve, Qendra AIRE ka ndërtuar reputacionin e saj të fortë në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke vepruar në të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë në rajon. Ajo punon në bashkëpunim të ngushtë me ministritë e drejtësisë, shkollat e trajnimit gjyqësor, gjykatat e larta dhe kushtetuese dhe me prokuroritë për të drejtuar, mbështetur dhe ndihmuar në drejtim të zhvillimit të shtetit ligjor dhe projekteve të reformave në kuadër afatgjata. Gjithashtu, Qendra AIRE bashkëpunon me sektorin e organizatave jo-qeveritare në mbarë rajonin me qëllim mbështetjen e reformave në fushën e ligjit dhe të respektimit të të drejtave të njeriut. Puna e organizatës ka qenë gjithmonë e përqendruar te garantimi që secili mundet praktikisht dhe efektivisht të gëzojë të drejtat e tij. Në praktikë kjo do të thotë promovim dhe lehtësim i zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare të zbatimit të të drejtave ligjore dhe të drejtave të njeriut, duke ndihmuar në procesin e Integritimit Evropian përmes forcimit të shtetit të së drejtës, garantimit të njohjes së plotë të të drejtave të njeriut dhe inkurajimit të bashkëpunimit mes gjyqtarëve dhe profesionistëve në fushën e së drejtës në mbarë rajonin.

RAI

Nisma Rajonale Anti-Korrupsion (RAI) është një organizatë ndërqeveritare me nëntë vende anëtare: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Mali i zi, Rumania dhe Serbia. Polonia, Gjeorgjia dhe Sllovenia janë vende me statusin e vëzhguesit. Misioni i RAI-t është udhëheqja e bashkëpunimit rajonal për mbështetjen e përpjekjeve kundër korrupsionit duke ofruar një platformë të përbashkët për diskutime përmes ndarjes së njohurive dhe të praktikave më të mira. Sekretaria e Organizatës e ka selinë në Sarajevë, ndërsa ka projekte në mbarë Evropën Juglindore, duke u përqendruar në radhë të parë te forcimi i bashkëpunimit rajonal për konfliktin e interesit dhe deklarimin e pasurisë, legjislacionin me masa paraprake parandaluese kundër korrupsionit, vlerësimin e rrezikut nga korrupsioni, sinjalizuesit, krijimin e integritetit të zbatuesve të ligjit dhe forcimin e kapaciteteve vendase për kthimin e pasurisë.